

TË PËRKUSHTUAR NDAJ ALLAHUT

Thuaj: "Namazi im, kurhani im, jeta dhe
vdekja ime janë thjesht për All-llahun,
Zotin e botëve.
(En'am: 162)

HARUN YAHYA



Në të vërtetë emri musliman është emri që All-llahu u jep atyre që i përmbahen fesë së Tij. Vetia themelore, e referuar në Kur'an, që i dallon muslimanët nga njerëzit tjerë është vetëdija e tyre për fuqinë e pakufi të All-llahut.

Të kuptuarit e fuqisë së All-llahut nuk është vetëm çështje e konfirmimit verbal. Besimtarë janë ata të cilët e njohin ekzistencën dhe madhërinë e Allahut, "janë të palëkundur në detyrat e tyre" ndaj Tij dhe i drejtojnë të gjitha veprat dhe sjelljet e tyre në dritën e këtij realiteti që është bërë i qartë për ata. Ky libër jep një pikturë të qartë e besimtarit të përkushtuar ndaj All-llahut siç përshkruhet në Kur'an. Duhet të mbahet në mend se xhenneti është vendbanimi i atyre "që besojnë me plotëbindje" All-llahun dhe Ahiretin e prandaj "përpiqen me tërë përpjekjen e duhur" në rrugën e All-llahut. Fundi i atyre të cilët "adhurojnë All-llahun me mëdyshje" dhe i vëjnë interesat e tyre të parëndësishme në shkallë të njëjtë me knaqësinë e All-llahut janë përshkruar kështu në Kur'an:

Ka nga njerëzit që adhurojnë All-llahun me mëdyshje (luhatshëm) nëse e godet ndonjë e mirë ata qetësohet më të, po nëse e godet ndonjë e pakëndshme, ai kthehet në fytyrën e vet të vërtetë (të mëparshme), ai i ka humbur këtë dhe jetën tjetër e ky është ai dështimi i qartë. (Haxhxh: 11)



ABOUT THE AUTHOR

The author, who writes under the pen-name Harun Yahya, was born in Ankara in 1956. He studied arts at Istanbul's Mimar Sinan University, and philosophy at Istanbul University. Since the 1980s, the author has published many books on political, faith-related and scientific issues. Greatly appreciated all around the world, these works have been instrumental in helping many to return their faith in Allah, and, in many others, to gain a deeper insight into their faith. Harun Yahya's books appeal to all kinds of readers, regardless of their age, race, or nationality, for they focus on one objective: to broaden the reader's perspective by encouraging him or her to think about a number of critical issues, such as the existence of Allah and His unity, and to live by the values He prescribed for them.

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ



Për lexuesin

Arsyeja pse një kapitull special është përcaktuar për shkatërrimin e teorisë së evulcionit është se kjo teori caktoi themelet e filozofive anti-shpirtërore. Gjatë 140 viteve të fundit, Darwinizmi, i cili mohon faktin e krijimit, e si rrjedhojë, edhe vetë ekzistencën e Zotit, ka bërë që shumë njerëz të largohen nga besimi i tyre dhe të bien në kthetrat e dyshimit. Ndaj, duke provuar se kjo teori nuk është gjë tjetër veç një mashtrim, ne kryejmë një detyrë shumë të rëndësishme që është e lidhur ngushtë me fenë. S'ka dyshim, se ky është një shërbim i rëndësishëm që duhet t'u ofrohet të gjithëve.

Pasiqë disa lexues mund të kenë mundësinë të lexojnë vetëm një libër të autorit, ne mendojmë se është e përshtatëshme që të ndajmë një kapitull për përmbajtjen e këtij qëllimi

Një pikë që duhet theksuar ka të bëjë me përmbajtjen e librit. Në të gjithë librat e autorit, temat që kanë lidhje me besimin trajtohen në dritën e ajeteve kur'anore dhe njerëzit ftohen që të mësojnë fjalët e Zotit dhe të jetojnë bashkë me to. Të gjitha temat që kanë lidhje me ajetet kur'anore janë të shpjeguara në mënyrë të atillë që të mos lënë asnjë shteg për dyshime apo dilema në mendjen e lexuesit. Stili i qartë, i lehtë e i rrjedhëshëm mundson çdo njëri të çfarëdo moshe apo grupi social që të kuptojë me lehtësi librat. Kjo gjë i bën ata shumë tërheqës për tu lexuar njëheresh, pa e ndërprerë leximin. Edhe ata persona që e mohojnë anën shpirtërore ndikohen pozitivisht nga faktet e përmendura në këto libra dhe nuk mund ta hedhin poshtë vërtetësinë e tyre.

Ky liber, ashtu si të gjithë librat e tjerë të autorit, mund të lexohen individualisht ose në grupe. Leximi i librit në gupe është shumë i dobishëm dhe i rëndësishëm, pasi çdo lexues mund t'ia përcjellë tjetrit mendimet dhe eksperiencën e tij.

Këta libra janë shkruar vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit, andaj edhe kontributi i çdokujt për leximin dhe prezantimin e tyre do të ishte një shërbim i madh për fenë e Zotit. Andaj, ata që duan t'ua transmetojnë fenë të tjerëve, do të gjejnë një mjet tepër efikas në librat e Harun Jahjas.

Shpresojmë që lexuesi do të ndajë pak kohë që të shikojë pasqyrimin e librave tona tjera, në faqet e fundit të këtij libri, dhe të vlersojë burimet e pasura të materialeve për të dhënat e lidhura me besimin, të cilat janë shumë të dobishme dhe është kënaqësi të lexohen.

Në këto libra ju nuk do të gjeni shpjegime që bazohen në burime të dyshimta, apo stil shkrimi që bie ndesh me respektin dhe nderimin që duhet të tregojmë për gjërat e shejta, apo ide të pabaza që fusin dyshim dhe shkaktojnë devijim në zemër.

**TË
PËRKUSHTUAR
NDAJ
ALL-LLAHUT**

*Thuaj: "Namazi im, kurhani im, jeta dhe vdekja
ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve.
(En'am: 162)*

HARUN JAHJA

Janar, 2005

Rreth autorit

Autori, i cili shkruan me pseudonimin HARUN JAHJA, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Pasi mbaroi shkollën tetëvjeqare dhe të mesme në Ankara, ai studioi artet në Universitetin Mimar Sinan të Stambollit, si dhe filozofi në Universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, autori ka publikuar libra të shumtë në fusha të ndryshme, si ato politike, fetare dhe shkencore. Hajrun Jahja njihet si një autor që ka shkruar punime tepër të rëndësishme për nxerrjen në shesh mashtrimet e evolucionistëve, pavalershmërinë e pretendimeve të tyre, si dhe anët e errta që lidhin Darwinizmin me disa ideologji shkatërrimtare siç janë: fashizmi dhe komunizmi.

Pseudonimi i tij përbëhet nga emrat "Harun" dhe "Jahja", për të përkujtuar këta dy pejgamberë që luftuan kunder mosbesimit. Vula e Pejgamberit, e cila gjendet në kapakun e librave të autorit përmban një kuptim simbolik që ka lidhje me përmbytjet e tyre. Kjo vulë përfaqëson Kur'anin, i cili është libri dhe fjala e fundit e Zotit dhe Pejgamberin, i cili është pejgamberi i fundit. Nën udhëheqjen e Kur'anit dhe Sunetit, autori ka për qëllim të hedhë poshtë të gjitha bazat e ideologjive anti-fetare, në mënyrë që të shuhet të gjitha kundërshtimet ndaj fesë. Vula e pejgamberit të fundit, i cili arriti mençurinë bazë dhe përsosmërinë morale, është përdorur si shenjë e qëllimit të tij për me e thanë këtë fjalë të fundit.

Të gjitha këto punime të autorit përqëndrohen rreth një qëllimi: transmetimi i mesazhit të Kur'anit për të gjithë njerëzit, duke i nxitur ata të mendojnë rreth temave të rëndësishme që kanë lidhje me besimin, si ekzistenca e Zotit, njësimi i Tij, bota tjetër etj, dhe t'i informoi ata për themelet e dobëta dhe ideologjitë e prishura të sistemeve të pafe.

Hajrun Jahja gëzon një reputacion të madh lexuesish në shumë shtete siç janë: India, Amerika, Anglia, Indonezia, Polonia, Bosnja, Spanja dhe Brazili. Disa prej librave të tij janë të përkthyer në shumë gjuhë siç janë: anglisht, frengjisht, gjermanisht, spanjollisht, italisht, portugalisht, urdu, arabisht, shqip, rusisht, serbokroatisht, boshnjakisht, polonisht, turqisht, indonezish etj.

Të vlerësuarit në të gjithë botën, këto punime kanë shërbyer për të ndihmuar shumë njerëz të gjejnë rrugën e besimit apo të arrijnë një kuptim më të thellë të besimit të tyre. Stili i qartë, i lehtë dhe i rrjedhshëm i këtyre librave u jep atyre disa veçori karakteristike që mund të vihen re nga kushdo që i lexon apo i shqyrton ato. Këto punime kanë pasur një ndikim të shpejtë dhe rezulate tepër të kënaqshme. Është e pamundur për ata persona, që i lexojnë këto libra me kujdes dhe mendojnë rreth tyre seriozisht që të vazhdojnë të mbrojnë filozofinë materialiste, ateizmin apo çfarëdo ideologjie apo filozofie shkatërrimtare. Edhe

nëse ata vazhdojnë mbrojtjen, kjo tregon se ata bazohen në sentimentalizmin e tyre, pasi këto libra i hedhin poshtë këto ideologji që nga themelet. Sot është bërë e mundur që të gjitha lëvizjet bashkohore jobsimtare të pësojnë një disfatë ideologjike, në saj të koleksionit të librave të shkruar nga Hajrun Jahja.

S'ka dyshim se këto veçori e kanë origjinën nga urtësia dhe udhëzimi i Kur'anit. Autori sigurisht që nuk ndihet krenar për veten e tij; ai synon që të jetë një mjet që ndihmon të tjerët për të gjetur rrugën e drejtë të Zotit. Për më tepër, ai nuk merr asnjë përfitim material nga librat e tij. Edhe ata që përgatisin këto libra nuk marrin asnjë përfitim material. Ata duan vetëm të fitojnë kënaqësinë e Zotit.

Duke pasur parasysh këto fakte, ata të cilët inkurajojnë njerëzit që të lexojnë këto libra, të cilët hapinë „sytë“ e zemrës dhe ndihmojnë të tjerët të bëhen adhurues të devotshëm të Zotit, bëjnë një shërbim të paçmueshëm për fenë.

Nga ana tjetër, do të ishte humbje kohe dhe energjie përhapja e atyre librave që krijojnë konfuzion në mendjet e njerëzve dhe nuk kanë ndonjë ndikim të efektshëm në largimin e dyshimeve dhe dilemave nga zemrat e tyre, siç e ka vërtetuar dhe ekspëriencia shumëvjeqare. Është më se e natyrshme që librat e tillë që janë shkruar më tepër për të theksuar forcën letrare të autorit të tyre, sesa për të fituar kënaqësinë e Zotit, nuk mund të kenë kurrë një efekt pozitiv. Ata që dyshojnë në këtë, mund të shohin se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjas është triumfi ndaj mosbesimit dhe përhapja e vlerave morale të Kur'anit. Te ky shërbim suksesi, efekti dhe sinqëriteti është manifestuar në bindjen e lexuesit

Nuk duhet ta harrojmë një pikë shumë të rëndësishme: shkak kryesor i vazhdimit të problemeve dhe konflikteve që përballojnë muslimanët sot është ndikimi ideologjik i mosbesimit. Të gjitha këto do të marrin fund kur të arrihet disfata ideologjike e mosbesimit dhe të sigurohemi që çdo njëri të njej mrekullitë e krijimit dhe moralin Kur'anor, në mënyrë që të gjithë njerëzit të jetojnë me frymën e tyre. Duke marrë në konsideratë gjendjen e botës sot, e cila i çon njerëzit në një humnerë të thellë dhune, korrupsioni dhe konfliktesh, është e qartë që ky shërbim duhet të jetë i disponueshëm sa më shpejt dhe sa më efektivisht që të jetë e mundur. Përndryshe, mund të jetë shumë vonë.

Nuk është zmadhim të themi se koleksioni i librave të Harun Jahjas ka supozuar këto role udhëheqëse. Ne shpresojmë që me vullnetin e Zotit, librat e harun Jahjas do të luajnë këtë rol tepër të rëndësishëm në shekullin XXI dhe do të ndihmojnë njerëzit të fitojnë paqën, bekimin, drejtësinë dhe lumturinë e premtuar në Kur'an.

Autori ka shkruar një numër të madh librash prandaj ka qenë humbje kohe që t'i përmendim të gjitha por personat e interesuar, ato mund t'i gjejnë (në faqen e internetit të Harun Jahjas në adresen www.harunyahya.org).

PËRMBAJTJE



SYNIMI I JESTËS SË NJË BESIMTARI: PËLQIMI I ALL-LLAHUT	8
KËRKIMI I KËNAQËSISË MË TË MIRË TË ALL-LLAHUT	24
JETA NË SHOQËRINË E INJORANCËS.....	53
VENDBANIMI I PËRHERSHËM I ATYRE QË KANË MARRË PERËNDI TJERA PËRPOS ALL-LLAHUT: XHEHNNEMI	80
VENDBANIMI I PËRHERSHËM I ATYRE QË KËRKOJNË VETËM MIRATIMIN E ALL-LLAHUT: XHENNETI.....	82
KEQKUPTIMET E EVULCIONIT.....	85

SYNIMI I JETËS SË NJË BESIMTARI: MIRATIMI I ALL-LLAHUT



All-llahu e vë me atë (me Kur'anin) në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë. (Maide: 16)

C'ka e bënë të dallohet muslimanin prej njerëzve të tjerë? Jomuslimanët mund t'i përgjigjen kësaj pyetje në mënyra të shumta; Ata mund të flasin për dallimet kulturore dhe morale, për "pikëpamjet e ndryshme për botën" apo vlerat të cilat ata drejtëpërdrejt i mohojnë. Rrjedhimisht, dikush mund të thotë se dallimi i ka rrënjët e veta në ideologjitë e ndryshme të cilat muslimanët i përqafojnë. Mirëpo, të gjitha këto përgjigjeje lidhen me dallimet "e dukshme" që shfaqen të jenë si pasojë kryesore. Shpesh, ata nuk kuptojnë arsyen e dallimeve themelore. (Në të vërtetë, nëse ata nuk janë musliman, është sepse ata nuk kanë mund të kuptojnë këtë dallim).

Është një pikë që duhet të theksohet para se të vazhdojmë me shpjegimin e vetive themelore që e bëjnë të dallohet muslimani: Kur ne flasim për një "muslimanë," ne nuk po mendojmë për dikënd që në letërnjoftimin e tij shkruan "muslimanë." Emri musliman faktikisht është emër që All-llahu u jep atyre që mbështeten në fenë e Tij. Vetia themelore, e përmendur në Kur'an që veçon muslimanët nga njerëzit e tjerë, është vetëdijshmëria e tyre për fuqinë e pakufij të All-llahut. Vetëdijshmëria për fuqinë e pakufij të All-llahut nuk do të thotë në të gjitha rastet pohimin e ekzistimit të një Krijuesi, megjithatë Kur'ani e nënvizon këtë fakt si në vijim:

Thuaj: "Kush ju furnizon me ushqim nga qielli e toka, Kush e ka në dorë të dëgjuarit e të pamurit (tuaj), Kush nxjerr të gjallin nga i vdekuri e Kush nxjerr të vdekurin nga i gjalli, Kush rregullon çdo çështje?" Ata do të thonë: "All-llahu". Ti thuaj: "A nuk frikësoheni?" (dënimet). E ky është All-llahu, Zoti juaj i Vërtetë. Pas të vërtetës nuk ka tjetër pos iluzione, e si po ia ktheni shpinën (të vërtetës)? (Junus: 31-32)

Në ajetin e mësipërm, pyetjet u janë parashtruar dikujë që pranon ekzistimin e All-llahut, i pranon vetitë e Tij, sidoqoftë, pavarësisht nga të gjitha këtotribute, nuk ka frikë nga All-llahu dhe kështu largohet nga Ai. (Faktikisht, as djalli nuk e refuzon ekzistimin e All-llahut)

Kuptimi i fuqisë së All-llahut nuk është vetëm një çështje e vërtetimit verbal. Besimtarë janë ata të cilët e pranojnë ekzistimin e All-llahut dhe madhësitinë e tij, "janë të palëkundur në detyrat e tyre" ndaj Tij dhe ri-orientojnë të gjitha veprimet dhe drejtohen në dritën e këtij realiteti i cili u bë i qartë për ta. Të tjerët, në anën tjetër, janë ose ata

që e mohojnë All-llahun, apo, si në rastin e njerëzve të përshkruar në ajetin e mësipërm, ata të cilët nuk i kryejnë detyrat e tyre ndaj All-llahut, pavarësisht nga vetëdija e tyre për ekzistimin e Tij.

Gjatë gjithë jetës së tyre, njerëzit e tillë mbesin plotësisht harrestar ndaj All-llahut, Krijuesit të njeriut. Kujt i kanë borxh jetën e tyre dhe si dhe pse u është dhënë një jetë në tokë, janë pyetje për të cilat ata nuk merakosen ta shqetësojnë vetën. Ata parashikojnë një llojë të jetës krejtësisht të ndarë nga All-llahu dhe feja e Tij. Mirëpo, krahasimi vijues në Kur'an e bënë të qartë se jeta e tillë mbështetet mbi themele të pavlera dhe të kalbura dhe është i dënuar në shkatërrim:

A është më i mirë ai që ndërtesën e vet e themeloi në devotshmëri dhe në kënaqësi të All-llahut, apo ai që ndërtesën e vet e themeloi buzë bregut të shëmbur e bashkë me të bie në zjarrin e xhehennemit? All-llahu nuk i udhëzon njerëzit zullumqarë. (Tewbe: 109)

Siç na informon edhe ajeti i mësipërm, jeta e atyre që u mungon besimi, siç u përshkrua në Kur'an, është e bazuar në anën e një "bregu të shëmbur". Qëllimi kryesor në të cilin jobesimtarët janë të bindur, është arritja e lumturisë dhe paqes "në këtë botë." Në këtë kuptim, atë që më së shumti ata e dëshirojnë, është të bëhen të pasur. Ata bëjnë gjithçka për arritjen e këtij qëllimi, duke përfshirë të gjitha përpjekjet fizike dhe mendore. Për të tjerët, në anën tjetër, me u bërë një person i respektuar dhe i njohur është qëllimi i jetës; ata do të bëjnë çdo gjë dhe do të bëjnë cilëndo sakrificë për të fituar respektin e publikut. Mirëpo, të gjitha këto nuk janë asgjë veçëse qëllime të kësaj bote, të cilat do të zhdukën kur të vjenë vdekja mbi ta. Madje disa

prej tyre mund t'i shmangë kuptimi i tyre këtu në këtë botë

Megjithatë, besimtari është plotësisht i vetëdijshëm për ekzistimin dhe fuqinë e All-llahut. Ai e di se pse e ka krijuar All-llahu atë dhe se çka Ai pret prej tij. Për këtë arsye, dëshira e tij themelore në jetë është të bëhet një robë me të cilin All-llahu është i kënaqur. Ai përdorë të gjitha mënyrat për arritjen e këtij qëllimi, dhe përpiqet për t'u bërë ashtu. Pasi ky është rasti, ai e zbërthen misterin e vdekjes: për shumë nuk do të thotë asgjë veçëse fundi final, por për të, vdekja nuk është zhdukje, por një fazë e kalimit për në jetën e vërtetë.

Jobsimtarët e supozojnë vdekjen, të cilën e marrin si një incident që e përfundon jetën e tyre, të jetë një "aksident i vet-krijuar", sikur që e supozojnë jetën të ketë shfaqje të rastësishme dhe të paplanifikueshme. Megjithatë, e vërteta është se All-llahu e krijon jetën dhe në të njëjtën mënyrë e merrë atë. Vdekja, e cila në asnjë mënyrë nuk është një rastësi apo një aksidentë, është një ndodhi e cila ndodhë me urdhrërin e All-llahut në një moment dhe vend të paracaktuar.

muslimani është një personë i cili e kuptonë se All-llahu ka fuqi mbi të gjitha sendet dhe se vdekja nuk është një fund por një kalim për në vendbanimin e vërtetë të njeriut (ahiretin). I vetëdijshëm për këto fakte, ai me kujdes i shmanget ndërtimit të jetës së tij në një "breg të shëmbur." Ai i kthehet All-llahut, i vetëdijshëm se Ai është Poseduesi i vërtetë dhe Krijuesi i jetës, vdekjes dhe çka ka përtej. Në këtë sistem të krijuar nga All-llahu, ai e kupton se pasuria, gjendja sociale apo dukjet e mira nuk janë mënyra që e çojnë njeriun në sukses; ato janë vetëm

"shkaqe" që funksionojnë sipas rregullave të vendosura nga All-llahu, të cilat janë efektive vetëm për një kohë të shkurtër.

Çelsi për te sistemi që All-llahu e ka krijuar është pëlqimi i All-llahut. Kjo është për shkak se All-llahu i udhëzonë vetëm ata që duan miratimin e Tij.

All-llahu e vë me atë (me Kur'anin) në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë. (Maide: 16)

Muslimani është musliman për shkak se ai e kërkon miratimin e All-llahut. Kjo është veçoria më e rëndësishme që e bënë muslimanin të dallohet nga njerëzit e tjerë. Muslimanët e shohinë fenë si një rrugë për të fituar miratimin e All-llahut, ndërsa shumica e njerëzve e konsiderojnë atë si një sistem të besimeve që e zenë një pjesë të pakuptim të jetës së tyre.

Në të vërtetë, në këtë pikë shfaqet ndryshimi në mes të muslimanëve të vërtetë dhe atyre që i imitojnë ata (hipokritët). muslimanët e përqafojnë fenë si një shteg i udhëzimit për te miratimi i All-llahut. Por, për hipokritët, është diçka prej të cilës ata nxjerrin përfitime. Kjo është pse lutjet e hipokritëve janë të një natyre "**për tu dukur**" (Ma'un: 6) ndërsa muslimanët lutën me përulje (Mu'minun: 1-2). Ngjashëm, përderisa muslimanët shpenzojnë paratë e tyre për çështjet e All-llahut, hipokritët shpenzojnë për t'i mahnitur njerëzit e tjerë më parë se të fitojnë miratimin e All-llahut.

O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim siç bën ai që e jep pasurinë e vet sa par sy e faqe të njerëzve, e nuk e beson All-llahun

dhe as botën tjetër. Shembulli i tij është si një gur i madh e i lëmuar që mbi të ka pak dhe, e kur e godet atë një shi i madh e lë të zhveshur (lakuriq). Ata (formalistët) nuk arrijnë asgjë nga ajo që punuan. All-llahu nuk udhëzon popullin jobesimtar. (Bekare: 264)

Përpyekja e duhur për miratimin e All-llahut

Njeriu orvatet shumë për të arritur pëlqimet botërore, në të cilat orvatje ai e vë mendjen e tij sikur të ishte qëllimi përfundimtarë në jetë. Ai e jep maksimumin e tij për të fituar përparim material, famën e pozitës shoqërore apo disa përfitime tjera botërore. Për "**një vlerë të parëndësishme**" (Tewbe: 9) që do t'i rrëshqas nga dora e tij për një kohë shumë të shkurtër, ai e bënë një përpyekje gjithëpërfshirëse.

Muslimanët, të cilët dëshirojnë një dhuratë ma të madhe, d.m.th, miratimin e All-llahut dhe kopshtin e Tij, gjithashtu përpiqen shumë për qëllimin e tyre. Për këtë veti All-llahu thotë:

Kush është që ka për qëllim vetëm këtë botë, Ne atij që duam i japim në të aq sa duam, e pastaj atij i bëjmë të hyjë në xhehennem i nënçmuar, i përbuzur. E kush e ka për qëllim botën tjetër, duke qenë ai besimtarë, përpiqet për të ashtu si i takon asaj, angazhimi i tyre do të jetë i pranishëm (te Zoti). (Isra': 18-19)

Një besimtarë përpiqet me "tërë përpyekjen e duhur" për aprovimin e All-llahut dhe për ahiretin. Ai "shetë" pronën e tij dhe jetën e tij për çështjen e All-llahut. Në Kur'an, kjo karakteristikë e besimtarëve është sqaruar si në vijim:

All-llahu bleu prej besimtarëve shpirtërat dhe pasurinë e tyre me xhennet. Luftojnë në rrugën e All-llahut, mbysin dhe mbyten. (All-llahu dha) Premtim të cilin e vërtetoi në Tevrat, Inxhill e Kur'an. E kush është më zbatues i sigurt i premtimit të vet se All-llahu? Pra, gëzonju tregtisë që bëtë me Të. Ky është suksezi i madh. (Tewbe: 111)

Besimtari në angazhimin e tij drejtë rrugës së All-llahut nuk has në asnjë vështirësi, po qe se ai i ka shitur "pronën e tij dhe vetëveten" All-llahut. Asgjë nuk e tërheqë atë përveç aprovimit të All-llahut. I vetëdijëshëm se ai nuk është "pronari" i trupit dhe pronës së tij, ai kurrë nuk i ndjekë dëshirat e pavlera të epshit (nepsit). All-llahu është Poseduesi i trupit të tij dhe i çdo gjëje që ai ka, dhe ato do të vëhen në shërbim në pajtim me Dëshirën e All-llahut.

Përveç kësaj, edhe nëse vendosmëria e ndonjërit është serioze do të sprovohet nga All-llahu. Besimtari nuk duhet t'i shmanget cilësdo lufte në rrugën e All-llahut. Sepse nëse do të ishte aty ndonjë pyetje e "fitimit të lehtë," edhe hipokritët mund të kryejnë ndojnë veprim e cila ka paraqitjen e të qenurit në pajtueshmëri me Dëshirën e All-llahut — e jo veprimin e vërtetë me të cilin All-llahu do të jetë i kënaqur — të arrijnë këtë " fitim të lehtë":

Sikur të ishte fitim i afërt dhe udhëtim mesatar, ata (hipokritët) do të vinin pas teje, por për ta ishte largësi e vështirë. Ata do të betohen në All-llahun: "Sikur të kishim pasur mundësi, do të dilnim me ju". E shkatërojnë veten e tyre; All-llahu e di se ata janë rrenacakë. (Tewbe: 42)

Prandaj, kriteri i vetëm për të qenë besimtarë është nd-

jenja e sigurtë e dëshirës për kërkimin e aprovimit të All-llahut dhe mos tërheqja nga bërja e cilësdo sakrificë në rrugën e All-llahut kur rrethanat kërkojnë sakrifice të tillë. Besimtarët janë ata të cilët **"ne i pajisëm me një virtyt të posaçëm, me përkujtim ndaj botës tjetër"** (Sad: 46). Besimtari nuk kërkon asnjë përfitim tjetër përveç aprovimit të All-llahut. Ai shpreson që All-llahu të jetë i kënaqur me të, të ketë mëshirën e Tij dhe të arrijë Parajsën, sepse **"Kush bën ndonjë nga punët e mira, qoftë mashkull ose femër duke qenë besimtarë, të tillët hyjnë në Xhennet dhe nuk u bëhet farë padrejtësie."** (Nisa': 124)

Siç e kemi parë, Kur'ani përmbanë një pikturë të saktë të besimtarit. Parajsa është vendbanim i atyre të cilët **"besojnë me plotëbindje"** në All-llahun dhe në ahiretin (Lukman: 4) dhe që "përpiqen me tërë përpjekjen e duhur" në rrugën e All-llahut. Fundi i atyre të cilët "adhurojnë All-llahun me mëdyshje" dhe vëjnë interesat e tyre të vogla të kësaj bote afër kënaqësisë së All-llahut janë përshkruar kështu në Kur'an:

Ka nga njerëzit që adhurojnë All-llahun me mëdyshje (luhatshëm) nëse e godet ndonjë e mirë ata qetësohet më të, po nëse e godet ndonjë e pakëndshme, ai kthehet në fytyrën e vet të vërtetë (të mëparshme), ai i ka humbur këtë dhe jetën tjetër e ky është ai dështimi i qartë. (Haxhxh: 11)

Besimtarët janë lakmues të ahiretit. All-llahu u premtonte besimtarëve një jetë të bukur dhe të pambarim në ahiret. Zoti ynë u premtonte besimtarëve gjithashtu se Ai do të u jep jetë të mirë edhe në këtë jetë robërve të Tij besimtarë. Sidoqoftë kjo nuk d.m.th se ata nuk do të ndeshën

me vështirësi dhe probleme në këtë botë. Këto vështirësi që ata i takojnë janë të sajuara që t'i vënë ata në sprovë dhe t'i bëjë ata ma të pjekur.

Pengesat të cilat besimtari i has janë sikur situata të vështira; por posa të gjejë nënshtrimin, All-llahu e liron atë nga të gjitha vështirësitë. P.sh, kur njerëzit e tij provuan ta hedhin peygamberin Ibrahim ,a.s., në zjarrë për shkak të besimit të tij, reagimi i tij ishte tipik për një musliman; ai e pëlqejë që më parë të hudhet në zjarr se të largohet nga besimi i tij dhe nga urdhërat e All-llahut. Të hudhurit në zjarrë është vuajtja trupore më e tmerrshme që cilido njeri mund t'i ndodh në këtë botë. Megjithatë, Ibrahim i a.s, i cili e takoi këtë sprovim nga All-llahu në sjelljen më të nënshtruar, ishte shpëtuar, nga kjo siç duket eksperiencë e mundishme, me Dëshirën e All-llahut, dhe ai nuk u dëmtua aspak.

Ai tha: "A po adhuroni pra në vend të All-llahut asish që nuk u sjellin kurrfarë dobie as dëmi?" Medet për ju dhe për ata që i adhuroni, pos All-llahut, po a nuk po kuptoni?"Atëherë ata thanë: "Digjeni atë (Ibrahimin) dhe ndihmoni zotat tuaj, nëse doni t'u ndihmoni!" Po Ne i thamë: "O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!" Ata deshën t'i bëjnë atij (Ibrahimit) kurth, po Ne ata i bëmë më të dështuarit. (Enbija': 66-70)

Fakti se nuk do të ju ndodh dëm atyre të cilët nuk frikohën të humbin çkadoçoftë kur ata orvatën për çështjen e All-llahut dhe se ata do të arrijnë shumë shpërblime shpirtërore dhe materiale, janë të nënvizuar në Kur'an në një kalim që e lartëson besimin e besimtarëve edhe kur janë në buzë të disfatës në luftë:

E atyre (shokëve të peygamberit) që dikush u tha: "Populli (idhujtarët) është tubuar t'ju sulmojë, pra keni frikë!" Ajo, vetëm ua shtoi edhe më shumë besimin e thanë: "Neve na mjafton që kemi All-llahu, Ai është mbrojtësi më i mirë!" Dhe atë pa i gjetur kurrfarë e keqe fituan begati e mirësi të mëdha nga All-llahu dhe e arritën kënaqësinë e Tij, All-llahu është dhurues i madh. Po atë (propagandë) e bëri vetëm shejtani që dëshironte me miqtë e vet (idhujtarët), t'ju friksojë, po ju mos u frikësoni prej tyre, frikësomënu Mua, nëse jeni besimtar. E ty të mos të brengosin ata që përpiqen për mosbesim, ata kurrsesi nuk mund të dëmtojnë asgjë All-llahun. All-llahu me urtësinë e vet dëshiron që atyre të mos u takojë kurrfarë e mire në botën tjetër dhe ata kanë një dënim të madh. Ata që në vend të besimit pranuan kufrin, nuk i bëjnë asgjë dëm All-llahut, ata i pret një dënim i idhët. (Ali Imran: 173-177)

Përfundimisht, asnjë shqetsim, vështirësi apo vuajtje nuk ndikonë në besimtarin i cili kërkonë pëlqimin e All-llahut dhe zbatonë urdhërat e Tij. Kjo vërtetohet gjatë ngjarjeve me të cilat All-llahu e vë vendosmërinë, durimin dhe nënshtrimin e besimtarëve në sprovë. Këto nga jashtë janë ngjarje të vështira dhe të mundimshme; por nëse takohen me durim dhe nënshtrim ato i lejojnë individit të zbulojë mëshirën e All-llahut. Kjo d.m.th, All-llahu na informon në Kur'an se Ai nuk e ngarkon askënd më shumë se që mund të mbaj:

All-llahu nuk ngarkon askë përtej mundësive të veta, (Bekare: 286)

All-llahu nuk e dënon besimtarin që vazhdimisht i

shërben Atij, as në këtë botë e as në ahiret. Përkundrazi, Ai e shpërblenë atë më së miri në të dyat, në këtë botë dhe botën tjetër:

Atyre që patën frikë nga (dënimi) All-llahu, u thuhet: "Ç'është ajo që shpalli Zoti juaj?" Ata thoshin: "Shpalli çdo të mirë!" Ata që bënë vepra të mira, edhe në këtë jetë kanë shpërblim të mirë, por shpërblimi i tyre në botën tjetër është shumë më i mirë, e sa vend i mirë është ai i të devotshëmve. Është Xhenneti i Adn-it, ku do të hyjnë, nën të rrjedhin lumenj, aty kanë çka të dëshirojnë, ashtu i shpërblen All-llahu të ruajturit. (Nahl: 30-31)

Si një përkujtues nga All-llahu, mundimi, vështirsia dhe telashet janë ndëshkim mbi ata që dështojnë të kërkojnë aprovimin e All-llahut, të cilët nuk paraqesin nënshtrim absolut ndaj Tij por më parë zbatojnë dëshirat e shpirtave të tyre. Kur të gabojnë bësimitarët, ata konsiderojnë se vështirësitë dhe telashet që ata i vuajnë janë pasojë e paralajmërimit mëshirues nga All-llahu, me kujdes nxjerrin mësim nga ato, pendohen dhe përmirësojnë sjelljen e tyre. Jobsimitarët, megjithatë, kurrë nuk mësojnë nga sprovat që ata kalojnë, në këtë mënyrë ata meritojnë denimin e përhershëm në ahiret.

Kuptimi i shpirtit

Një pjesë tjetër të informatës shumë të rëndësishme që na jep neve Kur'an'i për njeriun ka të bëjë me "epshin" (nefsin) e tij. "Epshi" si zakonisht përdoret në Kur'an, d.m.th, "egoizëm" apo "personalitet."

Në Kur'an, All-llahu shpjegon dy faqet e shpirtit: njëra

sugjeron të keqen dhe punët e liga, dhe tjetra, mbrojtëse kundër çdo rrënje të së keqës. Kur'ani e shpjegonë këtë kështu:

Pasha njeriun (nefsin) dhe Atë që e krijoi atë! Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten. (Shems: 7-10)

Siç është e qartë nga ajeti i mësipërm, e keqja ekziston në çdo shpirtë të njeriut. Mirëpo, ai që pastron shpirtin e tij do të arrijë shpëtimin. Besimtarët nuk i dorëzohen të keqës në shpirtrat e tyre; ata thjesht e largojnë me këshillën e udhëzimit të All-llahut. Siç ka thënë pejgamberi Jusufi a.s.: **"Unë nuk e shfajsoj veten time, pse epshi është shumë nxitës për të keqen, përveç atë që e ka mëshiruar Zoti im..."** (Jusuf: 53), paraqet sjelljen e duhur të mendimit të një besimtari.

Pasi që shpirti është "i prirur për të keqën" besimtari duhet gjithmonë të jetë syhapur për shpirtin e tij. Siç edhe pejgamberi Muhammedi (savs), ka thënë, " *lufta më e madhe është lufta kundër epshit (nefsit)*". Epshi vazhdimisht e provokon personin dhe kurrë nuk i fiton atij aprovimin e All-llahut. Meqë i bënë të gjitha këto tenton të prezentojë alternativa joshëse. Megjithatë, besimtari në saje të frikës së tij ndaj All-llahut, nuk është i mashtruar nga kjo veti "çorjentuese" e shpirtit. Ai gjithmonë kthehet në drejtim të asaj që është e drejtë në çuarjen e jetës në pajtueshmëri me Dëshirën e All-llahut. E tillë është sjellja e personit të ditur e kundert me atë të një të padituri, siç ka thënë pejgamberi s.a.a.s:

Person i mençur është ai që ruhet nga dëshirat trupore dhe pa-

sionet, dhe e kontrollojnë vetën nga ajo që është e dëmshme dhe përpriqet për atë që është fitimprurëse për të pas vdekjes; e personë i paditur është ai që e nënshtonë vetën ndaj dëshirave dhe epsheve të tij dhe pret nga All-llahu plotësimin e dëshirave të tij të pavlera.(Tirmidhiu)

Shmangëja nga idhujtaria

Shumë shkurtimisht, idhujtaria është shoqërimi i krisesave tjera All-llahut. Duke parë këtë definicion, disa njerëz mund të kundërshtojnë, "ne tanimë nuk i shoqërojmë shok All-llahut," ndonëse faktikisht mund të jetë rasti që ata i bëjnë. Dështimi i tyre për të kuptuar domethënien e idhujtarisë shpjegon kundërshtimin e tillë. Në të vërtetë, Kur'ani tregonë rastin e shumë popujve të cilët i shoqëruan shokë All-llahut — d.m.th, që ishin idhujtarët—megjithëse ata kurrë nuk e pranojnë këtë situatë:

Përkujto ditën kur Ne i tubojmë të gjithë dhe u themi atyre që i shoqëruan: "Ku janë ata të shoqëruarit tuaj, që i trillonit?" Atëherë (pas atij sprovimi) përgjigje tjetër s'u mbetet përveç të thonë: "Për All-llahun, o Zoti ynë, ne nuk ishim idhujtarë!" (En'am: 22-23)

Askush nuk duhet të merr si të gatshme se ai është plotësisht i lirë nga idhujtaria, por duhet gjithmonë t'i lutet All-llahut që ta ruajë atë nga ajo. Kjo sepse idhujtaria është mëkat i madh. Kur pejgamberi (savs) është pyetur se cili është mëkati më i madhë, është përgjigjur "*shoqërimi shokë All-llahut përderisa Ai u ka krijuar juve.*" Në Kur'an, All-llahu thotë se Ai mund të falë të gjitha mëkatet dhe krimet, përveç idhujtarisë:

S'ka dyshim se All-llahu nuk falë (mëkatin) t'i për-

shkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përpos këtij (mëkati) i falë kujt do. Kush i përshkruan All-llahut shok, ai ka trilluar një mëkat të madh. (Nisa': 48)

Pika fillestare e idhujtarisë, e cila është një "mëkat dhe shpifje" aq e madh, është përshkrimi i vetive të All-llahut disa gjallesave të tjera në mendjen e ndonjërit. Mirëpo, e vërteta është se vetitë (forca, inteligjenca, bukuria dhe të tjera) të cilat ne i përshkruajmë gjallesave të tjera në të vërtetë nuk u takojnë atyre; ata janë të pajisur me to nga All-llahu për një kohë të caktuar dhe kalimtare. Pretendimi se këto veti i "përkasin" gjallesave tjera përveç All-llahut thjeshtë nënkupton pranimin e tyre për zota. Kjo, në anën tjetër, është përkufizuar si shoqërim i gjallesave në pyetje si shokë All-llahut, me fjalë tjera, vendosja e shokëve All-llahut.

Lidhur me All-llahun si Një dhe të Vetmin, Kur'ani thotë:

Thuaj: Ai, All-llahu është Një! All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë. (Ihlas: 1-4)

Siç u tha në surën e mësipërm, All-llahu është furnizuesi i çdonjërit; çdo gjallesë është e nevojshme për të që të ekzistoi. Asgjë nuk barazohet me Atë. Posa të mohohet ky fakt dhe njerëzit të fillojnë të mendojnë se disa gjallesa mund të ekzistojnë me pëlqimin e tyre pa mbështetjen e All-llahut, idhujtaria del mbi sipërfaqe. Me mendimi të tillë, ndonjëri harron se çdo gjë e gjallë është nën kontrollin e All-llahut. Besimi i rrejshëm për ekzistimin e disa gjallesave të cilat nuk kanë nevojë për All-

llahun del në shesh. Pretendimi se gjallesat e tilla mund të ekzistojnë e çojnë njeriun me i lutë për ndihmë, të kërkojë pëlqimin e tyre dhe t'i përshtaten rregullave të tyre.

Mirëpo, besimtarët të cilët nuk i shoqërojnë shokë All-llahut i kthehen vetëm Atij pasi që ata e dinë se All-llahu ka fuqi mbi të gjitha sendet. Shpjegim i arsyeshëm i besimtarëve është treguar në Kur'an si në vijim:

**Ty të adhurojmë dhe prej Teje ndihmë kërkojmë.
(Fatiha: 4)**

Ata të cilët i shoqërojnë shokë All-llahut, në fakt i drejtohen qënieve që nuk janë të aftë të ju ndihmojnë. Sepse edhe qëniet që ata i marrin si zota janë robë të dobët sikur ata. Për këtë All-llahu thotë:

A i përshkruajnë shok atë çka nuk mund të krijojë asnjë send, e ata (idhujt) vetë janë të krijuar. Ata (idhujt) nuk mund t'ju sjellin atyre ndonjë ndihmë e as veten e tyre ta ndihmojnë. Dhe, edhe nëse i thirrni për t'i udhëzuar, ata nuk ju përgjigjen. Për ju është njejtë, i thirrët ata ose heshtët. S'ka dyshim se ata që po i adhuronit ju pos All-llahut, janë të krijuar sikur ju (njerëzit janë më të përsosur). Thirrni pra ata, e le t'ju përgjigjen juve nëse thuani të vërtetën. (A'raf: 191-194)

Si pasojë, idhujtaria është një shpifje e madhe, mashtrim i madh dhe një qëndrim shumë i pamatur. Drejtimi i pamatur i atyre që i shoqërojnë shokë All-llahut është përshkruar në Kur'an si në vijim:

O ju njerëz, ja një shembull veni veshin pra: Vërtet ata që po i adhuronit në vend të All-llahut, ata nuk mund të krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të, e po ashtu, nëse miza ua rrëmben atyre ndonjë send, ata nuk do të mund ta shpëtojnë atë prej saj. I dobët

është edhe lutësi edhe i luturi. Ata nuk madhëruan All-llahun me madhërinë e Tij të vërtetë, që e meriton, All-llahu është i fuqishëm, ngadhënjyes. (Haxh: 73-74)

Idhujtaria paraqitet në forma të ndryshme. Meqenëse njerëzit përveç All-llahut i marrin qëniet tjera si perëndi, ata kërkojnë miratimin e tyre. Njerëzit i mbështesin shpresat e tyre në këto perëndi dhe i pranojnë gjykimet e tyre si të vërteta. Kjo është si njeriu bëhet i nënshtruar ndaj miliona perendive të imagjinuara. Ai shpresonë të gjejë ndihmë në këto qenie, të cilat janë të paafta sikurse ai. Mirëpo, ai që i shoqëron shokë All-llahut është në rrugë pa krye, e humbja e tij është, si pasojë, shumë e madhe. Ky fakt është shpallur në Kur'an:

....idhujtaria është padrejtësi më e madhe! (Lukman: 13)

Sidoqoftë duhet të thuhet se njeriu i tillë i bënë padrejtësi vetëvetës. Sepse "**All-llahu nuk u bën asgjë të padrejtë njerëzve, por ata i bëjnë të padrejtë vetes së tyre.**" (Yunus: 44)

KËRKIMI I KËNAQËSISË MË TË MIRË TË ALL-LLAHUT



Besimtarë është ai i cili është pastruar nga idhujtaria dhe të gjitha formave tjera të injorancës, siç janë vënja e shpresave në përendi të imagjinuara apo kërkimin e aprovimit të tyre, në këtë mënyrë bëhet i nënshtrueshëm ndaj tyre. Ai i shërben vetëm All-llahut dhe kërkon vetëm aprovimin e All-llahut. Siç u përmend më parë, e bënë këtë duke "bërë të gjithë përpjekjen e duhur."

Çelësi i "bërjes së tërë përpjekjes së duhur" në rrugën e All-llahut është me e kërkue atë më të cilën All-llahu është më së shumti i kënaqur. Përballë disa zgjidhjeve, të cilat të gjitha janë të ligjshme, besimtari duhet të zgjedhë më të cilën All-llahu është më së shumti i kënaqur.

Kjo shkurtimeisht mund të përshkruhet si në vijim:

◆ Besimtari duhet të kalojë tërë jetën e tij duke bërë çka është e "ligjshme." Kur'ani e qartëson se cilat veprime janë të paligjshme, dhe këto në të vërtetë janë shumë pak në numër. Çdo gjë tjetër përveç këtyre punëve të paligjshme është e ligjshme.

◆ Veç kësaj, çka besimtari duhet të bëjë është t'i kush-tojë vemendje punëve dhe mendimeve më të cilat All-llahu është më së shumti i kënaqur. Në këtë përpjekje, urtësia dhe "parashikimi" i tij e udhëzojnë atë.

Shembulli i "shpenzimit në rrugën e All-llahut" (faktikisht) do ta qartësojë këtë koncept. Besimtari është një person i cili ja ka shitur "pasurinë dhe vetveten" All-llahun. Ai duhet të vë çkado çoftë që ai ka në përdorim në rrugën më të cilën All-llahu është më së shumti i kënaqur. Mirëpo, ai shpesh mund të ndeshet me shumë zgjedhje. Le të supozojmë se ai ka një shumë të konsiderueshme të pareve me të cilat ai mund të blejë një komplet të ri për vete. Kjo në fakt është një punë e ligjshme dhe e pranueshme për të bërë; të qenurit i përpikët për dukjen e ndonjërit është sigurisht diçka në pajtim me dëshirën e All-llahut. Mirëpo, mund të ketë gjëra tjera për të bërë me këto para më të cilat All-llahu do të ishte më shumë i kënaqur. Dhënja përsonave nevojtarë mund ta kënaqë All-llahun më shumë. Mirëpo, ky është një vendim që mbështetet tërësisht me vetë personin. Konsiderimi i kushteve dhe rrethanave specifike në të cilat ai është, ai duhet të vendosë parësoret e tij duke konsultuar ndërgjegjëjen e tij.

Edhe një shembull do të mundësojë kuptimin ma të mirë të këtij koncepti. Besimtari është përgjegjës për "urdhërimin për mirë dhe ndalimin e të keqës," komunikimin e fesë së All-llahut dhe zbatimin e luftës në terren intelektual kundër tiranave në këtë botë. Mbajtja e tërë këtyre përgjegjësive shumë të rëndësishme është një rrugë për fitimin e kënaqësisë së mirë të All-llahut. Një përgjegjësi e tillë dmth se punët e caktuara gjithmonë marrin për-

parësi. Pasiqë ka shumë punë që kërkohen nga një përgjegjësie aq e rëndësishme, do të ishte gabim poqëse i ipet përparësi ndonjë pune tjetër, megjithëse është e ligjshme dhe e përshtatshme. P.sh, një njeri është përgjegjës për kujdesjen ndaj familjes së tij; ai është i cili furnizon sigurinë dhe ushqimin për anëtarët e familjes. Mirëpo, marrja e kësaj si shfajsim për me ju shmangur përgjegjësisë së "urdhërimit për mirë dhe nadalimin e të keqës" do të jetë sjellje e papërshtatshme për një besimtar.

Në të vërtetë ne mund të shohim në reflektim se "epshi"(nefsi) është i përfshirë kur ndonjëri preferon atë që është ma pak e çmuar në praninë e All-llahut. Preferimi i sendeve ma pak të çmuara ndaj atyre që janë më shumë të çmuara në praninë e All-llahut është një pasojë e mbetjes anash për një "pjesë" të shpirtit të ndonjërit. Në këtë kuptim, çka ndonjëri duhet të përmbush nuk është udhëzimi prej shpirtit të ndonjërit, por të punoj tërësisht në kërkimin e aprovimit të përgjithshëm të All-llahut. Kërkimi i pëlqimit të All-llahut me një përpjekje prej nëntëdhjetë e nëntë përqind dhe mbetja një përqind pjese anash për shpirtin mund të mos jetë e pranueshme në shikimin e All-llahut. Sepse personi në fjalë i ka shoqëruar shpirtin e tij All-llahut. Një përqindë e thjeshtë e idhujtarisë mund të shëndrrojë shërbimin e tij në të papranueshëm. Situata e atyre që i përshkruajnë shokë ndonjë gjallesë tjetër pos All-llahut është përshkruar si vijon:

Dhe nga ajo që krijoi Ai prej të lashtave dhe prej kafshëve shtëpiake, ata (idhujtarët) ndanë një pjesë për All-llahun dhe thanë: "Kjo është për All-llahun, si mendonin ata, e kjo është e idhujve tanë". Ajo që ishte për idhujt, nuk shkon te All-llahu, e ajo që është për

All-llahun, shkon te idhujt e tyre. Sa gjykim i shëmtuar është ai që gjykojnë (pjesën e idhujve e plotësonin nga ajo e All-llahut, në rast nevoje, e të All-llahut jo).

(En'am: 136)

Nëse një personë e rrezikon jetën për të mbrojtur familjen e tij në ndonjë ngjarje për ndonjë padrejtësi që i është bërë atij, por mbetet i pavëmendshëm me punën e tij kur ka shtypje dhe shpifje kundër besimtarëve të tjerë, ne mund të themi se ai nuk e kërkonë pëlqimin e All-llahut. Një qëndrim i tillë tregon preferimin dhe bindjen e njeriut ndaj shpirtit të tij (nefsit), i cili është tërësisht kundër qëllimit Islam për t'i "shërbyer vetëm All-llahut." Veç kësaj, veprimi në përputhshmëri me dëshirat e shpirtit është definuar në Kur'an si përskrim i shokëve All-llahut:

A e ke parë ti atë, që për zot e çmon epshin e vet, a mos do t'i bëhesh ti atij mbrojtës? (Furkan: 43)

Një besimtarë, në anën tjetër, i kushtonë tërë pasurinë e tij dhe tërë jetën e tij All-llahut. Kjo veti superiore e besimtarëve është e treguar në Kur'an si në vijim:

Thuaj: "Namazi im, kurhani im, jeta dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve. (En'am: 162)

Si për kërkimin e asaj më të clën All-llahu është më së shumti i kënaqur, qëndrimi i besimtarëve në kohën e luftës në ditët e pejgamberit (savs) është e shpallur në Kur'an. Përballë dy grupeve të armiqëve, besimtarët preferojnë të luftojnë kundër më të dobët. Por ishte dëshira e All-llahut që të jetë lufta kunder më të fortëve. Këto ndodhi janë të lidhura me ajetet në vijim:

Përkujtoni kur All-llahu ju premtoi njerën prej dy grupeve se është juaja, e ju dëshironit t'ju takojë ai (grup) i paarmatosur, ndërsa All-llahu dëshiroi që me prem-

timet e Tij ta vendosë të vërtetën, e të zhdukë në themel mbeturinën e mohuesve. Ta forcojë të vërtetën e ta çrrënjosë të kotën, edhe pse këtë e urrejnë kriminelët. (Enfal: 7-8)

Më në fund, All-llahu i bëri besimtarë të përballohën me anën më të fortë dhe i ka vënë ata në atë më të cilën Ai është më së shumti i kënaqur. Në fund, ata fituan me ndihmën e All-llahut.

Shembulli i treguar më lartë është një ndodhi e formuar brenda gjendjes së asaj kohe. Sidoqoftë fakti qendron se në çdo moshë muslimanët vëhen në sprovë nëpër ndodhi të ndryshme. Sot, p.sh, muslimanët duhet të angazhohen në luftë në fusha intelektuale kundër atyre që mohojnë Kur'anin dhe faktet e krijimit dhe të cilët përpiqen të ngjallin imoralitetin në shoqëri. muslimanët duhet të përcaktojnë drejtimin më të mirë për të pasuar në këtë luftë që e vëjnë vetën dhe pastaj të vazhdojnë atë me angazhim. Sidoqoftë, edhe nëse ndonjëri ka forcën për të marrë mbi vete këtë përgjegjësi, nesë ndonjëri e përfshinë vetën me çështje jo të urgjencës së madhe vetëm për të kënaqur dëshirat e veta, kjo vetëm do të shkaktojë pakënaqësinë e All-llahut.

Gjithsesi, një prirje e tillë nuk përputhet me ndjenjën e sjelljes së mirë të muslimanit. Ai është dikush që është zgjedhur nga All-llahu dhe të cilit i është dhuruar besimi; ai është përgjegjës për asgjesimin e keqbërjeve nga shoqëria, zëvendësimin e tyre me paqe, dhe themelimin e një ambient ku secili do të jetonte sipas fesë së All-llahut. Ai është përgjegjës që të luftojë për ata burra, gra dhe fëmijë të cilët janë të shtypur dhe të cilët thonë: **"Zoti ynë! nxirrna nga ky fshat (Meka), banorët e të cilit janë mi-**

zorë. Jepna nga ana Jote shpëtim e ndihmë!" (Nisa: 75)

Ky nocion nuk është i izoluar vetëm në luftën intelektuale. Gjatë gjithë jetës së tij, muslimani duhet të ruaj këtë pikëpamje në jetën e tij të përditëshme, në adhurimin e tij dhe në të gjitha ndodhitë që i hasë.

Ndërkohë, ne duhet të kemi ndër mend se shprehja, "bërja e asaj që më së shumti e pëlqen All-llahu" është përdorur për të bërë nocionin më të kuptueshëm. **Largim nga ajo që më së shumti e pëlqen All-llahu dhe ngatërrimi i vetës me çështje të rëndësisë dytësore është në fakt fyerje ndaj All-llahut.** Prandaj, një gjë që më së shumti e pëlqen All-llahu është, sipas të gjitha rrethanave, çka do që është në pajtim me dëshirën e Tij. Me fjalë tjera, nuk ka alternativë në atë që më së shumti e pëlqen All-llahu.

Mos kërkimi i asaj që më së shumti e pëlqen All-llahu, dhe kënaqja me pak, faktikisht është pasojë e kuptimit të dobët për ahiretin. Një kuptim i tillë është formuar për shkak se njëri mendon se ai e meriton Xhennetin. Mirëpo, askush nuk mund të jetë i sigurt për një shpërbtim të tillë. Në Kur'an, All-llahu e paralajmron edhe pe-jgamberin (savs) me ajetin, "**...e nëse dëshiron All-llahu ta mbyllë zemrën tënde...**"(shura: 24). Pasi ky është rasti, është e qartë se askujt nuk i është garantuar Xhenneti.

Sidoqoftë, besimtari i sigurtë, siç përshkruhet në Kur'an, kurrë nuk mendon se ai ose ajo padyshim e meriton Xhennetin apo të entuziasmohet me këtë ndjenjë. Besimtari i vërtetë në mënyrë tipike i lutet All-llahut me "**frikë dhe shpresë.**" (A'raf: 56)

Edhe ata që u mungon besimi i vërtetë mendojnë se e meritojnë Xhennetin për shkak se ata nuk i frikohen All-llahut si do të duhej dhe supozojnë se punët e tyre

janë të mira. Me meditimin e tyre me të meta, ata thonë, "Në çdo mënyrë ne do të jemi të falur." Mirëpo, kjo është sjellje e veçantë e atyre që nuk i kanë frikën All-llahut ashtu si duhet me pasë frikë nga Ai. Për situatën e këtyre njerëzve All-llahut thotë:

E pas tyre erdhi brezi që trashëgoi librin. Këta merrnin mjete të pavlerë të kësaj bote (lakmues që nuk dallonin të mirën a të keqen) e thonin: "Do të na bëhet falje", e merrnin atë përsëri. A nuk është marrë prej tyre zotimi në librin (Tevratin) se nuk do të thonë ndaj All-llahut tjetër pos të vërtetës dhe ata e dinim mirë se çka në të (libër). Po, a nuk po kuptoni se bota tjetër është më e mirë (se ajo çka merrnit ju) për ata që ruhen. (A'raf: 169)

Gjithashtu ka të tillë që të mashtruar nga pasuria materiale që u është dhuruar në këtë botë, vijnë në përfundim të gabuar se All-llahu i do ata, në këtë mënyrë besojnë se ata gjithashtu do të jenë të mirëseardhur në xhennet – edhe pse ata fshehin dyshime për ekzistimin e Tij. Kur'ani na jep neve një shembull relevant:

E ti sillu atyre (që kërkuan t'i largosh varfanjakët) si shembul dy njerëz; njërit prej tyre i dhamë dy kopshte (vreshta) nga rrushi dhe ato i rrethuan me hurma, e në mes atyre hurmave bimë tjera. Të dy kopshtet jepnin frutat e veta pa munguar prej tyre asgjë, e në mesin e tyre bëmë të rrjedhë një lumë. Ai kishte edhe pasuri tjetër. E ai atij shokut të vet (që ishte besimtar) i tha: - duke iu krenuar atij - "Unë kam pasuri më shumë se ti e, kam edhe krah më të fortë!" Dhe ai hyri në kopshtin e vet (e me besimtarin për dore), po duke qenë dëmtues i vetës (duke mos besuar dhe duke u krenuar) tha: "Unë nuk mendoj se zhduket kjo kurrë!" Dhe nuk besoj se

do të ndodhë kijameti, (dita e gjykimit), por nëse bëhet që të kthehem te Zoti im, padyshim do të gjej ardhmëri edhe më të mirë se kjo. (Kehf: 32-36)

Muslimani, përkundërazi ndaj njerëzve me mendime të tilla, i friksohet " largimit pasi që është udhëzuar në rrugën e drejtë." Lutja e besimtarëve në Kur'an është si në vijim:

Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi na drejtove, na dhuro mëshirën Tënde, pse vetëm Ti je dhuruesi i madh. (Al 'Imran: 8)

Mirëpo, gjithashtu vlenë të përmendet se kjo nuk është lloj i frikës që nxitë tmerrin apo shqetësim në zemrat e besimtarëve. Në të kundërtën, frika ndaj All-llahut i motivon besimtarët të kenë përkushtim në luftën që të bëhen robërit e All-llahut që e meritojnë hyrjen në Xhennet dhe sigurohen që të kalojnë jetën e kësaj bote në mënyrën më të mirë të mundshme.

Muslimani synon në fitimin e miratimit të All-llahut në jetën e kësaj bote, e që është e përkohshme dhe e shkurtë. Mendimet e tij koncentrohen në ngjarjen e vetme që do të ndodhë së shpejti: sigurisht se ai do të vdes një ditë dhe do të jap llogari për punët e tij në prani të All-llahut. Kjo do ta shpie atë ose në shkatërrim të tmerrshëm dhe të përherëshëm ose në shpetim të përherëshëm. Sigurisht do të ishte e pamatur që të ndjek disa drejtime tjera apo të qendroj i pavëmendshëm përderisa përpara tij është një ngjarje kaq e madhe.

Për shpëtimin e tij, besimtari është përgjegjës të kërkoj "atë që All-llahu më së shumti e pëlqen." Dështimi për të bërë këtë nënkupton të qenurit i pa vetëdijshëm për rrezikun që ka përpara. Përballë poshtërimit që ndonjëri

do ta takoj në ferr dhe në praninë e All-llahut, është e pa dyshimt e nevojshme të kërkohet "atë me të cilën All-llahu është më së shumti i kënaqur".

Disa shembuj për sjelljen që ndonjëri shfaq përballë rrezikut që mund të has në këtë botë dhe përpjekjet që i bën për t'i luftuar ato, do të shpiejn në kuptim më të mirë se si ndonjëri e kërkon atë që All-llahu më së shumti e pëlqen:

◆ Supozo se ti je përballë një përmbytje gjigant dhe niveli i ujit po rritet shpejt. Në këtë situatë, a do të kishe vrapuar ti në majën e ndërtesës dhjetë katëshe për të shpëtuar, apo do të qëndroje në katin e pestë dhe të thoje, "ky vend është mjaft lart që të më shpetoj"?

◆ Le të supozojmë se aty është ashensori që mund të të çoj në katin ma të lartë. Ky ashensor nuk është falas dhe do të punoj vetëm një herë. Ti ke pikërisht shumën e saktë të parave që të të çoj ty në katin më të lartë. A do të jepje ti të gjitha parat që i ke për të shkuar në katin më të lartë apo do të qëndroje në një kat më poshtë e që është i cenueshëm nga përmbytja?

◆ Prapë, le të supozojmë se në katin e gjashtë është duke u mbajtur një festë, ku ti je strehuar. A do të marrësh pjesë në festë apo do të tentoje që të gjesh rrugën për në katin më të lartë?

◆ Si shembull tjetër, le të supozojmë se njëri nga shokët e tu të ngushtë ka pasur sulm në zemër dhe ai ose ajo duhet menjëherë të dërgohet në dhomën urgjente. Në këtë situatë, a do të kishe vozitur sa më shpejt që të mundesh apo nuk do të kishe vozitur aq shpejt dhe do thoje, "kjo është mjaft shpejt, ai ose ajo duhet të mbahet."?

Siç është e qartë nga shembujt e mësipërm, përballë

rrezikut, njeriu bëhet syhapur dhe e jep maksimumin e tij për të shpëtuar. Kërcenimi më i madh për njerzimin është xhehnemi. Një nga qëllimet më të rëndësishme të personit që e kërkon atë që më së shumti e pëlqen All-llahu, është prirja e mbrendshme e tij për t' ju mënjatur këtij rreziku.

Për një moment, le të supozojmë se ti je në skaj të xhehennemit, rreth të cilit njerëzit do të grumbullohen në Ditën e Gjykimit dhe të dëshmojnë imazhin e tij trullës. Pasi që ke parë xhehennemin, a nuk do ta zgjedhëje ti prej shumë alternativa tjera atë që All-llahu më së shumti e pëlqen?

Posa të dërgohet një person në xhehennem, ai nuk do të ketë mundësinë më të zgjedh por do të jap llogari për veprimet e tij. Pasi ky është rasti, ndonjëri duhet tashmë të filloj të veproj në atë dritë. Në të vërtetë, besimtari gjithmonë vepron në dritën e idesë së afërsisë së xhehennemit, duke ditur se ai mund, në çdo moment, të shkoj në ahiret. Kur'ani në raste të shumta tërheq vëmendjen në faktin se çdo ndjenjë e pendimit në ahiret do të jetë e kotë. Një nga ajetet e ndërlydhura është si vijon:

Dhe ata do të klithin aty: "O Zot ynë, nxirrna e të bëjmë vepra të mira, e jo si ato që i bënim!" Po a nuk u dhamë juve jetë aq sa që ai ka dashur të mendojë, ka mundur të mendojë gjatë asaj kohe, madje juve u ka ardhur edhe peygamberi, pra shijoni, se për zullumqarët nuk ka ndonjë ndihmëtarë. (Fatir: 37)

Në anën tjetër, siku që ne përpigemi të largohemi prej rrezikut, ne ngjashëm duhet t'i kushtojmë madje edhe më shumë përpjekje për të arritur bekimet. Pa dyshim është e pamatur të kënaqemi me pas më pak në xhennet. Kur të

largoheni nga një ishull përplot me flori, a s'do të marrësh sa më shumë flori që është e mundëshme me veti? Kur të vjen koha për me u nda nga kjo botë, muslimani nuk duhet të ndiej pendim dhe të thotë, "dua që ta kisha bërë këtë e këtë" apo " dua që të kisha shtuar shpërblimet e bërjes së drejtë të punës së caktuar." Për me ju shmangur kësaj situatë, ai duhet të jetë i kujdesshëm që të zgjedh atë që All-llahu më së shumti e pëlqen.

Jobesimtarët mundohen maksimalisht që "të shfrytëzojnë" jetrat e tyre, e cila nuk është asgjë veçse "**një kënaqësi e pakët**" (Ali Imran: 197). Përderisa kjo "kënaqësi e shkurtë" është e dënuar me një përfundim të idhët, All-llahu për besimtarët premton miratimin, mëshirën dhe xhennetin e Tij. Besimtari, që dëshiron të ketë dobi nga këto premtime të All-llahut, duhet të përpiqet shumë që të kërkojë atë që më së shumti e pëlqen Ai.

Çelsi për miratimin e All-llahut: Ndërgjegjësja

Përballë disa zgjedhjeve, besimtari duhet të zgjedh atë të cilën All-llahu më së shumti e pëlqen. Në këtë, ndërgjegjësja është kriteri më i rëndësishëm që do ta udhëzoj atë në zgjedhjen e duhur. I Dërguari i All-llahut, peygamberi Muhammedi (savs) ka tërhequr vëmendjen për rëndësinë e ndërgjegjësjes gjatë bisedës me një njeri:

Një person e pyeti të dërguarin e All-llahut (savs): "çka është besimi?" Ai(savs) tha : "kur një vepër e mirë bëhet burim i kënaqësisë për ty dhe një vepër e keqe bëhet një burim i pakënaqësisë për ty, atëherë ti je besimtar." Ai prap pyeti të dërguarin e All-llahut: "çka është mëkati?" pas së cilës ai (savs) tha: " kur diçka therrë ndërgjegjësjen tënde, të heqesh dorë prej saj." (Tirmidhi)

Një nga ndryshimet më të rëndësishme ndërmjet besimtarit dhe jobesimtarit është se përderisa besimtari do të mbështetet në ndërgjegjëjen e tij, jobesimtari do të pajtohet me epshin e tij i cili inspiron për punë të këqija. Si pasoj, besimtari shfaq gjendjen më natyrale të tij kur ai e ndëgjon ndërgjegjëjen e tij.

Mirëpo, nuk është e vërtetë në asnjë mënyrë se besimtari është imun ndaj joshjeve të epshit të tij. Siç ka thënë pejgamberi Jusuf (as), "**...epshi është shumë nxitës për të keqen...**"(Jusuf: 53) Për këtë arsye, do të urdhëroj alternativa që janë kunder dëshires së All-llahut.

Besimtari i menjanon dredhitë e epshit të tij me anë të ndërgjegjëjes së tij. I përballur me një zgjedhje, besimtari fillimisht i drejtohet asaj që së pari i ndodhë, e cila zakonisht është ajo që më shumti e pëlqen All-llahu. Atëherë, epshi ndërhyt: mundohet që të bëjë alternativa tjera që duken më tërheqëse dhe gjen pretekst t'i legjitimoi ato. Besimtari duhet t'i mospërfill këto pretekte dhe të pajtohet me zgjedhjen fillestare dhe absolutisht korrekte në të cilën e drejton ndërgjegjëja atë.

Me dashuruar për hirë të All-llahut

Ajo (dhunti) konsiston në atë që All-llahu u jep myzhde robërve të vet, të cilët besuan dhe bënë vepra të mira. Thuaj: "Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim për thirrjen time vetëm se respektin e dashurisë për hir të farefisnisë (akraballëkut)". Kush bën ndonjë të mirë, Ne ia shumëfishojmë të mirat; vërtet, All-llahu falë mëkatet, është mirënjohës. (Shura: 23)

Besimtari ia kushton All-llahut tërë jetën e tij. Ai jeton,

punon dhe dashuron për hirë të All-llahun.

"Me dashuruar për hir të All-llahut" mund të jetë një koncept i pakuptueshëm për dikë që nuk është i njohur mirë me Islamin e vërtet. Njëri që ka mbetur i largët nga All-llahu gjatë gjithë jetës së tij, dhe prandaj nuk e ka njohur Atë, do të jetë i pavetëdijshëm se si duhet të dojë All-llahun në mënyrë intuitive.

Mirëpo, besimtari që e njeh All-llahun dhe e sheh mëshirën e Tij ndaj tij, i cili njeh se çdo gjë që ai donë është bekim i Tij dhe se ai i ka borxh ekzistencën dhe jeten e tij mëshirës së Tij, e don All-llahun dhe arrinë shpirtin fisnik që të dashuroj për hirë të All-llahut. Në këtë kuptim në Kur'an është treguar një diferencë e madhe ndërmjet besimtarëve dhe njerëzve tjerë si në vijim:

E nga njerëzit ka asish që në vend të All-llahut besojnë idhujt, që i duan (i madhërojnë) ata, sikur (që besimtarët e vërtetë e duan) All-llahun, po dashuria e atyre që besuan All-llahun është shumë më e fortë... (Bekare: 165)

Siç u tha në ajetin e mësipërm, ata të cilët në mendjet e tyre i shoqërojnë shokë All-llahut dhe që i përshkruajnë krijesave tjera vetitë e All-llahut, i duan këto krijesa si duhet ta duan All-llahun, dashuria e tyre është e bazuar në idhujtari.

Të vetëdijshëm se çdo gjë i takon All-llahu dhe se ekzistimi i çdo krijese është si pasojë e krijimit të All-llahut, besimtarët më së shumti e duan All-llahun. Kjo veçori e madhe, që është një rrjedhim i natyrshëm i njohjes së besimtarëve se All-llahu është Një dhe i Vetmi Zot, e bënë besimtarin të dallojë plotësisht nga njerëzit tjerë. Kjo cilësi e besimtarëve është shpallur në një nga thënjet e pejgam-

berit (savs) kështu:

"Kushdo që i ka tri sende e zbulon ëmbëlsinë e besimit: se All-llahu dhe i dërguari i Tij (savs) janë më të dashur për atë se çdo gjë tjetër, se ai e donë dikënd vetëm për hirë të All-llahut, dhe se ai e urren kthimin në mosbesim sikur do ta urrente të hudhet në zjarr."(Muslimi dhe Buhariu)

Ata që i shoqërojnë shokë All-llahut, nga ana tjetër, nuk mund të durojnë përkujtimin e All-llahut:

..E kur e përmend ti në Kur'an Zotin tënd, vetëm Atë, ata ikin mbrapa dhe largohen. (Isra': 46)

Megjithatë, është e vlefshme të përmendet se përkujtimi i All-llahut pranë idhujve të tyre nuk i shqetësonë idhujtarët. Arsyeshmëria e shprehur kështu: "Ne jemi musliman, por ne mund të kemi edhe kohën tonë" është në bazën e mendimit të tyre. Mirëpo, besimtari e kupton faktin vijues:

- Asgjë (të jetë qenie njerëzore, send apo ngjarje, etj.) nuk ka bukurinë e vet. All-llahu i krijon të gjitha sendet dhe u jep atyre bukuri. Pasi që një person, psh, nuk e ka përcaktuar dhe formuar vet fytyrën e tij apo saj, ajo bukuri është bukuri që i takon All-llahut.

- All-llahu i jep këtë bukuri njeriut, të cilin Ai e krijoj nga asgjëja, vetëm shkurtimisht (pasiqë ai person së shpejti do të plakët dhe do të vdes). Vetëm All-llahu posedon fuqinë për t'a rikrijua atë bukuri në ahiret, në një formë edhe më të përkryer.

- Si në rastin e qenieve njerëzore, të gjitha krijesat që meritojnë dashuri janë krijuar nga all-llahu dhe i ka bërë "të bukur." Për t'i përkujtuar njerëzit se pronari i vërtet i kësaj bukurie është All-llahu, Ai përcakton që bukuria e këtyre qenieve të shkatërrohet me vdekje dhe për-

fundimisht me ditën e gjykimit. Në ahiret, të gjitha krijesat do të rikrijohen.

Pasiqë është kështu, besimtari i do të gjitha sendet që ai i has në këtë botë, i vetëdijshtëm se të gjitha i takojnë All-llahut dhe sa ai do të takojë formën "origjinale" të bukurisë së tyre në ahiret. Si pasojë, dashuria e vërtetë e tij është për All-llahun, për të Vetmin i Cili e pajis atë me çdo gjë që ai donë: Ai është Pronari i vërtetë i çdo lloji të bukurisë.

Përkundër nocionit të dashuriës së bazuar në besimin në All-llahun që pëlqehet nga besimtarët, dashuria e jobesimtarëve është e bazuar në idhujtari. Në Kur'an, kjo formë e dashurisë është përshkruar me fjalët e pejgamberit Ibrahimit (as):

Ai (Ibrahimi) tha: "Ju përqaftuat, veç All-llahut, idhuj vetëm sa për bashkëjetesë mes jush në jetën e kësaj bote, e në ditën e kijametit (ndryshon gjendja) ju do të refuzoni njëri-tjetrin dhe do të mallkoni njëri-tjetrin; fundi juaj është zjarri, për ju nuk do të ketë ndihmëtarë". (Ankebut: 25)

Said Nursi, i njohur edhe si Bediuzzaman (çudia e moshës), një nga dijetarët më mëdhenjë Islam të shekullit 20^{të}, krahasoj këtë formë të dashurisë me atë të një njeriu që shikon në diell përmes një pasqyrëje që mban në dorën e tij. Posa që të thehet pasqyrëja në pjesë dhe drita më nuk reflektohet nepër të, njeriu ndien një shqetësim të thellë me humbjen e burimit të dritës. Mirëpo, ai nuk është mjaft i zgjuar që të kuptoj se drita në pasqyre nuk fillonë faktikisht nga ajo. Drita vjen nga dielli; pasqyret vetëm e reflektojnë atë.

Besimtari shfaq tërë dashurinë e tij për All-llahun. Me

e dashtë All-llahun është me i dashtë gjallesat, të vetëdijshëm se ato reflektojnë tiparet e All-llahut dhe se këto tipare në të vërtetë i takojnë Atij, si në rastin e pasqyrës.

Si pasojë, besimtari shfaq dashurinë e tij për All-llahun duke i dashur besimtarët që bëjnë që të "manifestohen" tiparët e All-llahut në sjelljen dhe drejtimin e tyre, dhe të cilët shfaqin vlerat morale të parashikuara si të mira nga All-llahu. Kjo formë e dashurisë nuk është e bazuar në faqefisni, racë apo çfarëdo lloj të interesit. Në sajë të dashurisë të ndier për All-llahun, është vetëm një çështje e dashjes se atyre që e dojnë All-llahun. Në Kur'an, Zoti ynë e përshkruan dashurinë ndërmjet besimtarëve duke ju referuar dashurisë ndërmjet shokëve të pejgamberit (savs) në kohën e tij:

Edhe ata që përgatitën vendin (Medinën) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin te ata dhe nuk ndiejnë në gjoksat e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar. (Hashr: 9)

Kur'ani e qartëson se dashuria e ndier për besimtarët u është dhuruar posaqerisht atyre nga All-llahu:

Nuk ka dshim se ata që bënë vepra të mira, atyre i Gjithëmëshirshmi do t'u krijojë (në zemrat e tyre) dashuri. (Merjem: 96)

O Jahja, merre librin me shumë kujdes, dhe ashtu, Ne i dhamë atij urtësi kur ishte fëmijë. Dhe nga ana jonë i mundësuam të jetë i butë, i pastër dhe respektues (i dëgjueshëm). (Merjem: 12-13)

Besimtarët e duan vetëm All-llahun dhe ata që i besojnë Atij. Pasi ky është rasti, ata nuk kanë dashuri për askënd që ngritët kundër All-llahut. Kjo temë është theksuar në ajetet vijuese të Kur'anit:

O ju që besuat, nëse keni dalë (prej vendlindjes) për hirë të luftës për rrugën Time, duke kërkuar kënaqësinë Time ndaj jush, mos e zini mik armikun Tim dhe armikun tuaj, duke shprehur ndaj tyre dashuri, kur dihet se ata mohuan të vërtetën që u erdhi juve. Ata e dëbojnë të dërguarin dhe ju, sepse i besoni All-llahut, Zotit tuaj, e ju fshehurazi u ofroni miqësi, po Unë më së miri e di atë që e keni fshehur dhe atë që e keni publikuar. Ai që punon ashtu nga pala juaj, ai e ka humbur rrugën e drejtë. (Mumtehine: 1)

Ju e keni shembullin më të mirë te Ibrahimimi dhe te ata që ishin me të, kur i thanë popullit të vet: "Ne tërhiqemi prej jush dhe prej asaj që adhuroni, pos All-llahut, nuk besojmë tuajën, prandaj ndërmjet nesh e jush është e hapët armiqësia e urrejtja derisa ta besoni vetëm All-llahun Një!"... (Mumtehine: 4)

O ju që besuat, mos u ofroni miqësi (dashuri) prindërve tuaj, as vëllezërve tuaj, nëse ata vlerësojnë mosbesim kundër besimit. E kush prej jush miqësohet me ta, ata janë mizor. (Tewbe: 23)

Nuk gjen popull që e beson All-llahun dhe ditën e gjykimit, e ta dojë atë që e kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre... (Muxhadele: 22)

Siç e qartësuan ajetët e mësipërme, dashuria e besim-

tarit nuk mbështetet në asnjë kriter tjetër përveç "dashurisë së ndier për All-llahun." Menjanimi i të gjithë faktorve siç janë farefisnia apo pasuria materiale, kjo dashuri është e rrënjosur thell në besim dhe vlera fisnike. Besimtari ka dashuri për ata besimi i të cilëve është i sigurtë, më parë se për ata që kanë famë, para apo pozitë sociale, të cilët vetëm duken se janë të rëndësishëm.

Pasiqë i ka pastruar ndjenjat e tij të dashurisë ndaj faktorve tjerë përveç "dashurisë së ndier për All-llahun," besimtari e do atë që i friksohet All-llahut më së shumti dhe i cili është më i vëmendshëmi në kërkimin e kënaqësisë së All-llahut. Sa më shumë që ndonjëri ka tipare tipike të besimtarit, më shumë është i dashur nga besimtarët. Edhe në Kur'an, ne shohim se besimtarët e kanë më të dashur pejgamberin (savs)- atë që është më së afërmi All-llahut dhe atë që më së shumti i frikësohet All-llahut:

Pejgamberi është më i ndishëm ndaj besimtarëve se sa ata ndaj vetë vetvetes së tyre... (Ahzab: 6)

Meqenëse kuptimi i dashurisë së një besimtari bazohet në besim, ai do të vendosë martesën e tij në bazë të njejtë. Në këtë pikë, gjithashtu, shfaqet një dallim shumë i rëndësishëm ndërmjet besimtarëve dhe jobesimtarëve: jobesimtarët shpesh e themelojnë martesën e tyre në përfitime materiale të dyanshme. Kjo është posaçërisht e vërtetë për femërat, të cilat mundohen me gjetë një "burrë të suksesshëm" me shpresë në nivelë të lartë të jetesës. Për një synim të tillë, një vajzë e re lehtë mund të pajtohet që të jetë grua e përjetshme e dikujt për të cilin nuk ka aspak dashuri. Kjo është, në të vërtetë, e ngjashme me një marrëveshje tregtare nga e cila te dy palët nxjerrin përfitime. Ndryshimi i vetëm është se kjo marrëveshje pretendohet

të jetë e përjetshme.

Shembujt e martesave të tilla janë mizorike. Ka shumë të rinjë që martohen me njerëz që janë të pasur apo të vjetër apo të cilët janë të njohur për imoralitetin e tyre, vetëm për shkak se ata janë pasanik apo të famshëm.

Martesat e jobesimtarëve nuk janë gjithmonë të bazuara krejtësisht në përfitime materiale. Gjithashtu ka shumë të rinjë që kërkojnë "pamje të bukur" ose tërheqëshmëri në personi me të cilin donë të martohen. Femrat e tilla martohen me njerëz që nuk kanë tjetër pos bukurisë fizike, të cilët ato i supozojnë si "fisnik në kali të bardhë."

Sidoqoftë persiatja prapa kësaj pikëpamje lë pas dore një fakt vendimtar: tërë këto veçori fizike janë të dënuara që përfundimisht të shkatërrohen. Eventualisht të gjitha qeniet njerëzore do të plakën. Veç kësaj, All-llahu në një moment mund të merr pasurinë, pamjen e bukur apo shëndetin e një njeriu. Njësoj, s'nevojiten më shumë se disa sekonda për të ndodhur një aksident dhe njëri të mbetet i paralizuar, i shtrirë në shtratë apo të humbë pamjen e bukur. Në këto rrethana, çka do të bëhej me një martesë të tillë?

Çfarë do të bënte një grua kur burri i sajë të verbohet në një aksident, psh, nëse ajo është martuar me të për shkakun se ai ka pasur sy të bukur? Ajo sigurisht vetëm atëherë do të kuptoj paarsyeshmerinë e bazës në të cilën ka mbështetur vendimin më të rëndësishëm të sajë.

Besimtari synon xhennetin e përhershëm në ahiret. Jeta e tij është e caktuar për të fituar miratimin e All-llahut dhe për të arritur "shpëtim dhe lumturi." Pasiqë i ka përkushtuar tërë lutjet dhe jetën e tij All-llahut, sigurisht ai do t'i përkushtoj edhe martesën e tij Allahut.

Hyrja në martesë për të fituar miratimin e All-llahut sigurisht është tërësisht ndryshe nga martesja e bazuar në "idhujtari." Në martesë të tillë, kriteri assesi nuk mund të jetë paraja, fama apo bukuria. Qellimi i vetëm në martesë do të jetë fitimi i miratimit të All-llahut. Besimtari i vërtetë do të dojë që të martohet me dikënd që do të jetë më e dobishme në bërjen e atij dhe asaj që të fitojnë miratimin e All-llahut. Si pasoj, ai ose ajo martohet me një person të tillë kur shfaqë një besnikri të thellë ndaj All-llahut dhe është më i miri në besim dhe devocion (takwa).

Për arsyen e përshkruar më sipër, gra të caktuar që kanë jetuar gjatë kohës së peygamberit Muhammedit (savs), kanë shprehur dëshirën të martohen me peygamberin (savs). Ato që parapëlqyen ndryshe janë përshkruar në Kur'an si dëshiruese të "jetës së botës dhe stolive të saj":

O ti peygamber, thuaju grave tuaja: "Në qoftë se lakmoni jetën e kësaj bote dhe stolitë e saj, atëherë ejani: unë po ju jap furnizimin (për lëshim) dhe po ju lëshoj ashtu si është e rrugës. E në qoftë se e doni All-llahun, të dërguarin e Tij dhe botën tjetër, atëherë të jeni të sigurt se All-llahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato prej jush që bëjnë punë të mira." (Ahzab: 28-29)

Vetitë e besimtarëve

Ndonjëri që jeton sipas Kur'ani do t'i dojë edhe ata që jetojnë sipas Kur'anit, d.m.th, besimtarët. Në saj të besimit të tyre në All-llahun, besimtarëve u janë dhuruar disa veti që i bëjë ata të vlefshëm për t'i dashur. Një besimtarë do të kërkoj këto veti edhe në besimtarët tjerë dhe duke parë këto veti në ta, ai do t'i do ata.

Këto në vijim janë vetitë e dukshme të besimtarëve siç

shpjegohen në Kur'an:

- Besimtarët i shërbejnë vetëm All-llahut, ata nuk i shoqërojnë Atij asnjë send në mendjet e tyre. (Fatiha: 1-7; Nisa': 36)

- Ata i frikohen All-llahut, ata largohen nga bërja e çdogjëje që All-llahu e ka ndaluar apo që është e kundërt me dëshirën e All-llahut. (Ali Imran: 102; Ja Sin: 11; Tegabun: 16; Zumer: 23)

- Ata shpresojnë vetëm në All-llahun. (Bekare: 249; Tewbe: 25-26)

- Ata nuk i frikohen askujt përpos All-llahut. (Ahzab: 39)

- Ata gjithmonë ndihen mirënjohës ndaj All-llahut, përparimi apo mjerimi nuk i bënë ata të jenë lavdërues apo të ndejnë keqardhje për vete. (Bekare: 172; Isra': 3; Ibrahim: 7)

- Ata kanë siguri në besimin e tyre, mendimi për me u largua nga fitimi i miratimit të All-llahut as që vjen nder mend atyre. Ata vazhdimisht i kryejnë shërbimet e tyre me përkushtim dhe vrull gjithnjë më të rritur. (Huxhurat: 15; Bekare: 4)

- Ata janë të bindur në Kur'an, ata i riorjentojnë të gjitha punët e tyre në pajtim me pozitën Kur'anore. Ata menjëherë nuk e njohin si të tyren një qendrim pasi që të kuptojnë se ai nuk është në pajtim me mësimet Kur'anore (A'raf: 170; Maide: 49; Bekare: 121)

- Ata e përmendin All-llahun vazhdimisht, ata e dinë se All-llahu është gjithmonë Dëgjuesi dhe Shikuesi i çdogjëje, dhe gjithmonë e kanë në mendje fuqinë e patundëshme të All-llahut. (Ali Imran: 191; Rra'd: 28; Nur: 37; A'raf: 205; Ankebut: 45)

● Ata e dinë dobësinë e tyre përballë All-llahut. Ata janë të kokëulur. (Mirëpo, kjo nuk nënkupton se ata janë të dobët dhe kështu të çfaqin qendrimet e pasigurta ndaj njerëzve.) (Bekare: 286; A'raf: 188)

● Ata e dinë se asgjë nuk do të u ndodhë atyre, përveç asaj që All-llahu e ka urdhëruar. Ata nuk bëhen shumë të tendosur për asgjë dhe gjithmonë mbesin të qetë dhe i vënë shpresat e tyre në All-llahun. (Tewbe: 51; Tegabun: 11; Junus: 49; Hadid: 22)

● Ata kthehen nga ahireti; caku kryesor i tyre është ahireti. Ata edhe përfitojnë nga të mirat e botës dhe dëshirojnë një vend në këtë botë shumë të ngjashëm me xhenetin. (Nisa': 74; Sad: 46; A'raf: 31-32)

● Ata i marrin si shokë dhe të afërt të tyre vetëm All-llahun dhe besimtarët (Maide: 55-56; - al-Muxhadele: 22)

● Ata janë njerëz të pajisur me kuptim. Kurrë nuk e humbin adhurimin apo ndërgjegjëjen e tyre, ata mbesin të kujdesshëm dhe syhapur në çdo moment. Ata gjithmonë kryejnë shërbimet të cilat janë në interes të besimtarëve dhe fesë. (Mu'mininun: 54; Zumar: 18)

● Ata luftojnë deri në shkallën më të lartë në rrugën e All-llahut. Ata luftojnë me jobesimtarët në fusha intelektuale, posaçërisht me udhëheqësit e mosbesimit. Ata kurrë nuk ndihën të pashpresë apo guxim-dobët në këtë luftë. (Enfal: 39; Haxhxh: 78; Huxhurat: 15; Tewbe: 12)

● Ata nuk ngurrojnë të thonë të vërtetën. Ata nuk shmangen nga thirrja në të vërtetën për shkak të frikës nga të tjerët. Ata nuk i kushtojnë vëmendje talljeve dhe sulmimeve të refuzuesëve ndaj tyre dhe janë të patrembur nga kërcënimet njerëzore. (Maide: 54, 67; A'raf: 2)

● Ata përdorin metoda të ndryshme për të bartur

porosinë e All-llahut dhe për të thirrë njerëz në fenë e All-llahut. (Nuh: 5-9)

- Ata nuk i shtypin të tjerët. Ata janë të mëshirshëm dhe të dhembshëm. (Nahl: 125; Tewbe 128; Hud: 75)

- Ata nuk e humbin kontrollin me zemrimin e tyre; ata janë tolerant dhe zemërbutë. (Ali Imran: 134; A'raf: 199; Shu'ara: 40-43)

- Ata janë njerëz të besueshëm. Ata i impresionojnë njerëzit me personalitetin e tyre të fortë dhe i bëjnë të ndjejnë sesa janë besnikë. (Duhan: 17-18; Tekwir: 19-21; Maide: 12; Nahl: 120)

- Ata janë akuzuar se janë magjistarë ose të çmendur. (A'raf: 132; Junus: 2; Sad: 4; Hixhr: 6; Kamer: 9)

- Ata janë të nënshtruar ndaj shtypjes. (Shu'ara: 49; 167; Ankebut: 24; Ja Sin: 18; Ibrahim: 6; Neml: 49, 56; Hud: 91)

- Ata janë këmbëngulës përballë fatkeqësisë. (Ankebut: 2-3; Bekare: 156, 214; Ali Imran: 142, 146, 195; Ahzab: 48; Muhammed: 31; En'am: 34)

- Ata nuk frikësohen nga shtypja ose vdekja. (Tewbe: 111; Ali Imran: 156-158, 169-171, 173; Shu'ara: 49-50; Saffat : 97-99; Nisa': 74)

- Ata janë të sulmuar dhe të komplotuar nga jobesimëtarët; ata janë të përqeshur. (Bekare: 14, 212)

- Ata janë nën mbrojtjen e All-llahut. Të gjitha komplotet e sajuara kundër tyre dalin si të pavlera. Allahu i mbronë ata ndaj të gjitha përgojimet e komplotet, dhe i lartëson ata. (Ali Imran: 110-111, 120; Ibrahim: 46; Enfal: 30; Nahl: 26; Jusuf: 34; - Haxh: 38; Maide: 42, 105; Nisa': 141)

- Ata janë në vetëmbrojtje kunder jobesitarëve. (Nisa':

71, 102; Jusuf : 67)

- Ata e trajtojnë si armiqë djallin dhe pasuesit e tij. (Fatir: 6; Zuhruf 62; Mumteine: 1; Nisa': 101; Maide: 82)

- Ata luftojnë me hipokritët. Ata nuk shoqërohen me njerëz që shfaqin veti hipokrite. (Tewbe: 83, 95, 123)

- Ata e parandalojnë tiraninë e refuzuesëve. (Ahzab: 60-62; Hashr: 6; Tewbe: 14-15, 52)

- Ata veprojnë duke u konsultuar në mes veti. (Shura: 38)

- Ata nuk mahnitën me jetën tërheqëse të jobesimtarëve. (Kaf: 28; Tewbe: 55; Surah Ta Ha: 131)

- Ata nuk janë të impresionuar nga pasuria ose pozita. (Haxh: 41; Kasas: 79-80; Nahl: 123)

- Ata çdo veprim të adhurimin e praktikojnë në mënyrën më të mirë. (Bekare: 238; Enfal: 3; Mu'minun: 1-2)

- Ata nuk e pasonjë shumicën, por më parë kriterin që e ka dhënë Allahu. (En'am: 116)

- Ata përpiqen që të afrohen sa më afër Allahut, dhe të shërbejn si shembuj të mirë për ata që besojnë. (Maide: 35; Fatir: 32; Wakia: 10-14; Furkan: 74)

- Ata nuk janë të ndikuar nga djalli. (A'raf: 201; Hixhr: 39-42; Nahl: 98-99)

- Ata nuk i pasojnë prindërit e tyre verbërazi. Ata veprojnë në pajtim me mësimet kur'anore. (Ibrahim: 10; Hud: 62, 109)

- Ata nuk lejojnë keqtrajtimin e grave. (Nur: 4; Talak: 6; Bekare: 231, 241; Nisa': 19)

- Ata i shmangen shpenzimeve të tepërta. (En'am: 141; Furkan: 67)

- Ata e ruajnë patërtinë e tyre, martohen dhe i drejto-

jnë jetrat e tyre martesore në mënyrën si dëshiron All-llahu. (Mu'minun: 5-6; Nur: 3, 26, 30; Bekare: 221; Maide: 5; Mumteine: 10)

- Ata janë të matur derisa e praktikojnë adhurimin e tyre. (Bekare: 143; Nisa': 171)

- Ata janë njerëz vetëflijuës. (Insan: 8; Ali Imran: 92, 134; Tewbe: 92)

- Ata janë të kujdesshëm që të jenë të pastërt. (Bekare: 125, 168; Mudeththir: 1-5)

- Ata i kushtojnë rëndësi estetikës dhe artit. (Sebe': 13; Neml: 44)

- Ata nuk i përjojnë ose shpifin besimtarët. (Huxhurat: 12)

- Ata i shmangen xhelozisë. (Nisa': 128)

- Ata kërkojnë falje nga Allahu. (Bekare: 286; Ali Imran: 16-17, 147, 193; Hashr: 10; Surah Nuh: 28)

Shtypja ndaj besimtarëve

Vetitë e besimtarëve të shpallura më lartë, në të vërtetë janë dy llojesh:

Lloji i parë janë ato të cilat besimtarët i shfaqin me vullnetin e tyre; të qenurit një rob i All-llahut, vetëflijimi, dhe thjeshtësia mund të citohen midis tyre.

Lloji i dytë, megjithatë, janë ato të cilat ata i shfaqin në çështjet përtej kontrollit të tyre, psh, kompletet e sajura kunder tyre apo të qenurit objekt talljeje nga besimtarët. Në të vërtetë, këto janë shumë të rëndësishme për të mundësoar identifikimin e besimtarit të sinqertë. Kjo është për shkak se shumë nga vetitë e shfaqura nga besimtarët janë të natyrës së "imitueshme." Psh, një hipokrit mund gjithashtu të ushtroj çdo akt të adhurimit apo të

bëjë flijime, më kushtë që ai të fitoj nga kjo. Por vetitë e shfaqura në situata përtej kontrollit të tyre janë të "pa-imitueshme" psh, kur jobesimtarët i nënshtrojnë besimtarët e sinqertë me shtypje.

Pasi që është kështu, këto veti rrisin rëndësinë e madhe në vlersimin e besimtarëve nga ndonjëri. Për të kuptuar nëse një shoqëri është shoqëri e besimtarëve të sinqertë duhet të mirren në konsiderim këto kritere, ligjet e pandryshueshme të All-llahut siç shpjegohen në Kur'an.

Përderisa vlerësohen shtypja dhe shpifjet verbale kundër muslimanëve, ndodhitë që u ndodhën muslimanëve në të kaluarën duhet të jenë pikë referenca jonë. Në këtë kuptim, Kur'ani jep një llogari për vështirësitë dhe shpifjet që i hasën muslimanët e hershëm.

Apo ju menduat se do të hyni në Xhennet, pa u provuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush?... (Bekare: 214)

Në ajetët të cilat kanë të bëjnë me "testimet që erdhen te ata që vdiqën në të kaluarën", ne hasëm një pikë që vlenë të përmendet. Armiqët e pejgamberve dhe besimtarëve nuk thonë: "këta njerëz besojnë në All-llahun dhe kërkojnë miratimin e Tij" apo "këta nuk janë si ne amoral, ata posedojnë vlera fisnike." Në të kundërtën, ata përipiqen që t'i përgojnë besimtarët dhe t'i akuzojnë ata në formën më të pahijshme.

Sigurisht, ata nuk do të guxonin të thonin: "ne jemi kryengritës kundër All-llahut dhe ne nuk zbatojmë asnjë kufi moral; ne vetëm duam t'i shtypim këta njerëz të cilët nuk shërbejnë për të fituar ne." Do të ishte e pamatur me pritë që këta njerëz të bëjnë pranime si: "këta janë njerëzit të cilët i zbatojnë urdhërat e All-llahut, ndersa ne jemi

mëkatar." Në të kundertën, ata do të përpiqen me i legjitimue shpifjet e tyre duke i paraqitur besimtarët të rrëzikshëm dhe duke prezentuar veten e tyre si njerëz "modest dhe të ndershëm." Në tregimet e ndërlidhura në Kur'an, ne shohim metodat e njëjta të përdorura kunder besimtarëve në të kaluarën.

Psh, pejgamberi Nuh (as) – si të gjithë pejgamberet tjerë— e ftoj popullin e tij që t'i shërbejnë vetëm All-llahut. Një sistem i vendosur në bazën e shërbimit vetëm All-llahut sigurisht e ka penguar përparimit e interesave të udhëheqësve të shoqërisë, të cilët siguruan pasuri dhe pozitë përmes sistemit të mosbesimit. Sigurisht këta udhëheqës nuk do të pajtoheshin të thonin se çka Nuhu (as) kërkonte nuk ishte në interesin e tyre. Përkundrazi, ata e akuzuan atë për kërkimin e interesit të tij—"pozitë dhe autoritet." Kur'ani jep një shpjegim të kësaj situate në vijim:

Ne e patëm dërguar Nuhun te populli i tij, e ai u tha: "O populli im, adhurojeni vetëm All-llahun, se nuk ka zot tjetër pos tij; a nuk i frikësoheni (dënimin)?" E paria e atij populli që nuk besuan thanë: "Ky nuk është tjetër pos njeri sikurse edhe ju, po dëshiron të jetë më i lartë se ju..." (Mu'minun: 23-24)

Pejgamberët Musa (as) dhe Haruni (as) janë vënë në të njëjtin akuzim. Faraoni dhe rrethi i ngushti i tij u thanë atyre: "Ata thanë: "Mos erdhe të na largosh nga ajo (feja) që e gjetëm te prindërit tanë, për t'ju mbetur ju dyve madhështia në tokë? Po ne nuk u besojmë juve dyve." (Junus: 78)

Shpifjet e bëra kunder besimtarëve mund të arrijnë një shkallë të papërfytyrueshme. Gjatë gjithë historisë të dërguarit e All-llahut kanë qenë të akuzuar për "magjepsëjen

dhe mashtrimet" e besimtarëve rreth tyre:

Ata pastaj (pas bisedës së fshehur) thanë: "Këta të dy janë magjistarë, që me magjinë e tyre duan t'ju nxjerrin nga toka e juaj dhe ta zhdukin drejtimin (ideologjinë) tuaj që padyshim është më i drejti". (Surah Ta Ha: 63)

... e mosbesimtarët thanë: "Ky është magjistar, rrenës". (Sad: 4)

Ambicjet kryesore të atyre që i përgojnë muslimanët është të paraqesin një pamje të një muslimani i cili ka vese të njëjta sikur që vetë ata i shfaqin. Kjo shkoi në gjatësi aq të mëdha sa që ata guxuan të thonë për pejgamberin fisnik Nuh (as):..."**ai është një gënjeshtar mendjemadh!**" (Kamer: 25).

Një shpifje tjetër në të cilin besimtarët vëhen shumë shpesh është ajo e "marrëzisë." Në të vërtetë, dështimi i jobesimtarëve që të kuptojnë një shpjegim të arsyeshëm e të rëndësishme në llogari të besimtarëve për këtë shpifje. Duke mos pasur asnjë koncept për "fitimin e miratimit të All-llahut," jobesimtarët kanë vështirësi që të kuptojnë veprimet e besimtarëve që janë të drejtuara vetëm në këtë qëllim. Ata dështojnë të kuptojnë pse besimtarët, të cilët siç duket nuk kërkojnë interes për shërbimet që ata i bëjnë, i përkushtojnë jetët e tyre All-llahut. Në sytë e tyre, një qëndrim i tillë idealist nuk mund të jetë tjetër pos "marrëzis." Gjatë gjithë historisë, ata shpesh e kanë përdorur këtë shpifje. Për pejgamberin Musa (as) Faraoni ka thënë: "**Vërtet, i dërguari juaj që u është dërguar juve, me siguri është i çmendur!**" (Shu'ara: 27) Gjithashtu, kur e kanë refuzuar pejgamberin Nuh (as) populli i tij ka thënë: "**ai është i marrë!**" (Kamer: 9).

Duke lënë këto anash, besimtarët kanë qenë të

akuzuar edhe për shkelje të kurorës. peygamberi Jusufi (as) dhe Merjemja, të mirren shembull kryesor për të gjithë burrat dhe gratë besikë, janë njerëz fisnik të cilët ishin të vënë në këtë shpifje. Gjithashtu, jobesimtarët i akuzuan shumë peygamber për: "**plotësisht të humbur.**" (A'raf: 60).

Por nuk do të ishte e drejtë të supozojmë se tërë këto ndodhi i përkasin të kaluarës. Kur'ani na informon neve se edhe besimtarët e tjerë mund të kenë përvoja të njëjta. Prandaj, secili besimtar që përkrah fenë e vërtetë, është i cenueshëm nga akuzimet dhe shpifjet e njëjta.

Ne duhet ta kemi para sysh se çfarë jobesimtarët përhapin për muslimanët mund të jetë pjesë e një fushate të tillë shpifëse. Siç udhëzonë Kur'ani, përpara hulumtimeve të gjëra, ne duhet të shmangemi që të besojmë në lajme të tilla të përhapura nga "devijuesit." Për këtë All-llahu na paralajmëron neve në vijim:

O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, ashtu që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë. (Huxhurat: 6)

JETA NË SHOQËRINË E INJORANCËS



Në pjesët e më përparme, ne përmendëm se ndryshimet kryesore ndërmjet besimtarëve dhe jobesimtarëve është vetëdija e mëparshme në fuqinë e pakufi të All-llahut. Ne folëm edhe se si një besimtarë, i cili është i vetëdijshëm për ekzistimin e All-llahut, duhet të orientojë tërë jetën e tij për të fituar miratimin e All-llahut.

Një nga karakteristikat më domethënëse të dikuj që mund të çmoj fuqinë e All-llahut dhe kështu t'i orientojë tërë veprat e tij për fitimin e bekimit të All-llahut, është të liroj veten nga të gjitha krijesat tjera pos All-llahut. Duke përqendruar jetën e tij në fitimin e miratimit të Tij dhe duke qenë një robë i Tij, ai zhvillon një pikëpamje të ndryshme në univers, i cili ai e din se është krijuar dhe i kontrolluar nga All-llahu. Pasi ai e konsideron All-llahun si të vetmin zot, zotërat jo të vërteta që e rrethojnë atë e humbin kuptimin e tyre.

Në Kur'an, kjo temë është theksuar në tregimin për peygamberin Ibrahim (as) që i është shpallur peygamberit

Muhammedit (savs):

... Ai vërtet ishte shumë i drejtë dhe peygamber. Kur babait të vet i tha: "O babai im, pse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh, e as nuk ke asgjë prej tij"?
(Merjem: 41-42)

Pasi që besimtari kërkonë vetëm kënaqësin e All-llahut, i falet Atij, dhe vetëm Atij i lutet, ai është bërë "i pavarur" nga të gjitha gjallesat e krijuara. Ai nuk e ndien nevojën që të kërkojë kënaqësinë e njerëzve tjerë, dhe nuk i mbështet shpresat e tij në dikën tjetër përpos All-llahut. Arritja e lirisë së vërtetë është, në të vërtetë, e mundshme vetëm duke pasur kuptim të plotë në këtë fakt dhe duke ju mbështetur All-llahut.

Jeta e atyre që ju mungonë besimi i vërtet, ndryshe nga ajo e besimtarëve, është të nënshtruarit shumë perendive të rrejshme. Njerëzit e tillë e përkushtojnë tërë jetën e tyre që të arrijnë miratimin e njerëzve të panumërt, dhe kur kërkojnë ndihmë, e kërkojnë prej njerëzve tjerë. Në realitet, megjithatë, krijesat që një jobesimtar i adhuron në mendjen e tij nuk janë asgjë përveç "robë" të dobët, njëjtë sikur ai. Në të vërtetë, këto krijesa janë largë nga përm-bushja e dëshirave të tij, më largë nga shpëtimi i tij. Vdekja është, pa dyshim, fakti më i qartë në zbulimin se këto krijesa që adhurohen nuk mundën në asnjë mënyrë që t'iu ndihmojnë. Mirëpo, do të ishte shumë vonë që të pritët vdekjen për të kuptuar natyrën joreale të këtyre përendive.

Situata pa rrugdalje në të cilën këta njerëz gjinden është shpallur në Kur'an në vijim:

Po, shkojnë e në vend të All-llahut adhurojnë zota të tjerë me shpresë se do të ndihmohen prej tyre. Ata nuk

mund t'u ndihmojnë atyre, por këta (idhujtarët) u janë bërë ushtri e gatshme e tyre. (Ja Sin: 74-75)

Jobesimtarët e bazojnë tërë jetën e tyre në këtë arsye të shtrembëruar. Nga kjo shfaqet edhe një ndryshim tjetër i rëndësishëm ndërmjet besimtarëve dhe jobesimtarëve: besimtarët i pranojnë kriteret e zbritur nga All-llahu si udhëzim të tyre. Ata i zbatojnë urdhërat e Kur'anit, Librit të saktë dhe Sunetin e pejgamberit (savs). Feja e tyre është Isalmi, e cila është shpjeguar detajisht në Kur'an dhe është prezentuar te ne përmes jetës shembullore të pejgamberit (savs).

Njerëzit që i jetojnë jetrat e tyre në një gjendje të pavëmendshëm për All-llahun sigurisht më parë do të pranojnë kriterët e vëna nga perënditë e imagjinuara se kriterët e dërguara nga All-llahu. Ndryshe nga Islami, ligji i vetëm dhe i përhershëm i All-llahut, feja e tyre është politeizmi. Këta njerëz kanë rregulla kontradiktore dhe qëllime të ndryshme të imponuara nga shoqëria. Pasi ky është rasti, fetë politeiste veprojnë duke përdorë forma të ndryshme.

Disa nga ata synojnë fuqi dhe para, ndërsa të tjerët dëshirojnë një pozitë me autoritet dhe me ndikim të madh. Disa aspirojnë që të gjejnë një "grua të mirë" dhe të kenë një "jetë të lumtur familiare." Kjo shumëllojshmëri që shkakton lloje të ndryshme të jetës dhe prandaj fe të ndryshme është, faktikisht, e bazuar në dështim për të kuptuar ekzistencën e All-llahut dhe kufijt e Tij.

Mirëpo, njeriu është, nga natyra, i prirur t'i besoj All-llahut dhe të jetë rob i Tij. I paaftë në përmbushjen e nevojave të pakufi të tij dhe dëshirat nga vetja, nga natyra, ai tenton t'i kthehët vetëm All-llahut. Prandaj, natyra e njeriut është e prirur ta njeh All-llahun si Zot të tij:

Përqënro vetëveten tënde sinqerisht në fenë, i larguar prej çdo të kote, (e ajo fé), feja e All-llahut në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga All-llahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë. (Rum: 30)

Besimtari i sinqertë, i cili nuk është pushtuar nga dëshirat e liga të epshit të tij por i cili ka besim në All-llahun, mëson nga libri i shpallur nga All-llahu se si të drejtojë vetën gjatë gjithë jetës së tij, dhe i merr pejgamberët si shembëlltyr të tij. Jeta e një besimtari është tërësisht e ndryshme nga ajo e një jobesimtari. Veç kësaj, nga Kur'ani dhe Syneti i pejgamberit (savs) besimtari mëson faktet për të cilat jobesimtarët janë plotësisht të pavetëdijshëm. Psh, All-llahu ka dhënë lajme të gëzuara se kushdo që zbaton punën e tij ndaj All-llahut, Ai do ta furnizoj me mënyrën e shpëtimit:

...Kështu këshillohet ai që i beson All-llahut dhe ditës së fundit, e kush iu përmbahet dispozitave të All-llahut, atij Ai i hap rrugë, dhe e furnizon atë prej nga nuk e kujton fare. Kush i mbështetet All-llahut, Ai i mjafton atij, All-llahu realizon dëshirën e vet dhe All-llahu çdo gjëje ia ka caktuar kohën (afatin). (Talak: 2-3)

Një besimtarë i cili e njeh siç duhet fuqinë e All-llahut, do t'i përkushtoj jetën e tij Atij, sepse ai e din se All-llahu do të jetë i mjaftueshëm për "cilindo që e vë besimin e tij në Atë." Kjo është shprehur në ajetin vijues Kur'anor:

Po ai (Jakubi) tha: "O bijt e mij!... Unë nuk mund të largoj prej jush asnjë send nga caktimi i All-llahut, vendimi nuk është i tjetërkujt vetëm i All-llahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm Atij le t'i mbështeten ata që besuan." (Jusuf: 67)

Besimtari që e kupton këtë fakt do të shoh se detyra e tij në këtë botë është vetëm që t'i përmbushë urdhërat e All-llahut. Kjo është detyra dhe "profesioni" e tij. Ai thjesht është përgjegjës që të përpiqet në rrugën e All-llahut. Ai lutë All-llahun për çdo gjë, sepse është All-llahu Ai i Cili i jep çdo gjë atij. Qellimi i krijimit të njeriut është i regjistruar kështu në Kur'an:

Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre ndonjë furnizim e as dëshiroj të më ushqejnë ata. All-llahu është furnizues i madh. Ai fuqiforti. (Dhariat: 56-58)

Prandaj, është vështirë që një besimtarë, i cili i shfaqë moralet e lavdëruara në Kur'an, mund të ketë në zemrën e tij "frikën e të ardhmës." Kjo frikë është karakteristik e atyre që jetën e kuptojnë si një luftë midis miliona perendive false të pavarura. Të pavetëdijshëm se çdo gjë zhvillohet nën kontrollin e All-llahut, në pajtim me fatin, ata supozojnë se duhet të vendosin një luftë për të mbijetuar. Ata besojnë se ata do të përfitojnë duke "shkelur mbi të tjerët" dhe duke i "abuzuar ata" që t'i realizojnë qellimet e tyre dhe për plotsimin e interesave të tyre personale. Faktikisht, mendimet e tyre barazohen me atë që ata e marrin...

Said Nursi shpjegon se si njeriu dështon të kuptoj se detyra e vërtetë e tij është të jetë një rob i All-llahut dhe shton:

"... Ata pamenduar konkludojnë se jeta është një luftë."

Kjo arsyeshmëri, e nënshkruar nga ata të cilët nuk jetojnë sipas vlerave të Kur'anit, është një nga besimet kryesore të fesë së tyre. Për shkak të arsyes në pyetje këta njerëz gjithmonë vuajnë nga ndjenjat e shqetësimit dhe presionit:

◆ Shumica e këtyre njerëzve, ndryshe nga besimtarët, janë epshor, njerëz egoistë të cilët interesohen vetëm për fitimin e tyre.

◆ Ata u mungon gadishmëri delikate që zhvillohet me vetëfljirim. Dashuria e tyre është e bazuar në arritjen e përfitimeve; ata nuk e duan një person për shkak të vlerave dhe vetive të mira të tij por për shkak të interesit të tyre që të duan atë.

◆ Këta të cilët ata i konsiderojnë si të dashurit e tyre, gjithashtu, u afrohen atyre me të njëjten arsye, që krijon një marrëdhënie pa besnikëri. Ata gjithmonë merakosen për pabesinë e mundshme të partënerve të tyre, pasi ata e dinë se ata në çdo kohë mund të gjejnë të tjerë të cilët janë më të pasur apo më të bukur...

◆ Ata janë të harxhuar nga xhelozia, një veçori që i pengon ata nga pëlqimi i bukurisë dhe të mirave. Psh, në vend që t'i pëlqej bukuria e dikujt dhe të thonë "sa të bukur e ka krijue All-llahu atë apo atë," ata ndihen të shqetësuar dhe pyesin, "pse unë nuk jam aq i pashëm si ai apo bukuroshe si ajo?"

◆ Ata nuk janë mirënjohës ndaj All-llahut apo nuk janë të kënaqur me të mirat e tyre. Me një rregullim të tillë, ata gjithmonë duan të kanë më shumë. Kjo dëshirë e pangopur bëhet një burim konstant i shqetësimit.

◆ Të paaftë që të pranojnë dobësinë dhe ligshinë e tyre, ata nuk kërkojnë ndihmë nga All-llahu. Ata supozojnë se do të çlirohen nga dobësitë e tyre nëse në mënyrë arrogante zbrapsen larg nga All-llahu pa kërkuar ndihmë nga Ai. Mirëpo, kjo nuk është rruga e çlirimit nga dobësitë e tyre. Gjithashtu në këtë kohë, ata u drejtohen të tjerëve dhe mbajnë shpresat e tyre në ta. Edhe pse ata të cilëve u drejtohen janë gjithashtu individë të dobët të

cilët mendojnë vetëm për fitimin e tyre. Veç kësaj, ata nuk janë aspak të mëshirshëm dhe të dhembshëm. Pasi ky është rasti, ata shpesh ndihen të "shqetësuar," dhe humbin gjendjen shpirtërore të tyre përmes dështimit që t'i kënaqin pritjet e tyre.

◆ Atyre u mungon toleranca dhe zemërbutësia. Për këtë arsye, bile edhe mospajtimi më i vogël ndërmjet tyre ka mundësi zhvillohet në konflikt apo përleshje. Shumë herë, secila palë e bënë si një çështje të krenarisë që refuzon të pranojë se ajo është gabim. Për këtë arsye, ata shpesh ndihen të shqetësuar.

◆ Ata nuk besojnë se jetojnë në një botë nën kontrollin dhe mbrojtjen e All-llahut, por më parë në një xhungël të pamëshirshme ku ata për mbijetim duhet t'i "mundin" të tjerët. Sipas fantazive të tyre të prishura, ata supozojnë se që të jenë në gjendje të mbijetojnë në këtë "xhungël," duhet të zhvillojnë një karakter të paepur, agresor dhe egoist. Me të vërtetë, qëndrimi i tyre përshtatet me çfarë ata ndeshën. Ata ose janë, siç i quan shoqëria e injorancës, të gëlltitur, si në shembullin e "peshkut të vogël," apo ata rritën në një peshk të "madh dhe gjakatar" dhe t'i gëlltisin të tjerët.

Këto ligje i takojnë gati të gjitha shoqërive ku njerëzit nuk e përjetojnë fenë e vërtetë, dhe sillen sipas virtyteve të gabuara të përshkruara më sipër. Kur'ani i quan këto shoqëri "inJORante dhe të pasjellshme," sepse janë tërsisht të pavetëdijshme për All-llahun dhe për ahiretin (botën e ardhshme).

Kur'ani na tregon neve se peJgamberi Musa (as) i ka përshkruar bijtë e Izraelit, një fis që kurrë nuk përdorinë urtësinë apo nuk i nënshtrohen All-llahut, si të paditur:

Beni Israilët i kaluam përtej detit, e ata takuan një popull që adhuronte do statuja të tyre, dhe thanë: "O Musa, na e bën edhe ne një zot (statujë) si zotët që i kanë ata (ai popull)". Ai (Musai) tha: "Ju jeni popull që nuk dini". Vërtet, ai popull (që po adhuron idhuj) është i shkatërruar në atë (adhurim) dhe ajo që vepruan është e asgjësuar (s'ka dobi). Musai tha: "Mos deshët, pos All-llahut, të kërkoj për ju zot tjetër, kurse Ai ju vlerësoi mbi njerëzit e tjerë?" (A'raf: 138-140)

Mirëpo, siç u përmend më herët, "shoqëria e injorancës" nuk është e natyrës së njëjtë. Edhe pse përgjithësisht të quajtur "të paditur," në shoqërinë e caktuar mund të ketë pjesë tjera, që shfaqin karakteristika tjera. Shoqëria zakonisht është e ndarë sipas shkallës së a e kanë arritur kriterin —kryesorja duke qenë fuqia ekonomike —e caktuar nga vetë shoqëria.

Kriteri me anë të cilit vlersohen njerëzit në shoqërinë e "injurancës"

Muslimanët e marrin "*takvan*" (frikë apo drojë nga All-llahu e cila e frymëzon individin të jetë në ruajtje ndaj punëve të këqija dhe i etur për ato punë që i pëlqen Ai) si të vetmin kriter me anë të cilit i vlersojnë njerëzit. Siç ka thënë pejgamberi (savs): ata e dinë se "*njeriu më i përkryer në fenë e tij në mesin e besimtarëve është ai sjellja e të cilit është më e shkëlqyera.*" (Tirmidhi). Megjithatë, në shoqëritë e injorancës që janë të formuara nga njerëzit e pafe, "paraja" konsiderohet si kriteri kryesor në bazë të cilit formohen opinionet për tjerët:

Pasi ky është rasti, shumë persiatje të shtrembëruara paraqiten në shoqëritë injorante:

◆ një personi të pasur, edhe pse i korruptuar dhe i paturpshëm, i kushtohen nderime.

◆ në sajë të kësaj rregulle të vënë nga shoqëria, njëri që është "i pasur por i paturpshëm" faktikisht beson se ai është personi "i denjë për respekt"

◆ pasi që shoqëria i cakton rëndësi aq të madhe "parasë," të varfërve u mungon vetëbesimi. Ky qendrim i të varfërve bëhet i dukshëm kur ata janë në mesin e të pasurve. Një i varfër mund të dijë se ai është më i mirë se personi i pasur pran tij, sepse ky i dyti është i prishur. Megjithatë, nën ndikimin e ideve të rrënjosura nga shoqëria, ai nuk ka mundësi t'i mund ndjenjat e tij të përshtatshmërisë.

◆ në shoqëritë e injorancës, ku posedimi i "parasë" është një kriter shumë i vlershëm, ekziston degjenerimi i moralit. Prishja e tillë shfaqet në forma të ndryshme, siç është mitoja, shpërdorimi i autoritetit apo falsifikimi, dhe është pothuajse tërësisht i përfshirë në jetën e përditëshme. Pasi që grumbullimi i sukseshëm i parave është vlera më e rëndësishme, të gjitha metodat që e mundësojnë bërjen e parave, s'është e rëndësishme se sa imorale dhe të pavenda mund të jenë ato, janë të ligjshme.

Tregimi i Karunit në Kur'an më së miri e përshkruan pozitën e "të orientuarve në para" nga shoqëria e injorancës:

Karuni ishte nga populli i Musait dhe ai shtypte atë popull ngase Ne i patëm dhënë aq shumë pasuri sa që një grup i fuqishëm mezi bartin çelësat e (pasurisë së) tij, e kur populli i vet i tha: "Mos u kreno aq fortë sepse All-llahu nuk i do të shfrenuarit!" Dhe me atë që të ka dhënë All-llahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos le

mangu atë që të takon nga kjo botë, dhe bën mirë ashtu siç të ka bërë All-llahu ty, e mos bën të këqia në tokë, se All-llahu nuk i do çrregulluesit. Ai (Karuni) tha: "Më është dhënë vetëm në saje të dijës sime!" Po a nuk e di ai se All-llahu shkatërroi para tij nga popujt e lashtë asish që ishte edhe më i fuqishëm e më i pasur se ai, po mëkatarët kriminelë as që do të pyeten për fajet e tyre (meqë All-llahu e di). Ai (Karuni) doli para popullit të vet me stolinë e vet, e ata që kishin synim jetën e kësaj bote thanë: "Ah, të kishim pasur edhe ne si i është dhënë Karunit, vërtet ai është fatbardhë!" E ata që ishin të zotët e diturisë thanë: "Të mjerët ju, shpërblimi i All-llahut është shumë më i mirë për atë që besoi dhe bëri vepër të mirë, po atë nuk mund ta arrijë kush përveç durimtarëve!" Po Ne atë dhe pallatin e tij i shafuam në tokë dhe, veç All-llahut nuk pati që ta mbrojë e as vetë nuk pati mundësi të mbrohet. E ata që dje lakmuan të ishin në vendin e tij, filluan të thonë: "A nuk shihni se All-llahu me të vërtetë i jep begati e komoditet atij që do nga robërit e vet, e edhe ia mungon atë atij që do, e sikur All-llahu të mos bënte mëshirë ndaj nesh, do të na sharronte në tokë edhe neve; sa habi, se si jobesimtarët nuk gjejnë shpëtim!" Atë, vend të përjetshëm (Xhennetin) u kemi përcaktuar atyre që nuk duan as mendjemadhësi e as ngatërresë në tokë, e përfundim i këndshëm u takon atyre që i frikësohen All-llahut. (Kasas: 76-83)

Siç mund të kuptohet nga ajetet, karuni dhe ata që i lakmoni atij ishin përfaqësuesit e një shoqërie tipike të injorancës. Ata dështuan të kuptojnë se All-llahu është pronari i çdo gjëje dhe se All-llahu i jep pasuri atij që Ai

dëshiron. Karuni mendoi se pasurinë që ai e posedonte i ishte dhënë atij për shkak të epërsisë së tij. Por kjo nuk ishte ashtu.

◆ Sepse All-llahu krijon çdo gjallesë, Ai është pronari i vërtetë i çdo gjëje. Në këtë kuptim, ndonjëri që posedon diçka mund të konsiderohet si një "kujdestar," që përko-hësisht kujdesët për pronën e cila faktikisht i takonë All-llahut.

◆ Të mirat që u janë dhënë njerëzve nuk ju kanë dhënë atyre për shkak se janë më të mirë apo për shkak se posedojnë diçka të rëndësishme. Këto bekime i janë dhënë njeriut si një nderë apo një provë. Çka pritet prej tij nuk është të bëhet "mendjemadhë" por të jetë "mirënjohës" ndaj All-llahut. nëse ndonjëri dështonë të kuptoj këtë, prona të cilën ai e posedon nuk i sjellë as lumturinë e as shpëtimin në këtë apo në botën tjetër.

◆ Pasuria nuk i është dhënë ndonjëri që ai të mund të "grumbulloj" atë dhe të jetë dorështrënguar. All-llahu i jep pasuri njeriut që ai të mund të përdorë atë në rrugën e All-llahut. Fundi i atyre që bëjnë të kundërtën është shpallur në Kur'an, si në vijim:

Ata, të cilët bëjnë koprraci me atë që nga të mirat e veta u dha All-llahu, të mos mendojnë kurrsesi se ajo është në dobi të tyre. Jo, ajo është në dëm të tyre. Ajo e mirë me çka bënë koprraci, në ditën e kijametit do t'u mbështillet në qafën e tyre. All-llahut i mbesin trashëgim qiejt dhe toka, All-llahu është i njohur mirë më atë që veproni. (Ali Imran: 180)

◆ Kur të shpenzoj pasurinë që i është dhuruar nga All-llahu, individi duhet të përdorë atë me meçuri që të arrijë miratimin e All-llahut, pa u frikënsuar për shterrjen e

burimit të tij. Në Kur'an, All-llahu na e tërheq vëmendjen e këtij rreziku dhe na përkujtonë neve se djalli e kërcënon njeriun me "**varfëri**" (Bekare: 268). Më tej është shpallur se All-llahu kompenson çkado që është shpenzuar në rrugën e Tij. Ajeti në lidhmëri me këtë temë është si vijon:

Thuaj: "S'ka dyshim se Zoti im është Ai që i jep furnizim të begatshëm atij që do nga robërit e vet dhe Ai ia pakëson atij, e çkado që të jepni, Ai e kompenson atë dhe Ai është dhuruesi më i madh. (Sebe': 39)

Tregimi i Karunit në fakt zbulon një qëndrim të përgjithshëm nga shoqëria e injorancës. Një ekzaminim më i afërt i tregimit, nxjerr në shesh se Karuni faktikisht mund të jetë shembull tipik i një karakteri në shoqërinë e injorancës që mishërohet në njerëzit e pasur dhe me autoritet.

Në ajetet e nderlidhura, adresimi u është bërë edhe atyre që i lakmojnë Karunin. Këta njerëz kanë të njëjtën persiatje injorante si Karuni dhe dështojnë të kuptojnë se pronari i vërtetë i pasurisë është All-llahu. Kështu, ata i japin rëndësi të madhe Karunit dhe pasurisë së tij.

Ata të cilët mund të largohen nga ngulitja e shoqërisë janë besimtarët e vërtetë:

◆ Për shkak se kriteri i besimtarëve nuk ishte paraja por besimi dhe për shkak se ata e dinin se e tërë prona i takon All-llahut, ata e kuptuan se është pamaturi që t'i lakojnë Karunit. Gjithashtu, ata kuptuan se ai sigurisht ishte në një pozitë mekatare.

◆ Ndryshe nga antarët e shogërisë së injorancës, ata nuk thanë: "All-llahu i jep me bollëk atij që Ai do, apo me masë atij që Ai dëshiron" pas vdekjes së Karunit, por e kuptuan këtë fakt si duhet në fillim.

Situatë e ngjashme është treguar në tregimin e "poseduesve të vreshtave." Dallimi ndermjet një njeriu të cilit i janë dhënë shumë të mira dhe pasuri, si në rastin e Karunit, dhe një besimtari, i cili beson në All-llahun dhe e zbaton detyren e tij ndaj Tij, është treguar në Kur'an si vijon:

E ti sillu atyre (që kërkuan t'i largosh varfanjakët) si shembull dy njerëz; njërit prej tyre i dhamë dy kopshte (vreshta) nga rrushi dhe ato i rrethuan me hurma, e në mes atyre dyave bimë tjera. Të dy kopshtet jepnin frutat e veta pa munguar prej tyre asgjë, e në mesin e tyre bëmë të rrjedhë një lumë. Ai kishte edhe pasuri tjetër. E ai atij shokut të vet (që ishte besimtar) i tha: - duke iu krenuar atij - "Unë kam pasuri më shumë se ti e, kam edhe krah më të fortë!" Dhe ai hyri në kopshtin e vet (e me besimtarin për dore), po duke qenë dëmtues i vetës (duke mos besuar dhe duke u krenuar) tha: "Unë nuk mendoj se zhduket kjo kurrë!" Dhe nuk besoj se do të ndodhë kijameti, (dita e gjykimit), por nëse bëhet që të kthehem te Zoti im, padyshim do të gjej ardhmëri edhe më të mirë se kjo. Atij ai shoku i vet (besimtari) i tha - duke e polemizuar atë -: "A e mohove Atë që të krijoi ty nga dheu, pastaj nga një pikë uji, pastaj të bëri njeri të plotë?" "Por për mua, Ai All-llahu është Zoti im, e Zotit tim unë nuk i bëj shok askë!" E pse ti kur hyre në kopshtin tënd nuk the: "Mashaell-llah, la kuvete il-la bil lah" - (All-llahu çka do, bëhet, s'ka fuqi pa ndihmën e Tij). Nëse ti më sheh mua se unë kam më pak prej teje edhe pasuri edhe fëmijë (krah më të dobët). Po unë shpresoj se Zoti im do të më japë edhe më të mirë nga kopshti yt, e këtij tëndit t'i shkaktojë fatkeqësi nga

qielli e të gdhijë tokë e lëmuar (e zhveshur). Ose të gdhijë uji i shterur, e ti kurrsesi nuk mund ta kërkosh atë!" Dhe vërtet, u shkatërruan frutat e tij, e ai filloi të rrahë shuplakët për atë që kishte shpenzuar në të, e ajo ishte rrënuar në kulmet e saj dhe thoshte: "O i mjeri unë, të mos i kisha bërë Zotit tim askë shok!" E nuk pati krah (grup), përveç All-llahut të vërtetë që t'i ndihmojë atij dhe nuk mundi ta pengojë. Në atë vend ndihma është vetëm e All-llahut të vërtetë. Ai është shpërblyesi më i mirë dh te Ai është përfundimi më i mirë. (Kaf: 32-44)

Udhëheqësit nga shoqëritë në të cilat kriteri është posedimi i parave

Pothuajse në çdo tregim në Kur'an, All-llahu përmend një grup të njerëzve të cilëve muslimanët u bartnin porositë e Tij. Mirëpo, në vend që ata të korrigjoheshin, komunikimi i fesë së vërtetë i bënë këta njerëz të bëhen kryelartë dhe t'i shtypnin besimtarët. Kur'ani jep llogari për qëndrimet e këtij grupi të njerëzve që paraqitet pothuajse në të gjitha tregimet e peygamberve.

Në Kur'an, kjo pjesë e shoqërisë është përcaktuar me shprehjet siç janë "prijësitë kryelartë të popullit," "ata që çojnë jetën në lehtësime," "ata që vazhdojnë në punët e këqija deri në pafund" dhe "ata të cilit ishin padrejtësishtë krenarë në tokë." Kualiteti i përbashkët i tyre është përdorimi i fuqisë dhe posedimit të tyre për t'u ngritur kundër All-llahut dhe të dëmtojnë në tokë. Në Kur'an, "udhëheqësitë" janë përshkruar në suren Sebe':

Ne nuk dërguam në asnjë vendbanim ndonjë nga peygamberët e që pasanikët e tij të mos i thonin: "Ne nuk

i besojmë asaj me çka jeni dërguar". Ata thoshin: "Ne kemi më shumë pasuri e fëmijë, e ne nuk do të jemi të ndëshkuar". (Sebe': 34-35)

◆ "Posedimet dhe fëmijët" që i janë dhënë këtyre njerëzve shtojnë kryelartësinë dhe mohimin e tyre të All-llahut:

Sa i përket Adit, ata pa pasur kurrfarë të drejte, u treguan mendjemdhenj ndaj banorëve në tokë dhe thanë: "Kush ka fuqi më të fortë se ne?" A nuk e ditën ata se All-llahu, i cili i krijoi ka fuqi më të fortë se ata?! Ata mohuan argumentet tona. (Fussilet: 15)

◆ Kjo pjesë e shoqërisë strehon një urrejtje të rrënjosur thellë ndaj atyre të cilët besojnë në All-llahun. Njësoj, besimtarët shpesh ragimet më të fuqishme i marrin nga këta njerëz "të cilët jetojnë jetën me lehtësi." Këta njerëz, kundërshtojnë që t'i nënshtrohen All-llahut dhe që të përdorinë pasuritë e tyre në rrugën e Tij, kultivojnë ofendime dhe urrejtjet ndaj besimtarëve. Për shkak të urrejtjes që ata ndiejnë për besimtarët, disa prej tyre tentuan edhe që t'i "dëbojnë" ata:

Paria, që ishte kryelartë nga populli i tij, tha: "O Shuajb, ne do të dëbojmë ty dhe së bashku me ty edhe ata që besuan nga fshati ynë, ose pa tjetër të ktheheni në fenë tonë". Ai (Shuajbi) tha: "A edhe nëse ne nuk e dëshirojmë atë (kthimin)?" (A'raf: 88)

Shembujt e njerëzve të tillë, të cilët janë adresuar gjërësisht në Kur'an, ekzistojnë edhe në shoqëritë e sotme.

Posa që ne t'i mendojmë kualitetet kryesore të "atyre që çojnë jetën në lehtësi," siç përmendet në Kur'an, tema bëhet e vetëkuptueshme, sepse ka ngjashmëri habitëse ndërmjet kualiteteve të "atyre që çojnë jetën në lehtësime"

dhe të disa anëtarëve të pjesës së caktuar të shoqërisë të cilët i kanë adoptuar vlerat e injorantëve. Kjo pjesë e shoqërisë është quajtur "shoqëria e lartë" pothuajse kudo në botë.

Jeta e jetuar nga disa anëtar të kësaj shoqërie të cilët e shijojnë nivelin e jetesës larg mbi mesatarën, është plotësisht e degjeneruar. (Natyrisht, në këtë pjesë të shoqërisë ka prej tyre që kanë sjellje të mira si dhe ata që kanë sjellje të këqija). Festat e zgjatura prej kafeneve private në shtëpia, tregon bazën e një kuptim të vrazhdë të argëtimit, të rinjët të shkatërruar nga shpërdorimi i drogës, dëshitimet morale që i përjashtojnë individët e pandreqshëm nga të qenurit të përmbajtur dhe të bësueshëm, pirja e tepërtë, shpenzimet e tepruara, etj, prezentohen si "natyrale" në këtë mjedis shoqëror të shfrenuar... Në këtë kuptim, në maskën e nocioneve të sofistikuara të lirisë ose modernizimit, të gjitha format e mizorisë, çoroditjeve dhe imoralitetit i imponohen njerëzve.

Disa nga anëtarët e kësaj shoqërie i shfaqin të gjitha karakteristikat e shoqërive të prishura që përmenden në Kur'an: zbatojnë homoseksualizmin e popullit të Lutit (as), mashtrojnë në matje, peshë dhe në llogaritje, një veçori tipike e popullit të Medjenit (Hud: 84), tallen me besimtarët, si në rastin e popullit të Nuhit (as) (Hud:38), shfrytëzimi i pasurisë materiale të njerëzve me anë të kamatës, si praktikohet nga bijtë e Izraelit. (Nisa: 161)

Anëtarët e kësaj pjese të shoqërisë, duke mos pasur kualitete tjera përveç dashurisë së tyre ndaj llukseve, shfaqin një jetë me mungesë të moralit, derisa njerëzit mesatar me vështirësi mund të fitojnë bukën e gojës, edhe pse kanë punuar shumë dhe në mënyrë modeste. Këta

njerëz të cilët shpenzojnë shuma të mëdha të parave, larg mbi pagën e një personi mesatar, në një natë të vetme i shkaktojnë shoqërisë në tërësi dëm të madh shpirtëror.

Në këtë pikë, ne duhët të kujtojmë se Kur'ani na informon neve për fundin e "prijësve të cilët çonin jetë në lehtësime," veç nëse ata pendohen dhe janë të vendosur në braktisjen e jetës së tillë:

Ndërkaq, kur t'i kapim me dënim ata që kanë çuar jetë të shfrenuar, atëherë ata me britmë bëjnë lutje (duke kërkuar ndihmë). Mos ngritni zërin tash, se ju nuk keni ndihmën Tonë! (Mu'minun: 64-65)

Moralet në shoqërinë e injorancës

Parimet morale të besimtarëve të përshkuara në Kur'an janë të bazuara në frikën ndaj All-llahut dhe miratimit të Tij. Meqenëse, anëtarët e shoqërisë së "injurancës" nuk e vendosin aftësinë gjykuese të tyre në devocion, edhe parimet e tyre morale janë të shtrembëruara.

Meqenëse, shoqëria e "injurancës" është e pavetëdijshme për fuqinë e pafund të All-llahut, anëtarët e saj i bazojnë kuptimet e tyre morale në kriterin më mirë të shprehur me fjalët: "çfarë do të mendojnë njerëzit për këtë?" Një kuptim i tillë lejonë kryerjen e punëve të papranueshme morale në një mjedis ku askush nuk i dëgjon apo nuk i sheh ata. Rrjedhimisht, ky kuptim imoral është i legalizuar nën një titull dhe formë të re.

P.sh, shumë njerëz në shoqërinë e "injurancës" e konsiderojnë shkeljen e kurorës imorale. Disa nga këta individ të cilët shkelin kurorën zor se guxojnë të pranojnë atë. Megjithatë, ata përgjithësisht nuk largohen nga shkelja e kurorës, me kushtë që asnjë shpirtë të mos i shoh.

Është e mundur të vërehen forma të ndryshme të kësaj sjellje në jetërat e njerëzve injorant.

Dëshira për të jetuar përgjithmonë

Thuaj: "S'ka dyshim se vdekja prej së cilës po ikni, ka për t'ju zënë, e pastaj do të silleni te Ai që e di të padukshmën dhe të dukshmën, dhe atëherë Ai do t'ju njoftojë me atë që keni punuar". (xhum'a: 8)

Të pavetëdijshëm për ekzistencën e All-llahut dhe të ahiretit, anëtarët e shoqërisë së "inJORANCËS" sillen "sikur ata kurrë nuk do të vdesin." Në këtë shoqëri, vdekja vazhdon të jetë një nga fjalët që kurrë nuk theksohet. Kur të bëjnë plane, hapurazi e injorojnë vdekjen. Ata grumbullojnë pasuri sikur jeta e kësaj bote është e përhershme. Pasi që këto plane tërësisht i takojnë kësaj bote, ata që kujtojnë vdekjen etiketohen si "dëmtues të argëtimit"

Kjo është një nga shenjat më të dallueshme të persiatjeve të shtrembëruara në të cilat jobesimtarët injorantë bazojnë jetërat e tyre. Meqenëse **"Secili njeri do të shijojë vdekjen"** (Ali' Imran: 185), jeta e bazuar në injorimin e trilluar të vdekjes pa dyshim është e ngritur në themele të kalbura. Megjithatë, njeriu duhet të përdorë mendjen e tij:

- ◆ Pasi që atij i është dhënë dëshira për të jetuar përgjithmonë, ai duhet të mendoj se pse jeta e tij duhet të jetë e kufizuar në 60-70 vjetë

- ◆ Ai duhet të njeh si një persiatje të pamatur supozimin se menjanimi i mendimit të vdekjes është një rrugë për të mbajtur vdekjen në distancë. Kjo sjellje është pikërisht si një struc me kokën e tij në zallë.

- ◆ Ai duhet të kuptoj faktin se All-llahu, i Cili e ka for-

muar atë nga sperma në trupin më të përsosur, ka fuqinë që të rikrijon atë dhe t'i jap atij një jetë të re.

- Përfundimisht, ai duhet të mbaj në mendje se All-llahu, i Cili premtoj dhe shpalli në qindra ajete se Ai do të rikrijoj atë pas vdekjes, sigurishtë do të mbajë premtimin e Tij.

Të gjitha më lartë do të drejtojnë atë që të kuptoj se vdekja nuk është një lloj i zhdukjes, por një kalim për në ahiret.

◆ Në këtë rast, ai gjithashtu mund të kuptoj se frika nga vdekja është e pakuptim. Në fakt, frika nga vdekja nuk do t'i bëjë punë atij; vdekja është e pashmangshme. Ç'do njëri do të vdes në kohën e paracaktuar. Ata që i frikohen vdekjes janë paralajmëruar në Kur'an si në vijim:

... Ata fshehin në vetvete atë që ty nuk ta shprehin.

Thonin: "Sikur ne të kishim diçka në dorë në këtë çështje, ne nuk do të mbyteshim këtu!" Thuaj: "Edhe sikur të ishit në shtëpitë tuaja, atyre që është caktuar mbytyja (vdekja), do të dilnin në vendin e flijimit të tyre!"... (Ali Imran: 154)

Vdekja, e cila është dera për në ahiret, sjell shpetim dhe lumturi vetëm te ata që i kanë kaluar jetërat e tyre në pajtim me pëlqimin e All-llahut. Për ata të cilët u larguan nga All-llahut, në anën tjetër, vdekja dmth, shkatërrim absolut dhe fillim i një fatkeqësie të tmerrshme. Kur'ani na informon neve se posa të vij vdekja, pendimi i ndjerë nga ata të cilët e kanë harruar All-llahun—sikur ata kurrë nuk do të vdesin—nuk do të ju bëjë punë:

Nuk është pendim (i pranueshëm) i atyre që vazhdimisht bëjnë punë të këqia dhe vetëm atëherë kur t'i vjen vdekja ndonjërit prej tyre, të thotë: "Unë

tash u pendova!" e as i atyre që vdesin duke qenë jobesimtarë. Ndaj tyre kemi përgatitur dënim të ashpër. (Nisa': 18)

E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: "O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që lëshova!" Kurrsesi, (Kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distancë periodike) der në ditën kur ringjallen. (Mu'minun: 99-100)

Ç'do njëri që nuk i ka përkushtuar jetën e tij All-llahut do të jetojë që të vuaj këtë pendim veç nëse All-llahu dëshiron ndryshe.

Mendo se jeta është shumë e shkurtë, se është një jetë e vërtetë e përhershme pas jetës së kësaj bote, dhe se njëri është titulluar të arrijë jetën e përhershme, nëse ai fiton miratimin e All-llahut në këtë botë;

◆ Ne duhet të shqetësojmë vetën me jetën e vërtetë, që pritet të filloj pas vdekjes, më shumë se me jetën e kësaj bote e cila është e shkurtë dhe e pavlerë pranë begatisë së përhershme të premtuar. Kjo është pse, besimtarët që përkujtojnë këtë fakt janë nga ata që **"ne i pajisëm ata me një virtyt të posaçëm, me përkujtim ndaj botës tjetër."** (Sad: 46)

◆ Është e pakuptimë që të mashtrohet nga parëndësishmëria dhe joshjet mashtruese të botës dhe të lidhet thellësisht në të. As posedimet, bukuria, fuqia, familja, e as fama nuk mund të shoqërojnë një person në varrin e tij. Çka lihet në varr është vetëm një trup i mbështjellur në një qefin, që kalon një proces të shpejt të kalbjes pas varrimit.

◆ Çfarë do të dërgohet në ahiret janë punët e mira dhe veprimet e adhurimit të bëra për të fituar miratimin e

All-llahut. Aty, bekimet e përkohshme të kësaj bote (shëndeti, bukuria, pasuria, etj), në format më të përsosura, për përjetësi do t'i kthehen njeriut.

◆ Njëri që dështon të kuptoj këtë fakt, e duke mbetur koprrac i shmanget shpenzimit të pasurisë së tij në rrugën e All-llahut, eventualishtë e shkatërron jetën e përherëshme të tij në ahiret dhe e dëmton shpirtin e tij:

Ja, ju jeni ata që ftoheni për të dhënë në rrugën e All-llahut (për luftë kundër armikut tuaj), e dikush prej jush bën koprraci, e kush bën koprraci, ai bën kundër vetvetes, All-llahu s'ka nevojë, e ju jeni të varfër (keni nevojë). Po nëse ju i ktheni shpinën, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, që nuk do të jetë si ju. (Muhammed: 38)

Ata që dështojnë të kuptojnë këtë dhe lidhen thellësishtë për këtë botë luftojnë që të arrijnë një të ashtuquajtur "pavdekësi," për këtë arsye ata dëshirojnë të "lënë pas diçka në këtë botë me të cilën njerëzit mund t'i rikujtojnë ata." Kjo dëshirë paraqitet në forma të ndryshme:

◆ Disa mundohen të lënë prapa "vepra artistike", ashtu që "emri i tyre të mund të jetojë." Për këtë qëndrim, Kur'ani thotë:

A në çdo bregore ngritni ndonjë shtëpi (ndërtesë) sa për lojë? Dhe a i ndërtoni pallatet e fortifikura që të jeni përgjithmonë? (Shu'ara: 128-129)

◆ Përsiatja më së miri e shpreh vetën në dëshirën për t'i "rritur fëmijët." Ata që nuk shpresojnë në ahiret dëshirojnë të kenë fëmijë që do të mbartin emrin e familjes në të ardhmën. Kjo është arsyeja kryesore se pse zakonisht familjet preferojnë djem.

Në një ajet tjetër është thënë se dëshira për të "pasur

fëmijë" është vetëm pjesë e shkelqimit të përkohshëm të kësaj bote:

Ju njerëz dijeni se jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se lojë, kalim kohe në argëtim, stoli, krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve, e që është si shembull i një shiu prej të cilit bima i habit bujqit, e pastaj ajo thahet dhe e sheh atë të verdhë, mandej bëhet e thyer e llomitur, e në botën tjetër është dënimi i rëndë, por edhe falje mëkatesh dhe dhurim i kënaqësisë nga All-llahu; pra jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se përjetim mashtrues. (Hadid: 20)

Natyrisht, për njerëzit është më e pranueshme të dëshirojnë që të rrisin fëmijë me morale të mira. Mirëpo, në sistemet e shtrembëruara të shoqërisë së injorancës, shkak i kësaj dëshire nuk është kënaqësia e All-llahut, por për t'i plotësuar mburrjet e tyre dhe për të lënë prapa tyre në këtë botë një shenjë të qëndrueshme.

Megjithatë, kur ne i referohemi Kur'anit, ne shohim qendrimin e besimtarëve të vërtetë; ata kërkojnë fëmijë nga All-llahu vetëm nëse kjo është e nevojshme për kënaqësinë e All-llahut. Shumica e pejgamberve jetuan jetrat e tyre pa fëmijë pasi ata nuk kishin një mundësi të tillë gjatë kohës e vjetëve të tyre dhe kërkuan fëmijë nga All-llahu vetëm kur ata u plakën shumë dhe u novojitej dikush që do të vazhdonte kumtimin e porosisë së All-llahut dhe për të mbrojtur fenë e Tij.

Prandaj, "me pasë fëmijë" është e nevojshme vetëm nëse pajtohet me kënaqësinë e mirë të All-llahut. Është gabim i madh bërja e kësaj vetëm prej një dëshire instiktive për të "tejkalar njëri tjetrin" dhe për të vazhduar emri i tyre familjar në mënyrën si bëjnë jobesimtarët.

Kuptimi i fesë në shoqërinë e injorancës

Njerëzit e tillë që janë përshkruar më lart, të cilët dëshojnë t'i japin All-llahut vlerësimin e duhur e si rrjedhim janë "inJORANT," e kanë shpjeguar fenë në pajtim me persiatjet dhe besimet e tyre të shtrembëruara. Kuptimi i fesë që rezulton nga kjo shfaq devijimin e dukshëm nga feja origjinale siç është caktuar në Kur'an. Kur'ani e shpjegonë fenë e sjellur nga peygamberi Muhammedi (savs) si një fe që i **"...heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta..."** (A'raf: 157) dhe si një fe që "nuk përmban vështirësi në të":

...Ai ju zgjodhi ju (ju përcaktoi për të luftuar për rrugën e Tij) dhe nuk ju obligoi në fé me ndonjë vështirësi, në fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai edhe më parë, e edhe ky (Kur'an) ju quajti myslimanë ... (Haxh: 78)

Në Kur'an, All-llahu i ka thirrur njerëzit që të mendojnë dhe t'i njohin besimet e gabuara dhe metodat që ato i mbajnë, të kthehen te stili jetësorë i menduar si i përshtatshëm nga All-llahu.

Megjithatë, shoqëria e injorancës shtiren se nuk e sheh porosinë e qartë dhe të kuptueshëm të Kur'anit, në emer të Islamit, kanë shpikur një fe të bazuar në fantatizëm. Disa nga karakteristikat e kësaj feje të shtrembëruara janë si në vijim:

◆ Feja e paraqitur në Kur'an i thërret njerëzit t'i shërbejnë vetëm All-llahut dhe kështu të lirojnë vetën nga lidhja e të gjitha krijesave tjera. Prandaj, pasi ai nuk është i detyruar të kërkojë kënaqësinë e njerzëve tjerë, njeriu është përgjegjës vetëm për kërkimin e miratimit të All-llahut. Mirëpo, njerëzit e shoqërisë së injorancës kanë zhvilluar

një kuptim të fesë, jo si mënyrë e kërkimit të kënaqësisë së All-llahut dhe kështu ta lirojnë vetën, por si një institucion. Kjo e paraftyrone fenë si një faktor për përdorimin e shtypjes shoqërore ndaj njerëzve. Për shkak të këtij kuptimi, kjo fe e rreme ka kaluar në një formë, që është e shqetsuar kryesisht me atë se "çfarë njerëzit do të thonë"—një kuptim i larguar larg nga feja e vërtetë.

◆ Duke pasur këso ide të gabuara për fenë, shoqëria e injorancës gjërë në një shtrirje të madhe e ka identifikuar fenë me traditën. Zakonet vendore, besimet dhe faktorët kulturor janë inkorporuar në fe, dhe "të qenurit fetar" e kanë shkatërruar në "besnikri ndaj zakoneve të paraardhësve." Sidoqoftë, feja e paraqitur nga Kur'ani dhe e mishëruar në jetën shembullore të pejgamberit (savs), nuk ka çfarëdo ngjashmëri me këto. Në Kur'an, All-llahu e urdhëron njeriun të përdorë kufijtë e Tij dhe sunnetin e pejgamberit (savs) si vlerësuese e asgjë tjetër. Gjatë gjithë historisë, pejgamberet është dashur të luftojnë me ata që orvatëshin të mohojnë të vërtetën duke përmendur besimet e trashëguara nga paraardhësit e tyre. Virtytet që ata i shfaqën janë treguar në ajetet e mëposhtëme:

E kur u thuhet atyre (idhujtarëve): "Pranoni atë që All-llahu e shpalli!" Ata thonë: "Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë!" Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar dhe të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t'i pasonin)! (Bekare: 170)

Tema e njëjtë është përsëritur në Suret: Maide: 104; An'am:91; A'raf: 28 si dhe në shumë ajete tjera.

◆ Anëtarët e shoqërisë së injorancës, të cilët e kuptojnë fenë si një institucion shoqëror dhe e njëjtësojnë me traditat, si rezultat e kanë larguar fenë nga arsyetimi. Mirëpo,

siç na informon neve Kur'ani, për të qenë musliman duhet me qenë i mençur. Besimtarët janë thirrur gjithmonë të mendojnë, të pyesin dhe kështu të kuptoj ajetet e All-llahut. Besimi dhe urtësia janë të ndërlidhura; si pasojë e përdorimit të urtësisë njëri arrinë besimin, dhe besimi shtohet edhe më thellë përderisa njëriu vazhdon të përdor urtësinë. Shoqëria e injorancës, megjithatë, besojnë se besimi përbëhet vetëm nga "dogmat." Ata e kuptojnë zbatimin e verbër ndaj njohurisë tradicionale si besim, ndersa urtësia është çelësi i të kuptuarit të ekzistimit të All-llahut dhe të vetive të Tij. Kjo është pse besimi në All-llahun në shoqërinë e injorancës është e natyrës së dobët. Për të mos e lëkundur këtë besim të dobët kunder Kur'anor, ata kanë zhvilluar një pozitë të paarsyeshme që sugjeron se, "mendimi i tepërt mbi çështjet fetare mund të jetë e dëmshme për besimin e ndonjërit."

◆ Kjo arsyeshmëri, që buron nga injoranca, nuk sheh dëm në paraqitjen e principeve të reja në fe dhe në ndalimin e asaj që është e lejuar.

Kur'ani shpesh na tërheq vëmendjen në këtë përsiatje "ndaluese" që i shqetson shumë njerëz:

Thuaj: "Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që All-llahu i krijoi për robtë e vet?" Thuaj: "Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në ditën e kijametit janë të posaçme për ta. Kështu i sqarojmë argumentet një populli që kupton. Thuaj: "Zoti im i ndaloi vetëm të këqijat e turpshme, le të jenë të hapta ose të fshehta, ndaloi mëkatin, ndaloi shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ndaloi t'i mvishni All-llahut shok pa patur për të kurrfarë argumenti, dhe ndaloi të thoni për All-llahun atë që nuk e dini se është e vërtetë. (A'raf: 32-33)

Ç'keni ju që të mos hani nga ajo për të cilën është përmendur emri i All-llahut, e Ai ju sqaroi juve se çka është ndaluar për ju, përveç kur jeni detyruar (atëherë edhe harami është hallall). Një shumicë (e mohuesve), duke mos pasur kurrfarë dije, por vetëm nga pasionet e tyre, duan t'i largojnë nga e vërteta (njerëzit). Po Zoti yt di më së miri për ata që i shkelin dispozitat. (En'am: 119)

O ju që besuat! Mos i ndaloni (mos i bëni haram) të mirat që për ju i lejoi (i bëri hallall) dhe mos teproni, se All-llahu nuk i do ata që e teprojnë (i kalojnë kufijtë e dispozitave të Zotit). (Maide: 87)

◆ Si rezultat i këtij degjenerimi të shkaktuar nga shoqëria e injorancës, Islami po prezentohet si "një fe e veçantë për Beduinet (Arabët shtegtues)." Megjithëse ndryshe janë faktet. Pejgamberët gjithmonë kanë qenë njerëzit më të civilizuar në kohën e tyre. Ata ishin njerëz të kulturuar dhe të shkolluar me vlera të pastra estetike. Pejgamberi Sylejmani (as), me pallatin e tij që njihet të ishte një kryevepër e begatuar arkitekturele për shumë vende elegante, është njëri nga shembujt më të famshëm i përmendur në Kur'an.

Të qenurit musliman nënkupton mos të qenurit i lidhur për kulturen tradicionale apo të gëzuarit me vlera nostalgjike. Pa dyshim nuk është të qenurit "nga orienti" e as të qenurit i lidhur vetëm për një kulturë. Të qenurit musliman është të qenurit shërbyes te All-llahut dhe me qenë mirënjohës për bekimet e dhuruara nga Ai. Do të thotë opërpjekja për të njohur All-llahun, afrimin më afër te Ai dhe të qenurit një genie njerëzore me tipare fisnike.

Musliman i vërtetë është ai që kërkon miratimin e Krijuesit të tij, All-llahut, të Plotëfuqishmit, dhe i cili është larguar nga çdo shpres tjetër materiale apo shpirtërore përveç fitimit të miratimit të Tij.

Ky është nocioni i muslimanit

VENDBANIMI I PËRHERSHËM I ATYRE QË KANË MARRË PERËNDI TJERA PËRPOS ALL-LLAHUT: XHEHNENEMI



*A është i njëjtë ai që iu bind All-llahut dhe kërkoi kënaqësinë e Tij, si ai që tërhoqi kundër vetes hidhërim të madh nga All-llahu dhe e ardhmja e tij është xhehennemi, që është përfundim shumë i keq?
(Ali Imran: 162)*

● Është vend i poshtërimit dhe dënimit të përjetshëm. (Tewbe: 63, 68; Maide: 80; En'am: 128; Hud: 107; Nahl: 29; Enbija: 99; Nisa': 14, 151)

● Flaka e tij është e tmerrshme dhe djegëse. (Me'arixh: 15-16; Ali Imran: 181; Ahzab: 64; Haxhixh: 72; Nur: 57; Furkan: 11)

● Gjëmon dhe vlon. (Furkan: 12; Mulk: 7-8)

● Është vendi më i keq që e ka krijuar Allahu. (Ali Imran: 162; Nisa': 115)

● Denimi është i vazhdueshëm dhe nuk do të lehtësohet. (Mu'mininun: 46-47; Maide: 37; Junus: 52; Bajjine: 6; Haxhixh: 22; Ali Imran: 88; Fatir: 36)

● Nuk ka mundësi të shpetimit përmes vdekjes. (Ibrahim: 17)

● Nuk ka ndihmëtarë. (Ali Imran: 91)

● Nuk ka shtegdalje. (Maide: 37; Kaf: 53; Beled: 19-20)

● Roje të xhehnnemit janë engjëjtë. (Mudeththir: 31)

● Lëndë djegëse të zjarrit janë njerëzit dhe gurët. (Bekare: 24; Tahrim: 6; Ali Imran: 10; Enbija: 98; Hud: 119; Sexhde: 13)

● Fërgohimi në prushin e xhehennemit. (Tewbe: 35)

● Aty ata do të kenë rrënkim. (Enbija: 100)

● E idhujtarët atë ditë i sheh të lidhur në pranga. (Ibrahim: 49)

● Atyre do t'u jipet për të pirë ujë të vluar dhe qelbësira. (Nebe': 24-25; Gashije: 5; Wakia: 54-55; Junus: 4; Sad: 57; Ibrahim: 16-17)

● Ushqimi është pema e përherëshme (Zekumi) dhe barishte me ferra helmuese. (Duhan: 43-46; Saffat: 62-66; Wakia: 52-53; Muzemmil: 13; Gashije: 6-7)

● Petkat e tyre janë nga katrani. (Ibrahim: 50)

VENDBANIMI I PËRHERSHËM I ATYRE QË KËRKOJNË VETËM MIRATIMIN E ALL-LLAHUT: XHENNETI



● Ata aty kanë çka të dëshirojnë, e te Ne ka edhe më shumë. (Kaf: 35)

● Ata aty ketë çdo gjë nga e cila njeriu kënaqet dhe do të ketë edhe më shumë. (Kaf: 35; Zuhruf: 71; Enbija: 102)

● Aty ka begati të mëdha. (Insan: 20)

● Aty ka begati të mëdha e zotërim (pronë, pasuri) të madh. (Saffat: 43; Insan: 20)

● Aty nuk do të përjetojnë vdekjen, përveç asaj të parës në dunja. (Duhan: 56)

● Ata (të drejtët) do të jetojnë aty përgjithmonë. (Bekare: 25)

● Aty nuk do të ketë lodhje apo molisje. (Fatir: 35)

● Aty është kënaqësia e pakufizuar. (Ja Sin: 55)

- Aty është komforti i plotë. (Wakia: 89)
- Është jashtëzakonishtë i gjërë. (Hadid: 21)
- Aty është në një jetë shumë e kënaqshme. (Hakka: 21)
- Aty nuk ka frikë apo pikëllim. (Bekare: 62; Ali Imran: 170; Fatir: 34; A'raf: 35)
- Njerëzit e kopshteve janë të nderuar. (Saffat: 42)
- Aty janë hyritë të pastërta, virgjine syzeza të cilat janë krijuar përseri në mënyrë të përsosur, që i shikojnë vetëm burrat e tyre. (Bekare: 25; Saffat: 48-49; Duhan: 54; Wakia: 22-23; 36-37; Rahman: 56, 58, 70, 72; Nebe': 33; Wakia: 35-37)
- Aty ka korridore të larta dhe pallate të mira. (Furkan: 10, 75; Ankebut: 58; Saff: 12)
- Aty nuk ka vapë e as të ftoftë që do të shqetësonte ndonjërin. Aty është freskët me hije të përrjetshme. (Insan: 13; Rra'd: 35; Murselat: 41; Nisa': 57)
- Në kopshte janë lumenjë. (Bekare: 25)
- Aty ka lumenjë nga ujë dhe lumenjë nga qumështi. (Muhammed: 15)
- Aty janë shtretërit e lartë e të qendisur me ar. (Wakia: 15, 34, Gashije: 13; Saffat: 44)
- Aty ka edhe jastekë të renduar për mbështetje, edhe qilima të shtruar. (Gashije: 15-16; Rahman: 76)
- Aty ka furnizmie të bollëshme. (Sad: 54; Mu'mininun: 40)
- Bekimet janë të pafundshme. (Insan: 13, Wakia: 33)
- Aty ka frute të ëmbëla të varuara pranë tyre. (Wakia: 28, 29, 32; Nebe': 32; Hakka: 23; Rahman: 68; Insan: 14)
- Aty ka kroje të pastërta. (Mutaffifin: 28; Gashije: 12; Rahman: 50; Insan: 6, 18)

- Aty ka bukuri dhe të mira të ndryshme. (Rahman: 48)
- Aty ka kolltuqe me mbulesa të kadifës. (Rahman: 54)
- Në mesin e tyre qarkullojnë shërbëtoret si të ishin margaritarë të ruajtur. (Tur: 24)
- Aty la djelmosha që përherë janë të tillë që duken si margairtarë të derdhur. (Insan: 19)
- Aty ka pije të bardha si bora që nuk u shakakton dhimbje koke atyre që e pijnë atë. (Mutaffifin: 25, 26; Insan: 5; Saffat: 46-47; Wakia: 19; Tur: 23)
- Ka veshje prej mëndafshi të hollë e të gjelbër (atlas) dhe të mëndafshit të trashë (brokat); janë të stolisur arë, argjendë dhe xhevahirë. (Insan: 21, Haxhxh: 23)
- Ushqimi dhe pijet shërbehen në pjata të mëdha dhe me gota prej ari dhe argjendi. (Zuhruf: 71; Insan: 15-16)
- Shija e ushqimit është e ngjashme me atë të kësaj bote. (Bekare: 25)

KEQKUPTIMET E EVULICIONIT



Cdo detaj i universit është shenjë e qartë e një krijimi të epërm. Përkundrazi Materializmi, i cili mundohet të refuzoj të vërtetën e këtij krijimi në univers, nuk është asgjë veçse një mashtrim jashtëshkencor.

Pavlerësia në këtë mënyrë e materializmit i lë pa baza të gjitha ato teori që mbështeten në këtë filozofi. Në krye të tyre vjen Darwinizmi, dmth, teoria e evulicionit. Kjo teori, e cila pretendon formimin e rastësishtëm të materies organike dhe inorganike, me argumentimin shkencor të krijimit të universit prej All-llahut, është hedhur poshtë. Astrofizikanti Amerikan Hju Ros (Hugh Ross) e shpjegon këtë në vijim:

Ateizmi, Darwinizmi dhe praktikisht të gjitha "izmat" e lindura si zgjatime të këtyre filozofive që nga shekulli i XVIIItë deri në shekullin e XXtë patën mbështetur supozimet e tyre të gabuara në pretendimin se universi ekziston që nga pafundësia. Unikaliteti i big bengut na ballafaqoi me një Qëllim, i cili zuri vend (mbizotroi) pas universit dhe ky Qëllim u bë burim i çdo

gjëje duke përfshirë edhe jetën¹

All-llahu është Ai që e ka krijuar dhe sistemuar universin deri në detajet më të vogëla. Prandaj, është e pamundur që teoria e evulcionit, që mbronë tezën se jeta është fryt i rastësisë dhe nuk është krijuara nga All-llahu, të jetë e vërtetë.

S'është për tu habitur, kur ne të shqyrtojmë teorinë e evulcionit shohim se kjo teori refuzohet nga zbulimet shkencore. Projektimi në jetë është jashtëzakonisht i ndërlikuar dhe goditës. Në botën inorganike, psh, mund të studijojmë se sa të ndjeshme janë balancimet në të cilat atomet qëndrojnë, dhe më tej, në botën organike, ne mund të vështrojmë se si këto atome janë bashkuar, dhe sa të jashtëzakonshëm janë mekanizmat dhe strukturat siç janë proteinat, enzimet dhe qëlizat, që prodhohen me ato.

Ky projektim i jashtëzakonshëm në qëniet e gjalla në fund të shekullit njëzet e ka bërë të pavlefshme Darwinizmin.

Ne jemi marrë me këtë temë në hollësi të mëdha në studime tona tjera, dhe do të vazhdojmë të shtjellojmë. Mirëpo, ne mendojmë se, duke pas parasysh rëndësinë, do të ishte më dobishme që edhe këtu gjithashtu të bëjmë një përmbledhje të shkurt.

Rrëzimi shkencor i Darwinizmit

Teoria e evolucionit edhe pse është një doktrinë, e cila shtrihet qysh nga Grekët e vjetër, në shekullin e XIXtë u përqaftua gjerësisht. Progresi më i rëndësishëm që e futi teorinë në aktualitetin e botës së shkencës është botimi në vitin 1859 i librit të Charles Darwin "Origjina e llojeve." Në këtë libër, Darvini del kundra së vërtetës se gjallesat e

ndryshme në tokë janë krijuar veç e veç nga ana e All-llahut. Sipas Darvinit të gjitha gjallesat vijnë nga një stërgjysh i përbashkët dhe janë diferencuar në ndryshime të vogla brenda kushteve dhe kohe të përcaktuar.

Teoria e Darvinit nuk mbështetur në asnjë zbulim shkencor konkret; siç e pranon edhe vet, ishte vetëm një "supozim." Ashtu siç rrëfëhet edhe në kapitullin me titull "Vështirësitë e teorisë" në të njëjtin libër, teoria linte hap-sira të mëdha përballë pyetjeve të shumë të rëndësishme.

Darvini shpresonte që vështirësitë që i dilnin përpara teorisë me zhvillimin e shkencës do të kapërceheshin dhe zbulimet e reja shkencore do ta forconin edhe më tepër, gjë të cilën e deklaronte shpesh në libër. Por shkenca përparonte plotësisht në të kundërtën e shpresave të Darvinit, të gjitha hipotezat themelore të teorisë i la një nga një të pambështetura.

Disfata e Darwinizmit përballë shkencës mund të analizohet në tre tituj bazë:

1) Teoria nuk mund asesi të shpjegojë se si ka filluar jeta në tokë.

2) Teoria, e cila na parashtron "mekanizmat e evoluimit" nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor që të tregojë realisht ndikimin e tyre evolucionar.

3) Regjistrimet e fosileve na shfaqin një tabllë plotësisht të kundërt me sugjerimet e teorisë së evolucionit.

Në këtë pjesë, do t'i shtjellojmë në linja kryesore këta tre tituj bazë:

Shkalla e parë e pakapërçueshme: Origjina e jetës

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet

rrjedhin nga një qëlizë e vetme e gjallë e shfaqur në një botë primitive përafërsisht para 3.8 miliard vjetësh. Si është e mundur që një qëlizë e vetme të ndërtoj me miliona specie të gjalla të komplikuar dhe nëse me të vërtetë të ketë ndodhur diçka e tillë, përse këto shenja (gjurmë) nuk gjenden të regjistruara në zbulimet e fosileve janë disa pyetjet që teoria nuk mund të shpjegojë. Por para së gjithash duhet të ndalojë në shkallën e parë që pretendon prej procesit të evoluimit. Si u shfaq ajo "qëlizë e parë" për të cilën flitet?

Teoria e evolucionit, pasi e refuzon krijimin dhe nuk pranon asnjë ndërhyrje të mbinatyrshe, supozon se ajo qëlizë e parë është shfaqur brenda disa ligjeve të natyrës ashtu spontanisht në mënyrë aksidentale pa asnjë projektim, plan apo sistem. D.m.th., sipas teorisë lëndët inorganike si rrjedhim i rastësisë duhet të kenë nxjerrë në dritë një qëlizë të gjallë. Por kjo është një hipotezë, e cila bie ndesh me ligjet më themelore biologjike që njihen.

"Jeta rrjedh nga jeta"

Darvini në librin e tij nuk ka folur fare mbi origjinën e jetës sepse koncepti primitive në periudhën e tij supozonte që gjallesat zotrojnë një konstrukt shumë elementar. Sipas teoris me titull "gjeneracioni spotan" që besohet që në mesjetë, besojnë se lëndët inorganike duke u bashkuar mund të formojnë një qenie të gjallë. Në këtë periudhë ekzistonte mendimi shumë i përhapur se insektet formohen nga tepricat e ushqimeve, e minjët nga gruri. Për të demonstruar diçka të tillë janë bërë eksperimente të çuditshme. Pak grurë është vendosur në një leckë të ndotur dhe, dhe është besuar se miu pas pak do të formohet nga ajo.

Ngjashëm, mendohej të zënit e mishit krimba ishte një argument që jeta rridhte prej lëndëve inorganike. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba mbi mishin nuk formoheshin aksidentalisht por nga lavrat që nuk shihen me sy të cilat sillleshin dhe liheshin nga mizat.

Në periudhen që Darvini ka shkruar librin "Origjina e llojeve," besimi se bakteriet formoheshin nga lëndë inorganike në botën e shkencës së asaj kohe, shihej si një pranim i përhapur gjerësisht

Por vetëm pesë vite pas botimit të librit të Darvinit, biologu i shquar francez Lui Paster e zhduku plotësisht këtë besim, i cili formon bazat e evoluimit. Në përfundimin që e nxori pas shumë studimesh dhe eksperimenteve të gjata që i bëri, i përkufizoi kështu: *"pretendimet se lëndët inorganike mund të formojnë jetë tani e tutje u varrosën plotësisht në histori."*²

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit, këmbëngulën për një kohë të gjatë përballë zbulimeve të Pasterit. Shkenca që përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin me një përbërje komplekse të qelizës së gjallë, e qartsoi edhe më tepër pavleftësnë e pretendimeve mbi vetëformimin e jetës spontanisht.

Përpyekjet pa përfundim të shekullit të XXtë

Evolucionisti i parë, i cili në shekullin e XXtë mori në dorë çështjen mbi origjinën e jetës ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin. Oparini me një sërë tezash të hedhura nga vetë ai, në vitet 1930 u mundua të demonstronte që qëliza e gjallë mund të formohet spontanisht. Por këto punime do të dilnin të pasukseshme dhe Oparin do të de-

tyrohej të bënte këtë rrëfim: "*Origjina e qëlizës fatkeqsisht përbën pikën më të errët, e cila përmbledh të gjithë teorinë e evolucionit.*"³

Evolucionistët që ndoqën rrugën e Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje mbi origjinën e jetës. Më i njohuri nga eksperimentet u organizua në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miller. Miller, gazet, të cilat pretendoheshin se ekzistonin në atmosferën e botës primitive duke i grupuar së bashku në një eksperiment dhe këtij komponimi duke i shtuar energji, formoi disa molekula organike (aminoacide) që përdoren në strukturën e proteinave.

Ky eksperiment, i cili në ato vite paraqitej si një fazë e rëndësishme në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, atmosfera e përdorur në eksperiment do të dilte në shesh në vitet pasardhëse që ishte shumë ndryshe nga kushtet reale të botës.⁴

Pas një qetësie të gjatë, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte aspak reale.⁵

Të gjitha përpjekjet evolucionare që u ndërmorën gjatë shekullit të XXtë, për të shpjeguar problemin e origjines së jetës, u përfunduan pa sukses. Xhefri Bada gjeokimisti i njohur nga Instituti Skrips, San Diego, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën evolucioniste "Toka", këtë të vërtetë e pohon kështu:

Sot, duke e lënë pas shekullin e XXtë, ende jemi ballë për ballë me problemin më të madh të pazgjidhur që kemi që kur kemi hyrë në këtë shekull: Si filloj jeta në tokë?⁶

Ndërtimi i ndërlikuar i jetës

Shkaku kryesor që çështja mbi origjinën e jetës e

teorisë së evolucionit ka hyrë në një dilemë të tillë është konstrukti i pabesueshëm i përbërë i atyre gjallesave që supozoheshin me ndërtim elementar. Qëliza e gjallesave është akoma më e ndërlikuar se të gjitha ato produkte teknologjike që njëriu arrin të bëjë. Edhe nëse përdorim laboratorin më të përparuar të botës, duke grupuar komponime inorganike nuk mund të arrihet të përfitohet një qëlizë e gjallë.

Kushtet që duhet të krijohen për shfaqjen e qëlizës janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me spontanitet. Probabiliteti për proteinat që janë përbërësit bazë të qëlizës, si sintezë e spontanitetit për një mesatarisht 500 aminoacidesh është 1 në 10950. Në matematikë probabilitetet më të vogla se 1050 paraprakisht quhen të pamundura.

Molekula e ADN-së, e cila merr pjesë në bërthamën e qëlizës dhe fsheh informacionet gjenetike, është një bankë informacionesh e pabesueshme. Informacionin që përfshin ADN-ja e njëriut nëse do ta hidhnim në letër, llogaritet se do të nevojitej të krijohej një bibliotekë me 900 volume me nga 500 faqe.

Një dilemë shumë interesante del në shesh në këtë pikë: ADN-ja mund të përsëritet vetëm me ndihmen e disa proteinave të përshtatshme (enzimeve). Por sinteza e këtyre enzimeve mund të realizohet vetëm me informatat e koduara në ADN. Pasi që të dyja varen nga njëra-tjetra, ato kanë eksistuar në kohë të njëjtë për përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta e ka origjinën nga vetëvetja në një situatë pa rrugëdalje. Në shtator të vitit 1994 në një botim në revistën Amerikane shkencore Profesori Lesli Orgel, një evolucionist me famë nga Universiteti I San Diegos,

Kaliforni, e pranon këtë fakt:

Është jashtëzakonisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleare, strukturat e të cilave janë të nderlikuara, të bashkohen vetëvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Sidoqoftë gjithashtu duket se është e pamundshme me pasë njëren pa tjetrën. Kështu, në shikim të parë faktikisht njëri mund të konkludojë se jeta kurrë nuk mund të ketë origjinë nga mënyrat kimike.⁷

Pa dyshim nëse është e pamundur që jeta të ketë filluar nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta është "krijuar" në një formë të mbinatyrshme. Ky fakt qartësisht e shfuqizon teorinë e evolucionit, qëllimi kryesorë i të cilës është mohimi i krijimit.

Mekanizmat imagjinar të evolucionit

Pika e dytë e madhe që e bënë teorinë e Darvinit të pavlefshme është shpjegimi i "mekanizmave të evoluimit", të cilat na parashtrohen si dy koncepte që nuk zotrojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini tërë hipotezën e shfaqur të evolucionit e mbështeti në mekanizimin e "selekcionit natyror". Rëndësia që i jepet këtij mekanizmi mund të kuptohej fare lehtë edhe nga titulli i librit *Origjina e llojeve, me rrugën e seleksionimit natyror...*

Seleksion natyror do të thotë përzgjedhje e natyrës. Kjo mbështetet në logjikën se, të përfshirë nga lufta për mbijetesë, në natyrë do të mbesin në jetë vetëm ato gjallesa, të cilat i përshtaten më së miri kushteve natyrore dhe fizike. P.sh, në një kope drerësh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbesin në jetë

vetëm ata drerë që vrapojnë më shpejtë. Kështu që kopeja e drerëve do të përbëhej nga individë (pjesëtarë) të fortë dhe të shpejtë. Mirëpo, në mënyrë të padiskutueshme, ky mekanizëm nuk mund të ndërhyjë në evoluimin e drerëve e t'i kthejë ata në kafshë të tjera p.sh, në kuaj.

Për këtë qëllim mekanizmi i seleksionit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte në dijeni të këtij realiteti dhe në librin e tij "*Origjina e llojeve*" u detyrua të thoshte:

*Seleksioni natyror s'bën dot asgjë derisa të ndodhin ndryshime apo variacione të favorshme individuale.*⁸

Ndikimi i Lamarkut

Pra, si mund të ndodhin këto "ndryshime të favorshme"? Darvini u mundua t'i përgjigjet kësaj pyetjeje nga pikëpamja e kuptimit primitivë të shkencës në periudhen kur ka jetuar ai. Sipas Lamarkut, biolog francez, i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcjellin brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat i kanë kaluar gjatë jetës së tyre. Si përfundim i këtyre cilësive, të cilat akumulohen brez pas brezi, dalin në pah specie të reja. P.sh, Sipas Lamarkut gjirafat kanë evoluuar nga antilopët në përpjekje për të arritur gjethet e pemëve të larta, nga brezi në brez kanë pësuar një zgjatim të qafës.

*Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm në librin e tij "*Origjina e llojeve*" ku pretendon se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit janë shendërruar në balena..*⁹

Por me zbulimin e ligjeve të trashëgimisë nga Mandelit dhe me verifikimin nga shkenca e gjenetikës që lulëzoj në shekullin e njëzetë, u shemb plotësisht legjenda

se karakteristikat e fituara janë përcjellë në brezat pasardhës. Kështu që seleksioni natyror ra nga mundësia e të qënurit një mekanizëm efektiv i evolucionit.

Mutacionet dhe Neo-Darvinizmi

Për të gjetur një zgjidhje në fund të viteve 1930, Darwinistët avancuan "teorin sintetike moderne", apo siç njihej me emrin më të përhapur Neo-Darvinizmi. Neo-darvinizmi pranë seleksionit natyror si "shkak i ndryshimeve të dobishme" përdori mutacionet, dmth, prishjet gjenetike të gjallesave prej ndikimeve të jashtme si radiacioni apo prej gabimeve gjatë kopijimit.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vleftësinë në emër të evolucionit është Neo-Darvinizmi. Teoria hipotezon se të gjitha ato miliona specie që gjenden në natyrë ashtu edhe veshët, sytë, mushkритë, duartë dhe organet e tjera të komplikuar e të panumërta, formohen si konkluzion i mutacioneve, pra në një periudhë të mbështetur në shformime gjenetike. Por ekziston një realitet shkencorë shumë i qartë që lë teorinë pa rrugëdalje: Mutacionet nuk mund të zhvillojnë gjallesat, përkundrazi në çdo kohë i kanë dhënë vetëm dëm atyre.

Arsyeja është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një sistem shumë të ndërlikuar. Çdo ndikim spontan i formuar mbi këtë molekulë, mund të shkaktoj vetëm dëm. Gjenetisti amerikan B.G. Ranganathan e shpjegon kështu:

"Mutacionet janë të vogla, spontane dhe të dëmshme. Shfaqën shumë rrallë dhe në probabilitetin më pozitiv janë të pandikueshëm. Këto tri cilësi tregojnë se mutacionet nuk mund të sjellin zhvillime evolucioniste. Një ndryshim spontan që mund të shfaqët në një organizëm të përvetësuar më së miri ose

do të shkaktojë efekt steril ose të dëmshëm (shkatrrues). Një ndryshim i rastësishëm që mund të ndodhë në një orë dore nuk do ta zhvillojë atë. Me shumë mundësi do ta shkatërrojë ose po t'i afrohem pozitivist rastit, ky ndikim do të jetë i padobishëm. Një termet nuk e zhvillon një qytet po e shemb atë".¹⁰

Deri në ditët e sotme nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm. Kuptohet që mutacionet, që teoria e evolucionit i tregon si "mekanizma evoluese" janë raste gjenetike që i lënë të gjymtuara dhe i shkatërrojnë gjallesat. (Ndikimi më i shpeshtë i mutacionit te njerëzit janë kanceret). Sigurisht që një mekanizëm shkatrrues nuk mund të ketë efekte evoluese, kështu që edhe seleksioni natyror, ashtu siç pohon edhe Darvini, "i vetëm s' mund të bëjë asgjë". Ky realitet na çon të besojmë se në natyrë nuk ekziston asnjë mekanizëm evolues, dhe ashtu siç nuk ekziston asnjë mekanizëm i tillë dhe ai përfytyrim imagjinar që e quajnë evolucion nuk është përjetuar në asnjë periudhë.

Regjistrat e Fosileve: s'ka ndonjë shenjë nga format kalimtare (ndërklasore)

Regjistrat e fosileve janë treguesi më i qartë se skenari që pretendohet nga teoria evolucionit nuk është përjetuar kurrë.

Sipas teorisë, të gjitha gjallesat janë evoluar nga njëra-tjetra. Një specie, e cila eksistonte më parë me kalimin e kohës do të kthehej në një urë kalimi për formimin e një specie tjetër dhe në këtë mënyrë evoluimi, kanë dalur në dritë të gjitha speciet e tjera. Sipas teorisë, ky transformim zhvillohet gradualisht me miliona vite.

Po të ishte kështu, atëherë brenda këtij intervali të

gjatë transformimi duhet të kenë ekzistuar dhe jetuar specie kalimtare.

Psh, në të kaluarën duhet të ketë ekzistuar disa qenie gjysëm peshk gjysëm zvarranik që edhe pse mbart akoma karakteristikat e peshkut në një anë ka përfituar veçori zvarranike. Ose përkrah cilësive zvarranike duhet të kenë dalur edhe disa zvarranik zogj që kanë mbartë karakteristika të zogjëve përveç karakteristikave të zvarranikëve që i kanë pasë. E meqë kjo është një periudhë transformimi duhet të kenë qenë gjallesa të paafta, me mangësira e të gjymtuara. Evolucionistet u referohen këtyre krijesave të imagjinuara, që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, si "forma ndërmjetëse-kalimtare.

Nëse me të vërtetë qenie e tilla kenë ekzistuar, llojet dhe numri i tyre do të ishin me miliona madje milarda. Kështu që absolutisht mbetjet e këtyre qënieve të çuditshme do të haseshin nëpër regjistrat e fosileve. Darvini në librin e tij "*Origjina e llojeve*" këtë e shpjegon kështu:

Nëse teoria ime është e vërtetë, me siguri që duhet të kenë jetuar lloje të panumërta ndërmjetëse-kalimtare që lidhin njëra tjetrën... Dhe argumente për to, që me të vërtetë të kenë ekzistuar mund të faktohen vetëm nga regjistrat e fosileve të gjetura.¹¹

Shpresat e shëmbura të Darvinit

Nga mesi i shekullit të 19-të e deri sot edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosile, ende nuk janë zbuluar format ndërmjetëse apo kalimtare. Të gjitha fosilet e nxjerra nga gërmimet arkeologjike, në të kundërt të pritjeve të evolucionistëve, tregojnë se në tokë jeta është shfaqur papritmas dhe në formë të përsosur.

Paleontologu (shkenctar fosilesh) i njohur anglez

Derek W. Ager, edhe pse ishte një evolucionist, iu desh të rrëfehej në këtë formë mbi këtë realitet:

*"Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me detaje regjistrat e fosileve qoftë në nivelin klasor apo të llojeve, hasim vazhdimisht po me të njëjtën të vërtetë: Shohim grupe që nuk janë të zhvilluara me evoluim të pjesshëm por janë formuar (krijuar) në një çast në sipërfaqë të tokës."*¹²

Kjo nënkupton se, të gjitha qëniet e gjalla pa patur asnjë formë kalimtare me njëra-tjetrën nëpër regjistra fosilesh, kanë dalë në pah në një çast të vetëm në formë të përsosur. Kjo është krejtësisht e kundërta me atë që pretendonte Darvini. Njëkohësisht ky është një argument i fortë që tregon se këto qenie të gjalla janë krijuar. Shpjegimi i vetëm për ekzistencën e një qenie të gjallë, e cila nuk ka evoluar nga një stërgjysh i saj por e dalë në pah papritur e përsosur, është se ajo qenie është e krijuar. Ky realitet pohohet edhe nga ana e biologut të njohur evolucionist Dagllas Futujama:

*Krijimi dhe evolucionin janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Qeniet ose janë shfaqur në tokë plotësisht të përsosura dhe pa mangësira ose ka ndodhur ndryshe. E nëse nuk ka ndodhur kështu në sajë të një periudhe transformimi duhet të ketë dalë në dritë duke evoluar nga ato specie, të cilat ekzistonin më parë (gjë që nuk po mundim ta vërtetojmë). Por nëse janë shfaqur përfekte e të përsosura, atëherë duhet të jenë të krijuara nga ana e një mendje që zotron forcë të pafund."*¹³

Fosilet tregojnë se gjallesat janë shfaqur në tokë në një mënyrë të përsosur dhe pa mangësira. Kjo nënkupton se "Origjina e llojeve", në të kundërt me ç'pretendon Darvini, është krijim e jo evoluim.

Përralla e evoluimit të njeriut

Tema, e cila sillet më tepër në aktualitet nga ana e atyre që mbështesin teorinë e evolucionit është origjina e njeriut. Darwinizmi pretendon se njeriu i sotëm ka evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë këtij procesi evolues, i cili mendohet të ketë filluar 4-5 milion vjet më parë, thuhet se ekzistonin disa "forma kalimtare" midis njeriut modern dhe stërgjyshëve të tij. Sipas këtij skenari krejtësisht të fantazuar, "kategoritë" bazë janë katër:

1. Australopitekët
2. Homo habilis
3. Homo erectus
4. Homo sapiens

Evolucionistët e quajnë të ashtuquajturin stërgjyshin e parë të njeriut dhe majmunëve Australopitek, që do të thotë "majmun i jugut". Këto nuk janë gjë tjetër veçse një specie e vjetër majmunësh të disa llojeve të zhdukura. Punimet tepër të gjera të anatomistëve të njohur si në Angli ashtu edhe në Amerikë, të Lord Solly Zukerman dhe Prof. Qarl Oksnar mbi shembujt e Australopitekëve do të tregonin se kjo ishte vetëm një racë e zhdukur majmunësh dhe që nuk kishin asnjë lidhje me njeriun.¹⁴

Fazen tjetër të evolucionit të njeriut, evolucionistët do ta klasifikonin si "homo", pra njëri. Sipas pretendimeve të tyre ato gjallesa që marrin pjesë në serinë homo janë më të zhvilluara se Australopitekët. Evolucionistët duke i vendosur këto fosile të gjallesave të ndryshme formuan tabelën e një evoluimi imagjinar. Kjo tabelë është imagjinare sepse me të vërtetë kurrë nuk është vërtetuar një lidhje evoluese midis këtyre klasave. Ernst Mayr, një

nga mbështetësit më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit të shekullit të XX^{të} pranon se *"me të vërtetë ka humbur zinxhiri që zgjatet për te Homo sapiensi."*¹⁵

Duke futur në zingjirin e lidhjes formën "Australopitek>Homo Habilis> Homo erektus> Homo sapiens", evolucionistët nënkuptojnë se secila prej këtyre specieve është paraardhëse e njëra-tjetrës. Zbulimet e fundit të paleoantropologëve kanë treguar se Australopiteku, Homo habilis dhe Homo erektus kanë ekzistuar në pjesë të ndryshme të botës në të njëjtën periudhë.¹⁶

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo erektus ka ekzistuar deri në kohët moderne. Homo sapiensi, Neandertali dhe Homo sapiens sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtën zonë.¹⁷

Kjo situatë tregon qartë pavlefshmërinë e thënies se ata janë paraardhësit e njëri-tjetrit. Stefan xhei Guld, një nga paleontologët e Universitetit Harvard edhe pse personalisht ishte një evolucionist, këtë qorrsokak ku ka hyrë teoria darviniste e shpjegon kështu:

*Çdo të ndodhë me pemën tonë racore nëse në një mënyrë paralele me njëra-tjetrën ekzistojnë tre vija të ndryshme hominidësh (humanësh)? është e qartë se këto nuk rrjedhin nga njëri-tjetri. Aq më tepër që kur i krahasojmë këto njëri me tjetrin nuk vërejmë asnjë rrymë për një zhvillim evolucionar.*¹⁸

Shkurtimisht, skenari i evoluimit të njeriut, i cili mundohet të mbahet në këmbë me anë të një propogande boshe me anë të medias apo me anë të disa vizatimeve të gjallesave imagjinare gjysëm njëri-gjysëm majmun që zenë vend nëpër librat e shkollës, s'është gjë tjetër veçse një tregim që nuk ka baza shkencore.

Shkencëtari i mirënjohur dhe i nderuar i Anglisë, Lord Solli Zukerman, i cili për vite me radhë ka bërë studime të imta mbi këtë çështje sidomos mbi fosilet e australopitekut ka bërë punime gjatë 15 vjetëve dhe, edhe pse është një evolucionist, ka arritur në përfundim se nuk ekziston ndonjë pemë racore që zgjatet nga majmuni te njeriu.

Zukerman ka bërë edhe një "shkallë shkencore", ai ka bërë disa vlersime mbi degët e shkencës dhe i klasifikon ato si shkencore apo jashtëshkencore. Sipas kësaj tabloje të tij degët e shkencës, të cilat mund të quhen më "shkencore" të cilat mbështeten në të dhëna konkrete janë fizika dhe kimia. Më pas këto ndiqën nga biologjia dhe shkencat sociale. Nga ana tjetër ajo pjesë, e cila mund të të quhet si jashtëshkencore, sipas Zukermanit, janë telapatia, shqisa e gjashtë koncepti "përceptim përtej ndjesisë" si dhe "evolucioni i njeriut". Këtë gjë e shpjegon si më poshtë:

Duke dalur jashtë trajektores të së vërtetës objektive, e duke kaluar në këto fusha, të cilat i konceptojmë si shkencë biologjike —pra, përceptimet përtej ndjesisë dhe komentimi i historisë së fosileve të njeriut – shohim se për atë që i beson teorisë së evolucionit çdo gjë është e mundur. Aq sa është e mundur që në të njëjtën kohë të mbrojnë dy gjykime kontradiktore me njëra-tjetrën.¹⁹

Ja pra, përralla e evolucionit të njeriut rrjedh nga komentimi me paragjykime i disa fosileve të gjetura nga disa njerëz që i besojnë verbësisht teorisë së evolucionit.

Teknologjia në Sy dhe në Vesh

Një temë tjetër që mbetet e pazgjidhur nga teoria evolucioniste është kualiteti i shkëlqyer i përceptimit në sy dhe në vesh.

Para se të dalim në temën e syrit, të shohim shkurtimisht përgjigjjen në pyetjen se "si shohim ne"? Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt, bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze të dritës transmetohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapame të trurit, ku ndodhet qendra e shikimit. Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qëndër të trurit si një imazh pas një sërë procesesh. Me këtë prapaskenë teknologjike, le të mendojmë pak.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo nënkupton se mbrendësia e trurit është në errësirë të plotë dhe drita nuk arrinë atje. Qendra e shikimit është një vend i errësirës së plotë ku kurrë nuk arrin drita; mund të jetë edhe vendi më i errët që e ke ditur ndonjëherë. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë me anë të kësaj errësire të plotë.

Imazhi i formuar në sy është aq i mprehtë dhe i qartë që edhe teknologjia e shekullit të XX nuk ka qënë e aftë për ta arritur atë. P.sh, shikon në librin që e lexoni, duart me të cilat ti e mbanë, pastaj ngritni kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë kesi imazhi kaq të mprehtë dhe të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Bile edhe ekrani i televizorit më të zhvilluar e prodhuar nga prodhuesit më të mirë televiziv në botë nuk mund të ju pajisë me kesi pasqyrimi kaq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimenzional, me ngjyra, dhe pasqyrim tepër të mprehtë. Për më shumë se 100 vjet, mijra inxhinierë janë përpjekur të arrijnë këtë qartësi. Janë ndërtuar fabrika, kanë dhënë premtime të mëdha, janë bërë shumë studime, plane e projekte për këtë qëllim. Prap, shiko në

ekranin e tv-së dhe librin që e mbanë në duart e tua. Do të shihni se është një ndryshim i madh në mprehësinë dhe qartësinë. Për më tepër, ekрани i televizorit tregon një imazh dy-dimenzional, ndërsa me anë të syrit, njeriu është në gjendje të shohë imazhe tri-dimenzionale.

Për vite të tëra, me mijra inxhinier janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimenzional, dhe të arrijnë kualitetin e shikimit të syrit. Po, ata kanë bërë një televizion me sistem tre-dimenzional por është e pamundur me e shiquar pa i vënë syzat; gjithashtu, është vetëm një tre-dimenzional artificial. Prapaskena është shumë e mjegulluar; paraskena paraqitet sikur një ambient letre. Kurrë nuk ka qënë e mundshme që të arrihet një imazh kaq i mprehtë dhe të qartë sikur ai i syrit. Në të dyajt, në kamerë dhe në televizion, është një humbje e kualitetit të imazhit.

Evolucionistet pretendojnë se mekanizmi që e prodhonë këtë imazh të mprehtë dhe të qartë është formuar rastësisht. Tani, nëse ndokush të thotë ty se televizioni në dhomën tënde është formuar si një rezultat i rastësisë, se të gjitha atomet e tija vetëm rastësishtë janë bashkuar dhe e kanë bërë një paisje që prodhon një pasqyrim, çfarë do të mendoje? Si mund atomet të bëjnë atë që mijra njerëz nuk mundën?

Nëse një paisje që prodhonë një imazh më primitiv se syri, nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë se syri apo imazhi që shihet prej tij nuk kanë mund të formohen rastësisht. E njëjta situatë vlenë edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kapë tingujt në dispozicion me anë të dëgjimit, dhe i drejton për nga veshi i mesëm; veshi i mesëm i transmeton vibrimet e zërit duke

i rritur ato; veshi i mbrendshëm i dërgonë këto vibrime të truri duke i përkthyer ato në sinjale elektrike. Ngjashëm sikur me shikimin, akti i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Gjendja në sy është gjithashtu e vërtetë për veshin. D.m.th, truri është i izoluar nga tingujt sikur që është nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtoj brenda. Prandaj, pa marrë parasyshë se sa zhurmë ka jashtë, në mbrendësinë e trurit është plotësisht qëtësi. Megjithatë, tinguj më të mprehtë pranohen në tru. Në trurin tënd, i cili është i izoluar nga tingujt, ti e dëgjon simfontë e një orkestre, dhe i dëgjon të gjitha zërat në një vend të mbushur plot njerëz. Por, nëse do të ishte matur niveli i tingullit në trurin tënd nga një paisje precise në atë moment, do të ishte parë se aty ekziston një qëtësi e plotë.

Siq është rasti me imazhin, janë bërë përpjekje me dekada për të prodhuar dhe riprodhuar tinguj që është i afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruesit e zërit, sistemet me përpikri-të lartë, dhe sisteme për ndëgjimin e zërit. Pavarsisht nga e gjithë kjo teknologji dhe mijra injinjerëve dhe ekspertëve, të cilët kanë punuar në këtë përpjekje, asnjë tingull ende nuk ka arritur që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi që pranohet nga veshi. Duke menduar për kualitetet e larta të sistemeve më përpikëri-të lartë (HI-FI) të prodhuara nga kompanit më të mëdha në industrinë e muzikës. Edhe në këto paisje, kur zëri regjistrohet humbet ca prej tij, apo kur e ndez studion ju gjithmonë ndëgjoni një zë fërshfëllitës para se të fillojë muzika. Por, zërat që janë produkt i teknologjisë së trupit njerëzor janë shumë të mprehtë dhe të qartë. Një vesh njerëzor kurrë nuk ndien një zë të

shoqëruar me zëra fërshfëllues apo me shkarkime atmosferike siç bënë studioja; e ndien zërin ashtu siç është, të mprehët dhe të qartë. Kjo është mënyra që ka qënë që nga krijimi i njeriut.

Deri tani, asnjë aparat shqisor apo regjistruer i prodhuar nga njeriu nuk ka qënë aq i ndieshëm dhe i suksesshëm në pranimin e të dhënave ndijore siç janë syri dhe veshi.

Mirëpo, derisa shikimi dhe dëgjimi janë shqëtësime, një fakt tepër më i madh qëndron prapa tërë kësaj.

Ndjenja që sheh dhe dëgjon brenda trurit kujtë i takon?

Kush është që në trurin e tij shikon një botë tërheqëse, ndëgjon simfonitë dhe cicërimat e zogjëve, dhe nuhat lule?

Stimulimi që vjenë nga sytë, veshët dhe hunda e njeriut duke kaluar në tru si impulse nervore elektrokimike. Në biologji, fiziologji, dhe librat biokimik, ju mund të gjeni shumë detale se si ky pasqurim formohet në tru. Por, kurrë nuk do të vini të fakti më i rëndësishëm për këtë temë; Kush është që pranon këto impulse nervore elektrokimike, si: figurat, zërat, aromat dhe ngjarjet ndijore në tru? Në tru është një ndjenjë që pranon të gjitha këto pa pasur nevojë për sy, veshë dhe hundë. Kujt i takon kjo ndjenjë? Nuk ka dyshim se kjo ndjenjë nuk i takon nervave, shtresës dhjamore dhe neuroneve që përfshijnë trurin. Kjo është pse Darwinizmi-materializmi, të cilët besojnë se gjithçka është përbërje e materies, nuk mund të japin asnjë përgjigje në këto pyetje.

Për këtë ndjenjë është shpirti i krijuar nga All-llahu.

Shpirtit nuk i duhet as syri të shohë figura, as veshi të dëgjojë zëra. Gjithashtu, nuk i duhet truri që të mendojë.

Çdonjëri që e lëxon këtë fakt të saktë dhe shkencorë do të duhej të mendoj për All-llahun e Plotëfuqishëm, do të duhej t'i frikohet Atij, Ai i Cili tërë universin e shtrydh në një vend me errësirë të tmerrshme të disa centimetra kub në një tre-dimezional, me ngjyra, me hije dhe formë ndriqese.

Një besim materialist

Ajo çfarë kemi analizuar deri këtu tregon se teoria e evolucionit është një hipotezë, e cila bie ndesh me zbulimet e qarta të shkencës. Pretendimi i teorisë në lidhje me origjinën e jetës është në kundërshtim me fjalën e fundit të shkencës. Mekanizmat evoluese që parashtron nuk përmbyajnë asnjë efekt evolucionar dhe po ashtu edhe fosilet tregojnë se format e evolucionit janë një koncept që bie ndesh me zbulimet dhe që na duhet ta hedhim poshtë, ashtu si gjatë gjithë historisë shumë mendime si një kozmos me qëndër tokën janë nxjerrë jashtë aktualitetit të shkencës.

Për fat të keq teoria e evolucionit po mbahet në aktualitet me shumë këmbëngulje, aq sa disa njerëz kritikimin e teorisë mundohen ta shëmbëllojnë si "sulm ndaj shkencës". E pse ndodh kjo?

Shkaku i kësaj tabloje është se për disa njerëz, teoria e evolucionit përbën një besim dogmatik që kurrë s'mund të braktiset nga ata. Këto rrethe janë të lidhura ngushtë e qorrazi me filozofinë materialiste të Darvinit dhe këtë e përkrahin, vetëm se kjo ideologji i jep një shpjegim materialist natyrës, të cilën e pranojnë edhe haptazi.

Richard Levontin, një gjenetist i njohur nga Universiteti i Harvardit si një volucionist i mirëfillët e shpjegon kështu që "fillimisht është materialist e më pas shkencëtar":

Ne kemi një besim në materializëm, një besim "a priori" (të pranuar më parë, të supozuar të vërtetën). Ajo që ne na detyron t'i sjellim botës një shpjegim materialist nuk janë metodat e shkencës apo kushtet e saj. Përkundrazi, për shkak të lidhjes sonë "a priori" me materializmin spekulohen koncepte dhe metoda kërkimi që na detyrojnë një shpjegim materialist për botën. Arsyeja që materializmi është absolutisht i vërtetë (për ne) nuk mund të lejojë të hyjë në skenë një shpjegim hyjnor.²⁰

Këto fjalë tregojnë haptazi që (teoria e evolucionit) është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes së ngushtë me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Ajo predikon se lënda e pa jetë dhe e pavetëdijshme krijon jetën. Për këtë arsye besohet se jeta është krijuar nga materiale (lëndë) inorganike e të pavetëdijshme. Ajo pranon se me miliona qenie të gjalla të ndryshme si zogjët, peshqit, gjirafat, luanët, insektet, pemët, lulët, balenat dhe njerëzit me ndikimet e veta, u shfaqën si pasojë e ndikimit të fenomeneve fizike (shiut dhe rrufeve) mbi lëndën natyrale, d.m.th, me shiun që bie, me rrufetë, pranojnë që formohen brenda lëndës inorganike. Në të vërtetë kjo është një tezë në kundërshtim me logjikën si dhe me shkencën por darvinistët mbrojtjen e kësaj teze, e vazhdojnë për të "mos lejuar hyrjen në skenë të një Qenieje Hyjnor."

Çdokush që origjinën e jetës nuk e sheh me një paragjykim materialist (por me arsyen e tij), do të vështrojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha qeniet janë

vepër e një Krijuesi që zotron inteligjencë, dije dhe fuqi superiore. Ky Krijues, i Cili krijoi nga mosekzistenca të gjithë universin, i dha formë dhe krijoi gjallesat, është All-llahu.

Teoria e Evolucionit është magjia më e efektshme në botë

Duhet të bëhet e qartë se çdonjëri i lirë nga paragjykimet dhe ndikimet e çdo ideologjie të veçantë, i cili përdor vetëm arsyen dhe logjikën e tij, qartësisht do të kuptojë se besimi në teorinë e evolucionit, e cila sjell në mendje paragjykimet e shoqërive me panjohuri të shkencës apo civilizimit, është plotësisht e pamundur.

Siç u shpjegua më sipër, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një tinar mund të prodhojnë mendime, profesorë të arsyeshëm, student të universitetit, shkencëtar siç janë Ajnshtajni dhe Galileu, artista siç janë Hemfry Bogart, Frank Sinatra dhe Pavaroti, si edhe antilopët, drunjët e limonit dhe karafilin. Veç kësaj, shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këtë marrëzi janë njerëz të edukuar. Kjo është pse është fare e justifikueshme me folë për teorinë e evolucionit si "magjia më e efektshme në histori." Kurrë më parë ndonjë ide apo besim tjetër nuk ua ka marrë njerëzve' fuqinë e arsyes, duke mos u lejuar atyre me menduar me mendjehollësi dhe logjikisht dhe duke fshehur të vërtetën nga ata sikur t'i kishin ata sytë e mbyllur. Kjo është edhe më e keqe se verbëria e pabesueshme e Egjiptianëve që adhuronin Diellin Zotin Ra, totemi i adhuruar në disa pjesë të Afrikës, njerëzit e Sebes që ad-

huronin Diellin, fisi i peygamberit Ibrahimit (as) që adhuronin idhuj që vetë me duart e tyre i kishin ndrequr apo populli i peygamberit Musa (as) që adhuronin viçin e artë.

Faktikisht, kjo situatë është një mungesë e arsyes e spikatur nga All-llahu në Kur'an. All-llahu shpall në shumë ajete se mendjet e disa njerëzve' do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafaftë që të shohin të vërtetën. Disa nga këto ajete janë si në vijim:

E ata që mohuan (Kur'anin dhe Muhammedin) për ta është njësoj ua tërhoqe vërejtjen apo nuk ua tërhoqe, ata nuk besojnë. All-llahu ua mbylli atyre zemrat, veshët e tyre dhe në të pamurit e tyre ka një perde, e ata kanë një dënim të madh. (Bekare: 6-7)

...Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillët janë ata të marrët. (A'raf: 179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë). Ata gjithqysh do të thonin: "Neve na janë ndalë sytë (të pamët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Hixhr: 14-15)

Fjalët nuk mund të shprehin vetëm sa e mahnitëshme është që kjo magji do të mbaj një bashkim kaq të gjërë në skllavëri, t'i pengoj njerëzit nga e vërteta, dhe të mos priset për 150 vjetë. Është e kuptueshme që një ose disa njerëz mund të besojnë në skenaret dhe pretendimet e pamundura plot me budallaki dhe palogjikshmëri. Por, "magjia" është i vetëmi shpjegim i mundshëm për njerëzit nga e gjithë bota që besojnë se atomet e pajetë dhe të

pavetëdije papritmas vendosën të bashkohen dhe të formojnë universin që funksionon me një sistem të përsosur të organizimit, diciplinës, arsyes dhe vetëdijës, planetin e Tokës me të gjitha hollësitë që aq në mënyrë të përsosur i përshtatët jetës, dhe sendet e gjalla plot me sisteme të ndërlikuara të panumërta.

Në të vërtetë, All-llahu në ngjarjen e pejgamberit Musa (as) dhe Faraonit shpall në Kur'an se disa njerëz që mbështesin filozofitë ateiste faktikisht ndikojnë në të tjerët me magji. Kur ai i tregoi Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Muses (as) të takohet me magjistarët e tij. Kur Musa (as) e bëri atë, ai u tha atyre të paraqesin aftësitë e tyre së pari. Ajeti vazhdon:

Ai (Musai) tha: "Hidhni ju"! E kur hodhën ata (shkopinjë e litarë), magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe sollën një magji të madhe. (A'raf: 116)

Siç pamë, magjistarët e Faraonit qenë në gjendje të mashtrorinë çdonjërin, përveç Muses (as) dhe atyre që i besuan atij. Por, shenja e parashtruar nga Musa (as) e prishi magjinë, apo "gëlltiste atë që kishin magjepsuar." Siq e shpreh ajeti.

E Ne e frymëzuam Musain (duke i thënë): "Hidhe shkopin tënd!" Kur qe, ai gëlltiste atë që kishin magjepsuar. Atëherë u dëshmuua e vërteta dhe u zhduk ajo që kishin përgatitur. Aty u mundën ata (magjistarët dhe faraoni) dhe u kthyen të poshtëruar. (A'raf: 117-119)

Siç mund të shohim nga ky ajet, kur u kuptua se çfarë bënë këta njerëz të cilët të parët hudhen magjinë mbi të tjerët ishte vetëm një iluzion, ata e humbën tërë besueshmërinë. Edhe në ditët e sotme, ata që janë nën ndikimin e një magjie të ngjashme po të mos besonin në këto pre-

tendime qesharake nën fshehjet e tyre shkencore dhe të kalojnë jetrat e tyre duke i mbrojtur ata, do të heqin dorë nga ata, edhe ata do të jenë të turpëruar kur të dal në shesh e vërteta e tërë dhe të prishet magjia. Në të vërtetë, Malkom Mugerigj, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit pranoj se ai ishte i shqetësuar nga vetë pamja:

Unë jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja në të cilën është aplikuar, në të ardhëmen do të jetë një nga shakatë më të mëdha në librat e historisë. Brezat e ardhshëm do të çuditën që një teori aq shumë jobindëse dhe e dyshimtë kishte mundur të pranohet, me naivitetin pabesueshëm që e ka.²¹

Se e ardhmëja nuk është larg, përkundrazi, njerëzit së shpejti do të shohin se "rastësia" nuk është Zot, dhe do të rishikojnë në teorinë e evolucionit si mashtrimin më të keq dhe magjia më e tmerrshme në botë. Shumë njerëz të cilët e shohin fytyrën e vërtetë të teorisë së evolucionit janë duke pyetur vetën me habi se si ata ndonjëherë ishin të mashtruar nga ajo.

(Engjëjt) Thanë: "Ti je i pa të meta, ne nuk kemi dije tjetër përveç atë që na e mësove Ti. Vërtetë, Ti je i Gjithëdijshtëmi, i Urti!"

(Bekare: 32)

NOTES

- 1- Hugh Ross, *The Fingerprint of God*, p. 50.
- 2- Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, W.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
- 3- Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, Dover Publications, New York, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
- 4- "New Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, vol 63, November 1982, p. 1328-1330.
- 5- Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, p. 7.
- 6- Jeffrey Bada, *Earth*, February 1998, p. 40.
- 7- Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", *Scientific American*, vol. 271, October 1994, p. 78.
- 8- Charles Darwin, *The Origin of Species by Means of Natural Selection*, The Modern Library, New York, p. 127.
- 9- Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 184.
- 10- B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
- 11- Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 179.
- 12- Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", *Proceedings of the British Geological Association*, vol 87, 1976, p. 133.
- 13- Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, Pantheon Books, New York, 1983. p. 197.
- 14- Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, Toplinger Publications, New York, 1970, pp. 75-94; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, vol 258, p. 389.
- 15- "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final answers or by society's reluctance to pay the bills?" *Scientific American*, December 1992, p. 20.
- 16- Alan Walker, *Science*, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, *Physical Anthropology*, 1st ed., J. B. Lipincott Co., New York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
- 17- Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist With Modern Humans," *Time*, 23 December 1996.
- 18- S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30.
- 19- Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, p. 19.
- 20- Richard Lewontin, "The Demon-Haunted World," *The New York Review of Books*, January 9, 1997, p. 28.
- 21- Malcolm Muggeridge, *The End of Christendom*, Grand Rapids: Eerdmans, 1980, p. 43.